

Instituti
për
politikë
evropiane.
Shkup

RAPORTI NË HIJE PËR KAPITULLIN 23

PËR PERIUDHËN TETOR 2021 - SHTATOR 2022

RAPORTI NË HIJE PËR KAPITULLIN 23

PËR PERIUDHËN TETOR 2021 - SHTATOR 2022



RAPORTI NË HIJE PËR KAPITULLIN 23

PËR PERIUdhËN TETOR 2021 – SHtATOR 2022

Botues:

Instituti për Politikë Evropiane - Shkup

Për botuesin:

Dr. Simonida Kacarska

Redaktore:

Dr. Simonida Kacarska

Dr. Ardita Abazi Imeri

Autore:

Angella Delevska

Beba Zhagar

Përkthim nga gjuha maqedonase
në gjuhën shqipe:

Blerina Starova Zlatku

Dizajn grafik: Relativ

Shkup, dhjetor 2022



Ky raport në hije është hartuar në kuadër të projektit “Ndëtojmë ura për një të ardhme të përbashkët: Sundimi i ligjit në drejtim të anëtarësimit në BE”, financuar nga Bashkimi Evropian. Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi vetëm e autorëve dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se përfaqëson pikëpamjet dhe opinionet e Bashkimit Evropian.



Përmbajtje:

7	Hyrje
9	Metodologjia
11	1. Gjyqësor
13	Dokumentet strategjike
15	Organet drejtuese
20	Pavarësia dhe paanshmëria
30	Përgjegjësi
37	Profesionalizmi dhe kompetenca
43	Cilësia e drejtësisë
52	Efikasiteti
61	2. Lufta kundër korrupsionit
64	Kuadri institucional
64	Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit dhe
66	Prokuroria Publike
72	Kuadri ligjor
75	3. Të Drejtat Themelore
76	Praktika gjyqësore e
	Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut
78	Avokati i popullit
80	Tortura ose lloj tjetër i trajtimeve ose dënimeve mizore, çnjerëzore ose poshtëruese
82	Burgjet dhe paraburgimet
85	Mbrojtja e të dhënave personale
88	Liria e mendimit, e ndërgjegjes dhe e fesë
89	Liria e shprehjes
89	Presion mbi gazetarët
94	Grupet e cenueshme dhe parimi i mosdiskriminimit
94	Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi
96	Personat me aftësi të kufizuara
103	Gjinia
109	Gjuha e urrejtjes
111	Veprat e urrejtjes
112	LGBTI+
114	Romët
119	Literatura e shfrytëzuar



Lista e shkurtesave:

ASHMAV	Agjencia për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale
AMDHP	Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
AKMIS	Sistem i automatizuar informatash për menaxhim me lëndët gjyqësore
AQLI	Agjencia e Mbrojtjes të së Drejtës për Qasje të Lirë në Informata me Karakter Publik
AGJPP	Akademia për Gjykatës dhe Prokurorë Publikë
BIRN	Rrjeti ballkanik i raportimit investigativ
GJSRMV	Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut
GRECO	Grupi i shteteve kundër korrupsionit
ESHS	Enti Shtetëror i Statistikës
ISHP	Inspektorati Shtetëror i Punës
KSHPK	Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit
IEBGJ	Instituti Evropian për Barazi Gjinore
EJTN	Rrjeti Evropian i Trajnimit të Gjyqtarëve
KE	Komisioni Evropian
KEDNJ	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
ENER	Regjistrer i vetëm kombëtar elektronik i rregulloreve
EPI	Instituti për Politikë Evropiane
GJEDNJ	Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut
BE	Bashkimi Evropian
QEDR	Qendra Evropiane për të Drejtat e Romëve
QZHM	Ligji për shërbime mediatike audio dhe audiovizuale
LPP	Ligji për procedurën penale
SHGM	Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë
PPRMN	Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut
KP	Kodi penal
INK	Institucion ndëshkues korrektues
KPMD	Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi
CPT	Komiteti evropian për parandalimin e torturës dhe dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese
LGBTI	Komuniteti lezbik, homoseksual, biseksual, trans dhe interseks
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme

AMJR	Asociacioni Maqedonas i Juristëve të Rinj
MRT	Radiotelevizioni Maqedonas
MASH	Ministria e Arsimit dhe Shkencës
MD	Ministria e Drejtësisë
MPPS	Ministria e Punës dhe Politikës Sociale
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
PTHP	Prokuroria Themelore Publike
PTHPNOK	Prokuroria Themelore Publike për Ndjekjen e Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit
VNR	Vlerësimi i ndikimit rregullator
PINA	Platforma për gazetari investigative dhe analizë
RM	Republika e Maqedonisë
RMV	Republika e Maqedonisë së Veriut
SHBA	Shtetet e Bashkuara të Amerikës
SPB	Spektori për Punët e Brendshme
KEMM	Këshilli për Etikë në Media në Maqedoni
SÇE	VIZART – Sekretariati për Çështje Evropiane
CEPEJ	Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë
PSP	Prokuroria Publike për ndjekjen e veprave penale që lidhen dhe rezultojnë nga përmbajtja e monitorimit të paligjshëm të komunikimeve (Prokuroria Speciale Publike)
PPSRMV	Faqja zyrtare e Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut.
Këshilli i TIK-ut	Këshilli për koordinimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në organet gjyqësore
SPGM	Sindikata e pavarur e gazetarëve dhe punonjësve të medias
KGJRMV	Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut
TAIEX	Asistencë teknike për shkëmbimin e informacionit
DPF	Autoriteti i Policisë Financiare
KHDNJ	Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut
QPS	Qendra për Punë Sociale
ERA	Akademia e së Drejtës Evropiane
SSR	Qendra për trajnime dhe studime gjyqësore të Mbretërisë së Holandës



Hyrje

Ky raport në hije bashkon në një tërësi të vetme koherente të gjitha gjetjet, përfundimet dhe rekomandimet që dolën nga monitorimi i fushave të përfshira në Kapitullin 23 – Gjyqësori dhe të drejtat themelore. Ky është raporti i shtatë i tillë i publikuar nga Instituti për Politika Evropiane (EPI) - Shkup, duke marrë parasysh komentet dhe opinionet e organizatave joqeveritare. Gjashtë periudhat e mëparshme mbulojnë periudhat në vijim: tetor 2014 - korrik 2015,¹ korrik 2015 - prill 2016,² maj 2016 - janar 2018,³ qershor 2018 - mars 2019,⁴ prill 2019 - mars 2020⁵ dhe prill 2020 - shtator 2021.⁶

Rraporti mbulon periudhën nga fillimi i tetorit 2021 deri në fund të shtatorit 2022. Në raportin jepen të dhëna që janë të relevante edhe para tetorit 2021, kur nevojiten për kontekstualizimin apo sqarimin e risive nga periudha aktuale raportuese, të cilat janë të rëndësishme për periudhën raportuese. Periudha raportuese e raportit korrespondon me periudhën raportuese të Komisionit Evropian (KE) për Republikën e Maqedonisë së Veriut. Ky raport ndjek strukturën e Kapitullit 23, sipas raportit të KE-së. Në fund të çdo fushe, në kornizë janë ndarë rekomandimet dhe konkluzionet kryesore.

1 Neda Čalovska et al., “Gjyqësori dhe të drejtat themelore në Republikën e Maqedonisë” („Правосудството и темелните права во Република Македонија”), (Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut të Republikës së Maqedonisë, 2015) <https://epi.org.mk/docs/Analiza_Mreza.pdf>.

2 Neda Čalovska, Voislav Stojanovski dhe Aleksandar Jovanovski, “Raport në hije për Kapitullin 23 për periudhën nga korriku 2015 deri në prill 2016” („Извештај во сенка за Поглавје 23 за периодот од јули 2015 до април 2016 година”), (Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut të Republikës së Maqedonisë, 2016) <https://epi.org.mk/docs/lzvestaj_mk.pdf>.

3 Velimir Delovski et al., “Raport në hije për Kapitullin 23 për periudhën nga maji 2016 deri në janar 2018”, („Извештај во сенка за Поглавјето 23 за периодот од maj 2016 до јануари 2018 година”) (Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut të Republikës së Maqedonisë, 2018) <https://epi.org.mk/docs/Mreza23_lzvestaj%20vo%20senka_2018.pdf>.

4 Iva Conevska et al., “Raport në hije për Kapitullin 23 për periudhën Qershor 2018 – Mars 2019” (2019).

5 Iva Conevska dhe Ismail Kamberi, “Raport në hije për Kapitullin 23 për periudhën qershor 2019 – mars 2020”, („Извештај во сенка за Поглавјето 23 за периодот јуни 2019 – мај 2020”), Instituti për Politikë Evropiane – Shkup, 2020, <https://epi.org.mk/wp-content/uploads/2020/05/lzvestaj_vo_senka_2020.pdf>.


6 Iva Conevska Vangellova dhe Ismail Kamberi, “Raport në hije për kapitullin 23 për periudhën prill 2020 – shtator 2021”, („Извештај во сенка за Поглавјето 23 за периодот април 2020 – септември 2021”), (Instituti për Politikë Evropiane – Shkup, 16 dhjetor 2021), <https://epi.org.mk/post/20027>.

Gjatë periudhës raportuese, vendi filloi negociatat e anëtarësimit me Bashkimin Evropian, pas heqjes së bllokadës bullgare dhe pranimit të “propozimit francez” me miratimin e kornizës negociuese.⁷ Më pas, më 27 shtator 2022, në Bruksel u mbajt takimi shpjegues për Kapitullin 23 “Gjyqësori dhe të drejtat themelore”, duke përmbyllur skringun shpjegues për grupin e parë, “Themelet”.⁸ Skringu dypalësh i Kapitullit 23 u zhvillua më 1 dhe 2 dhjetor 2022, kur Maqedonia e Veriut prezantoi shkallën e harmonizimit me drejtësinë e BE-së, strukturën institucionale për zbatimin e ligjeve të harmonizuara, planet për harmonizim të mëtejshëm, ndërtimin e kapaciteteve institucionale dhe administrative, si dhe burimet e nevojshme njerëzore, financiare dhe TI për zbatimin e standardeve evropiane. Në periudhën e ardhshme do të jetë e nevojshme të ndërmerren aktivitete të dukshme që do të japin rezultate të matshme.

Ky raport në hije është përgatitur në kuadër të projektit “Ndërtojmë ura për një të ardhme të përbashkët: Sundimi i ligjit në drejtim të anëtarësimit në BE”. Projekti financohet nga Bashkimi Evropian dhe synon të ndihmojë në krijimin e reformave të qëndrueshme për sundimin e ligjit në drejtim të anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

7 “Parlamenti miratoi konkluzionet për propozimin francez,” (“Собрание го изгласа заключите за францускиот предлог,”) Deutsche Welle, 16 korrik 2022, <https://bit.ly/3hPlwbk>.

8 Mariçiq: Reformat në drejtësi janë kyçe për përshpejtimin e integritimeve evropiane,” Uebfaqja zyrtare e Sekretariatit për Çështje Evropiane, (Маричик: Судските реформи се клучни за забрзување на евроинтеграциите, Официјална интернет-страница на Секретаријатот за европски прашања), 27 shtator 2022, <https://www.sep.gov.mk/post/?id=13206#.Y7MsN3bMJPY>.



Metodologjia

Gjatë përgatitjes së këtij raporti është zbatuar metodologjia për monitorimin e fushave që janë në fokus të punës së “Rrjetit 23” – Gjyqësor, luftë kundër korrupsionit dhe të drejtat themelore,⁹ e përpunuar në vitin 2015 dhe e aplikuar tashmë në raportet e mëparshme. Ajo përfshiu hulumtimin e burimeve zyrtare të shtetit dhe institucioneve gjyqësore, analizën e njoftimit mediatik të zhvillimeve të caktuara në këto fusha në periudhën në fjalë, analiza dhe raporte të shumta të përgatitura nga organizata të shoqërisë civile, si dhe të dhëna të marra përmes kërkesave të dërguara për qasje në informacionin publik.

Për përgatitjen e këtij raporti në hije janë bërë konsultime edhe me organizata të shoqërisë civile, institucione dhe ekspertë. Fillimisht u bënë konsultime për dorëzimin e analizave, raporteve dhe hulumtimeve përkatëse në lidhje me Kapitullin 23. Më pas, më 25 nëntor 2022, u realizua një diskutim për vetë raportin, i cili bëri të mundur marrjen e një kontributi të rëndësishëm e thelbësor të përfaqësuesve përkatës të institucioneve gjyqësore, shtetërore dhe organizatave civile në finalizimin e këtij dokumenti, me çka shënimet, pikëpamjet dhe komentet e tyre janë të përfshira në këtë raport në hije.

9 Natalija Shikova (red.), “Metodologjia për monitorimin dhe vlerësimin e politikave publike nga Kapitulli 23 – gjyqësori dhe të drejtat themelore nga legjislacioni i Bashkimit Evropian”, („Методологија за мониторинг и евалуација на јавните политики од Поглавјето 23 — правосудство и фундаментални права од законодавството на Европската унија”), (Qendra për menaxhimin e ndryshimeve), <https://epi.org.mk/docs/Metodologjia_mk.pdf>.



1. Gjyqësor



Në periudhën raportuese, zbatimi i reformave në sektorin e gjyqësorit është intensifikuar në përputhje me hyrjen e Strategjisë për Reformën e Sektorit Gjyqësor 2017-2022 në fazën përfundimtare të zbatimit të saj, si dhe me fillimin e bisedimeve për anëtarësim të vendit me BE-në.

Krahas aktivitetit intensiv legjislativ në vitet e fundit, ende nuk kanë përfunduar në tërësi proceset e hartimit dhe miratimit të disa zgjidhjeve ligjore. Arsyet e kësaj situete mund t'i atribuohen pjesërisht pandemisë COVID-19, e cila ndryshoi prioritetet e qeverisë dhe ngadalësoi dinamikën e proceseve të përgjithshme reformuese, megjithatë, vetë natyra e ligjeve luajti një rol të rëndësishëm në vonesën, e cila kërkon një qasje veçanërisht të kujdesshme për çfarëdo lloji ndryshimesh dhe shtesash. Po ashtu, procedura për miratimin e disa zgjidhjeve ligjore, të sjella nga Qeveria dhe të dorëzuara në Kuvend, pothuajse është ndaluar plotësisht.

Për shkak të bashkëpunimit të pamjaftueshëm ndërmjet ministrive të linjës,¹⁰ kur u ndryshua Ligji për Marrëdhëniet e Punës, pati një çrregullim të plotë të burimeve njerëzore në gjyqësor, duke nxjerrë në pension një numër të madh të gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë, gjë që ndikoi në funksionimin efikas të institucioneve gjyqësore. Nga ana tjetër, veprimet e institucioneve gjyqësore në raste të veçanta me interes publik shkaktuan reagime të theksuara negative mes publikut profesionist dhe të gjerë, gjë që ndikoi negativisht në besimin e qytetarëve në proceset reformuese dhe në përgjithësi në gjyqësor.

10 Ministria e Punës dhe Politikës Sociale dhe Ministria e Drejtësisë.

DOKUMENTET STRATEGJIKE

Gjatë periudhës raportuese, Strategjia për Reformën e Sektorit Gjyqësor 2017-2022 hyri në vitin e pestë, të fundit të periudhës së planifikuar për zbatimin e saj. Monitorimi i zbatimit të Strategjisë ka vazhduar edhe në periudhën raportuese, nëpërmjet Këshillit për zbatimin e Strategjisë për Reformën në Gjyqësor, i cili ka mbajtur dy seanca në dhjetor 2021 dhe në prill 2022. Nga gjithsej 227 aktivitete të përcaktuara në Strategji, më shumë se 118 aktivitete janë realizuar në tërësi.¹¹ Kjo veçanërisht i referohet aktiviteteve që parashiknin ndryshime në ligjet ekzistuese ose miratimin e ligjeve të reja (të ashtuquajturat masa rregulluese), të cilat tashmë janë zbatuar ose janë në fazën përfundimtare të miratimit të tyre. Megjithatë, disa nga proceset e hartimit dhe miratimit të disa zgjidhjeve ligjore ende nuk kanë përfunduar¹² ose, nga ana tjetër, vërehen sfida në zbatimin e atyre që tashmë janë miratuar.¹³ Nga ana tjetër, detyrimi për sigurimin e një buxheti gjyqësor të pavarur në masën e parashikuar nga Ligji për Buxhetin Gjyqësor është ende larg përmbushjes dhe nuk janë ndërmarrë veprime të rëndësishme për përmirësimin e gjendjes me burimet njerëzore, nëpërmjet zbatimit të Strategjisë së Burimeve Njerëzore për Rrjetin Gjyqësor¹⁴ dhe Strategjisë së Burimeve Njerëzore për Rrjetin e Prokurorisë Publike,¹⁵ e cilat do të ketë ndikim negativ në kapacitetet reformuese. Aktivitete të caktuara që kanë të bëjnë me trajnimet, harmonizimin e praktikës gjyqësore, ekipimin kadrovik dhe teknik, janë realizuar në vazhdimësi dhe do të zgjasin deri në përfundim të zbatimit të Strategjisë për Reformën e Sektorit Gjyqësor 2017-2022.

Me zgjedhjen e Qeverisë së re¹⁶ dhe emërimin e Ministrit të ri të Drejtësisë, u shpall dhe u hartua Strategjia e re për Sektorin Gjyqësor 2023-2027,¹⁷ grupi i punës të së cilës mbajti seancën e parë konstituive më 5 shtator 2022.¹⁸ Grupi i punës përbëhet nga 31 anëtarë dhe përfshin përfaqësues nga komuniteti akademik,¹⁹ Ministria e

11 Ministria e drejtësisë, "Raporti vjetor i zbatimit të Strategjisë për Reformën e Sektorit Gjyqësor 2017-2022," 2021, („Годишен извештај за имплементација на Стратегијата за реформа на правосудниот сектор 2017-2022”), <https://bit.ly/3Wl0mX>.

12 Kodi penal, Ligji për Procedurën Penale, Ligji për Procedurën Civile, Ligji për Drejtësinë për Fëmijët, etj.

13 Sidomos në lidhje me zbatimin e disa dispozitave të Ligjit për Prokurorinë Publike, Ligjit për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Ligjit për Ndhimë Juridike Falas. Blueprint grupi për reforma në gjyqësor, PËRMBLEDHJE E DYTË GJASHTËMUJORE E MONITORIMIT: Monitorimi i zbatimit të Strategjisë për Reformën e Sektorit Gjyqësor 2017-2022 – periudha e monitorimit: janar 2022 – qershor 2022” (Instituti për Politikë Evropiane – Shkup, 19 shtator 2022), (Следене на спроведувањето на Стратегијата за реформа на правосудниот сектор 2017-2022 година – период на следење: јануари 2022 – јуни 2022”), <https://bit.ly/3NnEySR>.

14 “Strategjia e Burimeve Njerëzore për Rrjetin Gjyqësor”, („Стратегија на човечки ресурси за судската мрежа”) shtator 2020, <https://bit.ly/3trhzNE>.

15 “Strategjia e Burimeve Njerëzore për Rrjetin e Prokurorisë Publike”, („Стратегија на човечки ресурси за јавнообвинителската мрежа”), tetor 2020, <https://bit.ly/3GcekBs>.

16 “Kuvendi zgjodhi Qeverinë e re, Kovačevski kryeministër”, („Собрание ја избра новата Влада, Ковачевски е премиер”), Radio Slobodna Evropa, 16 janar 2022, <https://bit.ly/3x6vFgR>.

17 “Tupančeski ka shpallur Strategji të re të gjyqësorit 2023-2027 në një takim me Gir”, („Нова Стратегија за правосудството 2023-2027 најавил Тупанчески на средба со Гир”), 360 stepeni, 9 shkurt 2022, <https://bit.ly/36VQg6D>.

18 “Takim konstituv i grupit të punës për zhvillimin e Strategjisë së re gjyqësore 2023-2027”, (“Конститутивен состанок на работната група за изработка на новата судска стратегија 2023-2027 година), Faqja zyrtare në Facebook e Ministrisë së Drejtësisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, 5 shtator 2022, <https://bit.ly/3gYogUg>.

19 Konkretisht, Akademia e shkencave dhe e arteve e Maqedonisë (MANU), Fakulteti Juridik “Justiniani i Parë” – Shkup në Universitetin “Shën. Kirili dhe Metodi” dhe Fakulteti Juridik në Universitetin Shtetëror në Tetovë.

Drejtësisë, Ministria e Financave, Sekretariati për Çështjet Evropiane (SÇE), Akademia e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë, Zyra e Presidentit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Gjyqësori dhe Prokuroria Publike,²⁰ përfaqësues nga Prokuroria Shtetërore e Republikës së Maqedonisë së Veriut, përfaqësues nga odat përkatëse,²¹ si dhe përfaqësues nga organizata të shoqërisë civile që janë pjesë e Blueprint grupit për reformat në gjyqësor.²² Gjithashtu, për hartimin më efikas të Strategjisë, përbërja e grupit të punës ndahet në nëngrupe sipas tre fushave kryesore të fokusit, përkatësisht organeve gjyqësore dhe drejtësisë elektronike, qasjes në drejtësi dhe kornizës ligjore.²³ Megjithëse është i nevojshëm miratimi në kohë i Strategjisë së re, është gjithashtu i nevojshëm një kuptim real i situatës aktuale në gjyqësor dhe zbatimi i deritanishëm i Strategjisë ekzistuese, si dhe tejkalimi i pengesave që kontribuojnë në zvarritjen e aktiviteteve të parashikuara në të, e gjitha me synimin për të propozuar drejtimet dhe masat e duhura në të ardhmen.

Me hyrjen e Strategjisë për reformën e Sektorit Gjyqësor 2017-2022 në vitin e pestë, të fundit të periudhës së planifikuar për zbatimin e saj, numri më i madh i aktiviteteve të realizuara janë ato që parashikojnë ndryshimin e ligjeve ekzistuese apo miratimin e ligjeve të reja (të ashtuquajturat masa rregullatore). Megjithatë, disa nga proceset e hartimit dhe miratimit të disa zgjidhjeve ligjore ende nuk kanë përfunduar ose, nga ana tjetër, vërehen sfida në zbatimin e atyre që tashmë janë miratuar. Detyrimi për sigurimin e një buxheti gjyqësor të pavarur në shumën e parashikuar me Ligjin për Buxhetin Gjyqësor është ende larg përmbushjes dhe nuk janë ndërmarrë veprime të rëndësishme për përmirësimin e gjendjes me burimet njerëzore. Për shkak të saj, megjithëse miratimi në kohë i Strategjisë së re për Reformën e Sektorit Gjyqësor 2023-2027 është i nevojshëm, është gjithashtu i nevojshëm një kuptim real i situatës aktuale në gjyqësor dhe zbatimi aktual i Strategjisë ekzistuese, si dhe tejkalimi i pengesave që kontribuojnë në zvarritjen e aktiviteteve të parashikuara në të, të gjitha me synimin për të propozuar drejtimet dhe masat e duhura në të ardhmen.

20 Anëtarë të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Këshillit të prokurorëve publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Shoqatës së Gjyqtarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Shoqatës të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Shoqatës të Administratës Gjyqësore të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Këshillit Buxhetor Gjyqësor.

21 Oda e Avokatëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Oda e Noterëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Oda e Përmbanuesve të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Oda e Ndërmjetësuesve të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

22 Ministria e Drejtësisë, Sektori Gjyqësor, "Vendim për ngritjen e grupit të punës për përgatitjen e Strategjisë për Sektorin Gjyqësor me plan veprimi 2023-2027", 25 korrik 2022, i pabotuar.

23 Ministria e Drejtësisë, "Procesverbale nga mbledhja e parë konstituive e grupit të punës për Strategjinë për Sektorin Gjyqësor me plan veprimi 2023-2027", 12 shtator 2022.

ORGANET DREJTUESE

Me qëllim të promovimit të pavarësisë dhe paanshmërisë së sistemit gjyqësor, në periudhën e kaluar (2019-2020), si masa për zbatimin e Strategjisë për Reformën e Sektorit Gjyqësor²⁴, u miratuan Ligji i ri për Këshillin Gjyqësor²⁵ dhe Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Këshillin e Prokurorëve Publik.²⁶

Në lidhje me zbatimin e Ligjit për Këshillin Gjyqësor për përzgjedhjen e anëtarëve të këshillit,²⁷ gjatë periudhës raportuese, për herë të parë pas rekomandimeve të shumta, është dhënë mundësia që gjyqtarët të mund të paraqesin drejtpërdrejt kërkesë të inicijojnë procedurë për përgjegjësi disiplinore kundër një anëtar të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë Veriore (KGJRMV) të cilin e kanë zgjedhur.²⁸ Një kërkesë të tillë mund të paraqesin të paktën 20 gjyqtarë ose çdo anëtar i Këshillit Gjyqësor, me të drejtë vote.²⁹ Megjithatë, në ligj, në dispozita të veçanta nuk parashikohen afate, gjë që lë hapësirë për praktika të mundshme korruptive, ndikim mbi anëtarët e KGJRMV-së ose, nga ana tjetër, shfaqjen e konfliktit të interesave, në kundërshtim me dispozitat ligjore.³⁰ Zbrazëtira të tilla ligjore gjenden në nenin 32, i cili i referohet largimit të përkohshëm nga ushtrimi i funksionit të anëtarit të KGJRMV-së, si dhe në nenin 35, për paraqitjen e kërkesës për fillimin e procedurës disiplinore për një anëtar të Këshillit.³¹ Deri më tani nuk është paraqitur asnjë kërkesë për inicimin e procedurës për përgjegjësi disiplinore të një anëtar të Këshillit Gjyqësor.

Në përputhje me angazhimin e Qeverisë për luftën kundër korrupsionit dhe miratimin e Strategjisë kombëtare për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit 2021-2025 nga Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK),³² KGJRMV më 7 shtator 2022 miratoi Programin dhe Planin e Veprimit për Parandalimin dhe Monitorimin e Korrupsionit në Gjyqësor 2022-2025.³³ Programi dhe plani i veprimit synojnë uljen e korrupsionit, përmirësimin e integritetit të gjyqtarëve, transparencën dhe llogaridhënien, duke siguruar kështu besim më të lartë të publikut në sistemin

24 "Strategjia për Reformën e Sektorit Gjyqësor 2017-2022 me plan veprimi" (n 18).

25 "Ligji për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut", Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 102/2019.

26 "Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Këshillin e Prokurorëve Publikë", Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 42/2020.

27 Ligji për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, nenet 34 dhe 35.

28 Instituti për të Drejtat e Njeriut Shkup, "Raport për monitorimin e punës së Këshillit Gjyqësor Janar-Qershor 2022" („Извештај од следењето на работата на Судскиот совет: јануари-јуни 2022 година“), 2022, <https://bit.ly/3liMvYV>.

29 Ligji për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

30 Ibid.

31 Ibid.

32 Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, "Strategjia kombëtare për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit 2021-2025", („Националната стратегија за спречувањето на корупцијата и судирот на интереси 2021-2025 година“) 2020, <https://dksk.mk/wp-content/uploads/2021/01/Nacionalna-strategija-DKSK-KONECNA.pdf>.

33 Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut, "Programi dhe plani i veprimit për parandalimin dhe monitorimin e korrupsionit në gjyqësor 2022-2025" („Програма и Акционен план за превенција и следење на корупцијата во судството 2022-2025“), 7 shtator 2022, <https://bit.ly/3DNooPw>.

gjyqësor.³⁴ Në program, KGJRMV ka treguar të gjitha dobësitë e gjyqësorit që kanë vite që janë të pranishme në vend, si ndërtimi i marrëdhënieve joprofesionale ndërmjet prokurorëve publikë, gjyqtarëve dhe avokatëve dhe abuzimi i sistemit AKMIS përmes ndarjes subjektive të lëndëve nga personat udhëheqës. Mirëpo, në planin e veprimit ato janë deklaruar më shumë si konstatime, pa specifikuar veprimet që do të ndërmerreshin për tejkalimin e situatës dhe as nuk ka tregues për matjen e rezultateve.³⁵ Për këtë qëllim është i nevojshëm zhvillimi i mëtejshëm i programit dhe i planit të veprimit për të përcaktuar saktë aktivitetet, afatin kohor në të cilin ato planifikohen të realizohen, si dhe për të përcaktuar shkallën e rrezikut.³⁶ Gjithashtu, duke rishikuar programin dhe planin e veprimit, është e nevojshme të synohen vetë anëtarët e KGJRMV-së, të cilët janë të përjashtuar sipas programit aktual.³⁷

Pasi nuk kaluan në Kuvend ndryshimet që supozohej të zgjasnin punësimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë edhe për tre vjet,³⁸ KGJRMV në seancën e mbajtur më 1 korrik 2022 nxorri në pension 42 gjyqtarë që plotësonin kushtet për pension, dhe të cilët e kishin zgjatur mandatin në bazë të mundësisë së mëparshme ligjore.³⁹ Sipas kësaj, u hap çështja e mandatit të gjyqtarëve, anëtarë të KGJRMV-së. Gjegjësisht, në Ligjin për Këshillin Gjyqësor nuk parashikohet kjo situatë, por nga ana tjetër, anëtar i KGJRMV-së nga radhët e gjyqtarëve mund të jetë vetëm gjyqtar aktiv, sipas të cilit dy anëtarë kanë dalë në pension në korrik të vitit 2022,⁴⁰ ndërsa në gusht 2022 edhe një tjetër anëtar.⁴¹ Më pas u publikua shpallja për zgjedhjen e anëtarve nga rradhët e gjyqtarëve nga njësitë zgjedhore: Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Zona e Apelit Shkup dhe Gjykatat Administrative dhe Zona e Apelit Gostivar.⁴² Pas formimit të Komisionit për zbatimin e zgjedhjeve⁴³ dhe përgatitjes së listave të kandidatëve për zgjedhjen e anëtarëve,⁴⁴ më 14 shtator 2022, u zgjodhën tre anëtarët e rinj të KG-

34 Ibid.

35 Emilia Spasovska, "Raport nga monitorimi i Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë në vitin 2022" (Koalicioni «Të gjithë për gjykim të drejtë», 2022).

36 Ibid.

37 Ibid.

38 "Është ndërprerë seanca për vazhdimin e punësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve", („Прекината седница за продолжување на работниот ангажман на судии и обвинители“), Agjencia Informative Mediatike – MIA, 29 qershor 2022, <https://bit.ly/3NYBqgE>.

39 "Njoftim nga seanca e 407-të e Këshillit Gjyqësor të RMV - 01.07.2022", („Соопштение од 407-та седница на Судскиот совет на РСМ – 01.07.2022 година“), Faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, <https://bit.ly/3zs1070>.

40 Anëtarë të Këshillit Gjyqësor nga radhët e gjyqtarëve u pensionuan - Kiro Zdravov nga Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Zoran Teofilovski nga Gjykata e Apelit në Gostivar.

41 Anëtarja e Këshillit Gjyqësor nga radhët e gjyqtarëve u pensionua - gjyqtarja Gordana Spirevska nga Gjykata Themelore Penale Shkup. "Njoftim nga seanca e 411-të e Këshillit Gjyqësor të RMV - 09.08.2022", („Соопштение од 411-та седница на Судскиот совет на РСМ – 09.08.2022 година“), Faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, <https://bit.ly/3Ud3puM>.

42 "Shpallje për zgjedhje të anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut nga radhët e gjyqtarëve", Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 163/2022.

43 Me short u zgjodh Komisioni për Zhvillimin e Zgjedhjeve, përkatësisht: një gjyqtar nga Gjykata Supreme e RMV, një gjyqtar nga Gjykata e Apelit në Shkup dhe një përfaqësues nga sektori i shoqërisë civile. "Njoftim nga seanca e 413-të e Këshillit Gjyqësor të RMV - 24.08.2022", („Соопштение од 413-та седница на Судскиот совет на РСМ – 24.08.2022 година“), Faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, <https://bit.ly/3U8Chx9>.

44 "Lista e kandidatëve për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit nga radhët e gjyqtarëve", („Кандидатски листи за избор на членови на Советот од редот на судитите“), Faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 11 gusht 2022, <https://bit.ly/3TPKw0J>.

JRMV-së.⁴⁵ E gjithë procedura ishte transparente dhe numërimi i votave për zgjedhjen e anëtarëve u shfaq për herë të parë publikisht.⁴⁶ Mirëpo, është për t'u habitur fakti që një numër i vogël gjyqtarësh kishin paraqitur kandidaturë për t'u anëtarësuar në KGJRMV. Domethënë, për njësinë zgjedhore Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Zona e Apelit Shkup dhe Gjykatat Administrative, ka aplikuar vetëm një kandidat, që do të thotë se gjyqtarët nuk kanë pasur mundësi të votojnë, pasi opsioni i vetëm për zgjedhje ishte vetëm kandidati që aplikoi.⁴⁷ Nga analiza e vitit të kaluar të Koalicionit "Të gjithë për gjykim të drejtë"⁴⁸ nga intervistat e bëra me gjyqtarë, u konstatua se KGJRMV nuk gëzon një opinion të lartë për punën e saj nga ana e gjyqtarëve. Më saktësisht, shumica e gjyqtarëve të intervistuar mendojnë se KGJRMV nuk ka legjitimitet dhe besueshmëri të mjaftueshme për të kryer vlerësimin e gjyqtarëve. Gjithashtu, disa nga gjyqtarët theksojnë shqetësimin e tyre për cilësinë dhe njohuritë që zotërojnë anëtarët e KGJRMV-së, cilësinë e vendimeve të marra për përzgjedhjen e gjyqtarëve në një gjykatë më të lartë që nuk janë mjaftueshëm të arsyetuara, si dhe mënyrën në të cilën gjyqtarët shkarkohen. Mirëpo, nëse merren parasysh këto perceptime të gjyqtarëve, lind pyetja pse ata nuk reagojnë dhe ndërmarrin hapa, si për shembull të kandidojnë për anëtarësim në KGJRMV, për të pasur mundësi të bëjnë disa ndryshime dhe të avancojnë punën e këshillit, si dhe t'a përmirësojnë situatën për të gjithë gjyqtarët në të gjithë vendin.⁴⁹

Si pasojë e reagimeve të forta të publikut ekspert, ndaj miratimit të Kodit të Etikës së Prokurorëve Publikë në maj 2021⁵⁰, sipas të cilave disa dispozita të kodit mund të kontribuojnë në mbylljen e Prokurorisë Publike për publikun dhe se ato janë në kundërshtim me Ligjin për Prokurorinë Publike dhe përpjekjet për transparencë,⁵¹ në dhjetor 2021 është organizuar takimi me prokurorët publikë dhe Shoqatën e Prokurorëve

45 "Njoftim për publikun për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut nga radhët e gjyqtarëve", („Соопштение за јавноста за избор на членови на Судскиот совет на Република Северна Македонија од редот на судиите"), Faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 15 shtator 2022, <https://bit.ly/3fHnH9Y>.

46 Këto zgjedhje ishin zgjedhjet e para në të cilat u regjistrua numërimi i votave dhe i njëjti u publikua në faqen e internetit të Këshillit Gjyqësor, gjë që ka rëndësi të veçantë për përmirësimin e transparencës së punës së Këshillit Gjyqësor për çështje kaq të rëndësishme. "Numërimi i votave për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor nga radhët e gjyqtarëve", („Броење на гласови за изборот на членови на Судски совет од редот на судиите"), Faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 16 shtator 2022, <https://bit.ly/3gZ1bB6>.

47 Emilia Spasovska, "Raport nga monitorimi i Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë në vitin 2022" (Koalicioni "Të gjithë për gjykim të drejtë", 2022).

48 Natali Petrovska dhe Darko Avramovski, "Ndikimi i sistemit të meritës në pavarësinë dhe profesionalizmin gjyqësor në Maqedoninë e Veriut", 2021), („Влијание на мерит-системот врз судската независност и професионалност во Северна Македонија"), (Koalicioni "Të gjithë për një gjykim të drejtë"), <<https://bit.ly/3Yn1qaa>>.

49 Emilia Spasovska, "Raport nga monitorimi i Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë në vitin 2022" (Koalicioni "Të gjithë për gjykim të drejtë", 2022).

50 Këshilli i Prokurorëve Publikë, "Kodi Etik i Prokurorëve Publikë në Republikën e Maqedonisë së Veriut", („Етички кодекс на јавните обвинители во Република Северна Македонија"), 20 maj 2021, <https://bit.ly/3Ga4786>.

51 Dispozitat e kodit, sipas të cilave "Prokurorët publikë janë të detyruar të shmangin deklaratat publike apo private që mund të shkaktojnë dyshime në paanshmërinë e tyre dhe në veçanti të mos bëjnë komente për lëndët në të cilat ata veprojnë ose mund të veprojnë" dhe "Prokurorët publikë, kur marrin udhëzime nga prokurori më i lartë publik se si të veprojnë në lëndë të caktuara, do të përmbahen nga dhënia e njoftimeve apo komenteve për të tjerët" veçanarisht shkaktojnë reagime në publik. Sipas një pjese të opinionit ekspert, kjo është në kundërshtim me nenin 3 të Ligjit për Prokurorinë Publike, "(1) Prokuroria Publike është e organizuar sipas parimeve të hierarkisë dhe të vartësisë. (2) Prokuroria Publike është organ i pavarur shtetëror. (3) Respektimi i parimeve nga paragrafi (1) i këtij neni nuk guxon të rrezikojë pavarësinë dhe përgjegjësinë e secilit prokuror publik në kryerjen e detyrës." Reagime ka pasur edhe për dispozitën e kodit të etikës sipas të cilit "Prokurorët publikë nuk do të komentojnë në publik vendimet e marra nga KPPRMV.

Publikë në të cilin është konstatuar se kodi duhet të rishikohet.⁵² Përveç kësaj, në takim u përcaktua që kodi duhet të jetë gjithashtu në përputhje me parimet e vlefshme bazë, legjislacionin kombëtar dhe standardet ndërkombëtare, siç janë Udhëzimet Evropiane për Etikën dhe Sjelljen e Prokurorëve Publikë («Udhëzimet e Budapestit») 2005 (CP-GE).⁵³ Megjithatë, kodi mbetet ende i pandryshuar.

Gjatë periudhës raportuese, Këshilli i Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut (KPPRMV) konstatoi ndërprerjen e mandatit të tre anëtarëve të këshillit.⁵⁴ Lidhur me këtë çështje janë shpallur zgjedhjet për zgjedhjen e një anëtari të Këshillit nga radhët e prokurorëve publikë në Prokurorinë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut,⁵⁵ si dhe zgjedhjen e dy anëtarëve të Këshillit të cilët zgjidhen nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut.⁵⁶ Në përputhje me zgjedhjen e parë, këshilli zgjodhi një anëtar të këshillit nga vendvotimi numër 5 (Prokuroria Publike Republikane), mandati i të cilit filloi më 1 mars 2022, me të cilin përbërja aktuale e Këshillit punon me dy anëtarë më pak domethënë punon me një përbërje prej nëntë anëtarësh në vend të 11 të parashikuar me ligj. Vendet e anëtarëve të cilëve u ka përfunduar mandati në mars dhe gusht 2022 nuk janë mbushur ende.⁵⁷

KPPRMV në vitin 2021, për herë të parë që nga konstituimi i tij në 2008, financohet nga buxheti i tij.⁵⁸ Këshilli është financuar deri në vitin 2021 si pjesë e programit buxhetor të Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Prandaj, në periudhën raportuese të seancave të tij, këshilli shqyrtoi propozim projeksionet për buxhetin e KPPRMV për vitin 2022.⁵⁹ Megjithatë, publikimi jo transparent i buxhetit të KPPRMV ka vazhduar, me çka ai nuk është publikuar në faqen e internetit të KPPRMV.⁶⁰

52 "Rishikimi i Kodit të Etikës së Prokurorëve Publikë", („Ревизија на Етичкиот кодекс на јавните обвинители”), Faqja zyrtare e Zyrës së programit të Këshillit të Evropës në Shkup, 21 dhjetor 2021, <https://www.coe.int/mk/web/skopje/-/revision-of-the-code-of-ethics-for-public-prosecutors>.

53 "Udhëzimet Evropiane mbi etikën dhe sjelljen për prokurorët publikë, Udhëzimet e Budapestit", („Европски насоки за етика и однесување за јавните обвинители, „Насоки од Будимпешта”), (Këshilli i Evropës, 2005), <https://rm.coe.int/conference-of-prosecutors-general-of-europe-6th-session-organised-by-t/16807204b5>.

54 Në shkurt të vitit 2022 iu konfirmua ndërprerja e mandatit si anëtar i këshillit Aco Kolevskit. Në mars të vitit 2022, Angell Solevit iu ndërpre mandati si anëtar i këshillit, ndërsa Ljupčo Ivanovskit iu ndërpre në gusht. Kontribut në Raportin në hije nga Koalicioni "Të gjithë për gjykim të drejtë".

55 "Shpallje për zgjedhjen e një anëtari të Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut nga radhët e prokurorëve publikë të Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut me vendvotim nr. 5", Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 18/2022.

56 "Shpallje për zgjedhjen e një anëtari të Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut të cilin e zgjedh Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut", Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut", nr. 154/2022.

57 Kontribut drejt Raportit në hije të Kapitullit 23 për periudhën tetor 2021 – shtator 2022 nga Koalicioni "Të gjithë për gjykim të drejtë".

58 Këshilli i Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, «Raporti vjetor për punën e Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2021», („Годишен извештај за работата на Советот на јавни обвинители на Република Северна Македонија за 2021 година”), janar 2022, <https://bit.ly/3DGHDCu>.

59 Ibid.

60 Ardita Abazi Imeri et al., "Analizë - Vlerësim gjithëpërfshirës i zbatimit të Strategjisë për reformën e Sektorit Gjyqësor 2017-2022", („Анализа — Сеопфатна оценка на спроведувањето на Стратегијата за реформа на правосудниот сектор 2017-2022”), (Instituti për Politikë Evropiane – Shkup, 10 nëntor 2022), <https://bit.ly/3X2nox8>.

Në përputhje me zbatimin e Ligjit për Këshillin Gjyqësor në lidhje me përzgjedhjen e anëtarëve të këshillit, për herë të parë, pas rekomandimeve të shumta, u dha mundësia që gjyqtarët të mund të paraqesin drejtpërdrejt kërkesë për fillimin e një procedure për përgjegjësi disiplinore të një anëtari të këshillit që ata kanë zgjedhur. Mirëpo, në ligj, në dispozita të veçanta, nuk parashikohen afate, gjë që lë hapësirë për praktika të mundshme korruptive, ndikim mbi anëtarët e KGJRMV-së apo, nga ana tjetër, shfaqjen e konfliktit të interesit, në kundërshtim me dispozitat ligjore.

Këshilli Gjyqësor miratoi Programin dhe planin e veprimit për parandalimin dhe monitorimin e korrupsionit në gjyqësor 2022-2025, i cili synon uljen e korrupsionit, përmirësimin e integritetit të gjyqtarëve, transparencën dhe llogaridhënien, duke siguruar kështu besim më të lartë të publikut në sistemin gjyqësor. Megjithatë, është e nevojshme të zhvillohet më tej programi dhe plani i veprimit për të përcaktuar saktë aktivitetet që duhet të ndërmerren sipas konstatimeve të përcaktuara, afatin kohor në të cilin ato planifikohen të zbatohen, si dhe të përcaktohet shkalla e rrezikut. Gjithashtu, duke rishikuar programin dhe planin e veprimit, është e nevojshme t'i kush-tohet vëmendje sjelljes së anëtarëve të Këshillit Gjyqësor dhe respektimit të detyrimeve të përcaktuara me ligj. Ndryshe, dëmtohet planifikimi dhe zbatimi i plotë i programit, i cili ka për qëllim pikërisht luftën kundër korrupsionit.

Niveli i ulët i interesimit të gjyqtarëve për të paraqitur kandidaturën për anëtarë të Këshillit Gjyqësor tregon nevojën e ndërmarrjes së veprimeve konkrete nga institucionet kompetente për të inkurajuar gjyqtarët që të kandidojnë për anëtarë të Këshillit Gjyqësor, në mënyrë që të përzgjedhin gjyqtarët më të mirë dhe më profesionistë të cilët do të kontribuojnë më tej në punën e Këshillit Gjyqësor.

Shihet se Kodi i Etikës i Prokurorëve Publik përmban dispozita të caktuara që kundër-shtojnë drejtpërdrejt parimet e transparencës, veçanërisht në aspektin e mohimit të mundësisë së prokurorëve publik për të komentuar vendimet e Këshillit të Prokurorëve Publikë, si dhe të bëjnë deklarata publike për lëndët mbi të cilat veprojnë. Komentimi i vendimeve mund të çojë vetëm në përmirësimin e cilësisë së vendimeve të marra, duke qenë se autoriteti që i merr ato do të duhet të shpjegojë në detaje arsyet pse është marrë pikërisht një vendim i tillë. E gjithë kjo kontribuon në rritjen e transparencës dhe llogaridhënien në punën e Këshillit të Prokurorëve Publikë. Pikërisht për këtë, është e nevojshme të ndërmerren veprime specifike për ndryshimin e Kodit të Etikës në një periudhë sa më të shkurtër të mundshme.

PAVARËSIA DHE PAANSHMËRIA

Korniza ligjor, si garanci për pavarësinë e gjyqësorit, është mirë e zhvilluar dhe e zbatuar plotësisht,⁶¹ me përjashtim të pjesës së pavarësisë financiare të buxhetit gjyqësor. Megjithatë, përkundër kornizës ligjore të vendosur që së bashku me Kushtetutën e RMV-së garanton pavarësinë e gjyqësorit dhe parimin e ndarjes së pushtetit, besimi i qytetarëve në gjyqësor është ende në nivel të pakënaqshëm, siç tregohet nga hulumtimi i fundit nga Barometri Ballkanik, ku Maqedonia e Veriut krahasuar me një vit më parë shënoi një rritje të mosbesimit prej 3%.⁶² Një rol kyç në forcimin e besimit të qytetarëve në gjyqësor luan pushteti legjislativ, pushteti ekzekutiv, media dhe KGJRMV, duke inkurajuar transparencën e proceseve gjyqësore, zbatimin e vendimeve, duke ruajtur kështu besimin e publikut në pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit.⁶³ Në këtë drejtim, KGJRMV duhet të vazhdojë me praktikën e mbrojtjes dhe promovimit të pavarësisë së gjyqësorit të theksuar në raportet e mëparshme në hije.⁶⁴

Përmirësimi i transparencës mbetet një sfidë për të dy këshillat. KGJRMV shënon vazhdimësi në plotësimin e kushteve themelore për funksionim publik dhe transparent të seancave të tij, që do të thotë se njoftimet për seancat e parapara publikohen me kohë në faqen zyrtare të Këshillit dhe njoftimet për vendimet e marra botohen rregullisht pas përfundimit të seancave.⁶⁵ Respektohet detyrimi ligjor për publikimin e procesverbaleve të seancave të KGJRMV-së dhe procesverbalet, të cilat janë të detajuara, publikohen pas miratimit të tyre.⁶⁶ Megjithatë, ka një vonesë prej rreth një muaji nga dita e mbajtjes së seancave deri në publikimin e tyre në faqen e internetit. Kjo mund të jetë për faktin se procesverbali miratohet ngadalë duke pasur parasysh se në to shpesh ka gabime shtypi, prandaj anëtarët e KGJRMV-së kërkojnë që të bëhen korrigjime për të mos keqinterpretuar deklaratën e tyre.⁶⁷ Më tej, mund të theksohet se janë publikuar edhe informacione të tjera lidhur me mbledhjet ku marrin pjesë kryetari dhe anëtarët

61 Një pjesë e aktiviteteve dhe masave të përcaktuara në Strategjinë për Reformën e Sektorit Gjyqësor 2017–2022 që i referohen pavarësisë dhe paansësisë janë zbatuar me miratimin e grupit të tretë të ndryshimeve në Ligjin për Gjykatat dhe Ligjin e ri për Këshillin Gjyqësor. Në drejtim të rritjes së pavarësisë së gjyqësorit, janë në fuqi edhe Ligji për Prokurorinë Publike dhe Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Këshillin e Prokurorëve Publikë. Grupi i tretë i ndryshimeve në Ligjin për Gjykatat dhe Ligjin e ri për Këshillin Gjyqësor kontribuan në veçanti në zbatimin e rekomandimeve të grupit të ekspertëve të kryesuar nga Pribe dhe rekomandimeve të dhëna nga Komisioni i Venecias.

62 Qendra ACIT dhe Instituti EPIK, "BAROMETER BALKANIK - Raport analitik për opinionin publik 2022", (BALKAN BAROMETER – 2022 Public Opinion Analytical report) qershor 2022, <https://www.rcc.int/balkanbarometer/publications>.

63 Ledi Bianku [Ledi Bianku] dhe Hana Smith [Hannah Smith], "Pavarësia dhe paanshmëria e gjyqësorit - një pasqyrë e praktikës përkatëse gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut" (2021) <<https://www.rolplatform.org/wp-content/uploads/2021/09/independence-and-impartiality-of-judiciary-mkd.pdf>> .

64 Conevska Vangellova dhe Kamberi, "Raport në hije për kapitullin 23 për periudhën prill 2020-shtator 2021", („Извештај во сенка за Поглавје 23 за периодот април 2020-септември 2021"), (Instituti për Politikë Evropiane - Shkup, 16 dhjetor 2021), <https://bit.ly/3lIN3ir>; Iva Conevska dhe Ismail Kamberi, "Raport në hije për kapitullin 23 për periudhën prill 2019 – mars 2020", („Извештај во сенка за Поглавје 23 за периодот април 2019 – март 2020 Година") (Instituti për Politikë Evropiane – Shkup, 26 maj 2020), <https://epi.org.mk/post/14897>.

65 Instituti për të Drejtat e Njeriut Shkup, "Raport nga monitorimi i punës së Këshillit Gjyqësor Janar-Qershor 2022" („Извештај од следењето на работата на Судскиот совет: јануари-јуни 2022 година"), <https://bit.ly/3lIMvYV>.

66 Ibid.

67 Emilia Spasovska, "Raport nga monitorimi i Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë në vitin 2022" (Koalicioni "Të gjithë për gjykim të drejtë", 2022).

e këshillit, si dhe raportet vjetore për punën e këshillit.⁶⁸ Gjithashtu, ka një aktivitet të shtuar të KGJRMV-së në drejtim të rritjes së transparencës së gjykatave për zbatimin e vazhdueshëm të dispozitave të Ligjit për Qasje të Lirë në Informacionet Publike⁶⁹ dhe realizimin e të drejtës së qytetarëve për qasje të lirë në informacion. Në këtë drejtim, KGJRMV dhe Agjencia për Mbrojtjen e të Drejtës për Qasje të Lirë në Informacionin Publik (AQLI) nënshkruan një memorandum bashkëpunimi në maj të vitit 2022.⁷⁰ Në periudhën e ardhshme AQLI do të monitorojë faqet e internetit të gjykatave në lidhje me respektimin e nenit 10 të ligjit për qasje në informacionin publik dhe më pas do të përgatisë një analizë.⁷¹

Ajo që mbetet si sfida janë kapacitetet hapësinore dhe teknike në dispozicion të KGJRMV-së dhe gjykatave në tërësi, të cilat jo gjithmonë lejojnë praninë e anëtarëve të interesuar të publikut dhe medias. Ekziston gjithashtu nevoja për aplikim më të madh të regjistrimeve audio dhe audio-vizuale të seancave dhe gjykimeve, të cilat edhe pse janë obligim ligjor, në praktikë nuk u zbatuan në mënyrë të vazhdueshme dhe të rregullt. Gjithashtu, kryetarja e KGJRMV-së nuk inicon konferenca për shtyp dhe takime me media kur ka çështje të rëndësishme që janë në kompetencë të organit dhe që janë në interes të publikut.⁷² Vazhdon praktika e papërshtatshme e mbajtjes së kolegjiut me dyer të mbyllura të anëtarëve të KGJRMV menjëherë para fillimit të seancave,⁷³ sidomos për çështje kyçe, për të cilat reagojnë vetë disa anëtarë të këshillit.⁷⁴ Në të njëjtën kohë, është vërejtur se ndonjëherë gjatë vetë seancës, kur ndodh debati mes anëtarëve për një çështje të caktuar, bëhet një pushim prej 10 ose 15 minutash, kohë në të cilën publiku largohet nga salla ku mbahet seanca dhe anëtarët vazhdojnë debatin me dyer të mbyllura, gjë që lë përshtypjen se këshilli i fsheh opinionet dhe mendimet e tij nga publiku.⁷⁵ Prandaj është e nevojshme që vetë anëtarët e KGJRMV-së të debatojnë në seancat, të shprehin mendimin e tyre për secilin propozim, sepse në këtë mënyrë përmirësohet opinionin e publikut për punën e KGJRMV-së dhe rritet shkalla e kontrollit.⁷⁶

68 Ibid.

69 "Ligji për Qasje të Lirë në Informata Publike", Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 101/2019.

70 "Memorandum i nënshkruar për rritjen e transparencës së gjykatave", Akademik, („Потпишан меморандум за зголемување на транспарентноста на судовите“), 18 maj 2022, <https://akademik.mk/potpishan-memorandum-za-zgolemuвање-na-transparentnosta-na-sudovite/>.

71 Ibid.

72 Deklaratat apo intervistat e kryetares mund të regjistrohen, vetëm për ndodhi të veçanta aktuale, si për shembull prezantimi i raportit të punës së KGJRMV-së për vitin 2021. Shih më shumë në Institutin për të Drejtat e Njeriut Shkup, "Raport nga monitorimi i punës së Këshillit Gjyqësor: janar-qershor 2022."

73 Opsioni për mbajtjen e mbledhjeve të punës (kolegjiute) u mundësua me Rregulloren e Këshillit Gjyqësor të vitit 2015, ku në nenin 15 parashikohet se kryetari i Këshillit mund të mbledhë dhe të mbajë kolegjiute sa herë që e vlerëson të nevojshme. Në Rregulloren e punës që është aktualisht në fuqi, kjo dispozitë pasqyrohet në nenin 19. Spasovska, "Raporti nga monitorimi i Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë në vitin 2022".

74 Institutin për të Drejtat e Njeriut Shkup, "Raport nga monitorimi i punës së Këshillit Gjyqësor janar-qershor 2022" („Извештај од следењето на работата на Судскиот совет: јануари-јуни 2022 година“), <https://bit.ly/3lIMvYV>.

75 Emilia Spasovska, "Raport nga monitorimi i Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë në vitin 2022" (Koalicioni "Të gjithë për gjykim të drejtë", 2022).

76 Ibid.

Një trend pozitiv në përmirësimin e transparencës së gjyqësorit dhe rritjen e besimit të qytetarët është krijimi i Këshillit për Gjyqësor të Hapur,⁷⁷ i cili duhet të shërbejë edhe si mekanizëm për përmirësimin e statusit të gjyqësorit përmes respektimit të plotë të parimit të pavarësisë në të gjitha format - institucionale, funksionale dhe financiare.⁷⁸ Këshilli për Gjyqësor të Hapur përfshin një përfaqësues nga të gjitha instancat gjyqësore dhe përfaqësues të KGJRMV, Akademisë së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë, si dhe përfaqësues nga gjashtë shoqata të qytetarëve.⁷⁹

Sa i përket transparencës së punës së KPPRMV, mund të thuhet se seancat janë të hapura për publikun dhe mund të ndiqen në të gjitha pikat, përveç atyre ku publiku është i përjashtuar sipas ligjit.⁸⁰ Në seancat, anëtarët vazhdimisht kyçen në diskutime dhe shprehin qëndrimet e tyre për çështje të caktuara, edhe kur janë kundër anëtarëve të tjerë të këshillit.⁸¹ E gjithë kjo kontribuon në zhvillimin e një debati konstruktiv nga i cili publiku mund të njohë realisht situatën në prokuroritë publike. Sa i përket publikimit në faqen e internetit, KPPRMV publikon datat e mbajtjes së seancave, por disa herë data e seancës shpallet menjëherë ose shumë pak para mbajtjes së seancës, gjë që vështirëson ndjeshëm pjesëmarrjen e publikut.⁸² Gjithashtu, KPPRMV vazhdon me praktikën e publikimit të parregullt të procesverbaleve të seancave të mbajtura.⁸³ Të njëjtat vërejtje kanë të bëjnë edhe me publikimin e vendimeve të arsyetuara për përzgjedhjen, ngritjen në detyrë dhe shkarkimin e prokurorëve publikë, si dhe vendimeve të tjera të marra nga ai, që është plotësisht në kundërshtim me Rregulloren e punës së KPPRMV-së.⁸⁴ Mungon gjithashtu transparenca aktive në sektorin e marrëdhënieve me publikun dhe publikimi i informacionit në lidhje me aktivitetet e përditshme të KPPRMV-së, pavarësisht emërimit të një personi për marrëdhënie me publikun.⁸⁵ Është e rëndësishme të publikohet një informacion i tillë në mënyrë që të afrohet puna e KPPRMV-së me publikun dhe të rritet më tej ndërgjegjësimi i publikut dhe afirmimi

77 Akademik.mk, "U themelua Këshilli për Gjyqësor të Hapur dhe u nënshkrua Deklarata për Gjyqësor të Hapur", („Основен Советот за отворено судство и потпишана Декларацијата за Отворено судство”), 31 mars 2022, <https://akademik.mk/osnovan-sovetot-za-otvoreno-sudstvo-i-potpishana-deklaratsijata-za-otvoreno-sudstvo/>.

78 "Këshilli për Gjyqësor të Hapur miratoi Rregulloren e punës dhe zgjodhi bashkëkryetarët", („Советот за Отворено судство го усвои Деловникот за работа и избора ко-претседатели") Faqja zyrtare e Gjykatës së Lartë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 13 korrik 2022, <https://bit.ly/3gY1hIV>.

79 Shoqata e Gjyqtarëve, Shoqata e Administratës Gjyqësore, Qendra për Hulumtime dhe Analiza Juridike, Instituti për të Drejtat e Njeriut, Shoqata Maqedonase e Juristëve të Rinj dhe Koalicioni «Të gjithë për gjykim të drejtë».

80 KPPRMV mund t'a përjashtojë publikun vetëm me vendim, për të mbrojtur reputacionin dhe integritetin e prokurorit publik. Sipas nenit 14 të Rregullosës së KPPRMV, Këshilli mund të vendosë të përjashtojë publikun nga seancat me shumicë prej dy të tretave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve. Nëse Këshilli merr një vendim të tillë, ai është i detyruar të informojë publikun për arsyet e përjashtimit të publikut.

81 Emilia Spasovska, "Raport nga monitorimi i Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë në vitin 2022" (Koalicioni "Të gjithë për gjykim të drejtë", 2022).

82 "Diskutim për Raportin në hije në kapitullin 23 për periudhën tetor 2021 – shtator 2022", („Дискусија за Извештајот во сенка за Поголемиот 23 за периодот октомври 2021 – септември 2022 година"), Faqja zyrtare e Institutit për Politikë Evropiane – Shkup, 25 nëntor 2022, <https://epi.org.mk/post/22609>.

83 Në të njëjtën kohë, mund të aksesohen vetëm procesverbalet më të fundit, duke qenë se procesverbalet dhe njoftimet e vjetra që datojnë para muajit maj 2022 nuk gjenden në faqen e internetit.

84 Në nenin 16 paragrafi 7 i Rregullosës për punën e KPPRMV-së, thuhet se vendimet e Këshillit duhet të shpjegohen dhe të njëjtat të publikohen në ueb faqen e Këshillit. „Лигет dhe aktet nënligjore”, („Закони и подзаконски акти"), Faqja zyrtare e Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, <https://bit.ly/3v8rfqH>.

85 Informacioni se ku mund të kontaktohet personi i marrëdhënieve me publikun nuk është i publikuar në faqen e internetit të KPPRMV-së. Instituti për të Drejtat e Njeriut Shkup, "Raporti tremujor për monitorimin e seancave të Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut: periudha maj-korrik 2022", („Тримесечен извештај од следење на седниците на Советот на јавни обвинители на Република Северна Македонија: период мај-јули 2022 година"), <https://bit.ly/3zt5o6c>.

i kompetencave të KPPRMV.⁸⁶ Prandaj, është i nevojshëm miratimi i një strategjie të re komunikimi për periudhën e ardhshme 2022-2025, në të cilën do të analizohen në detaje nevojat dhe mangësitë në zbatimin e strategjisë së mëparshme, me synim funksionimin e pandërprerë dhe një qasje më të madhe dhe proaktive në komunikim me publikun dhe qytetarët në tërësi.⁸⁷

Siç u tha në raportet e mëparshme në hije, një aspekt i rëndësishëm i pavarësisë së sistemit gjyqësor është sigurisht pavarësia financiare. Konkretisht, pavarësia financiare dhe rritja e pagave në gjyqësor janë temë diskutimi prej disa vitesh. Megjithatë, ka konsistencë në politikat e autoriteteve legjislativë dhe ekzekutive në moszbatimin e garancive ligjore për pavarësinë financiare të sistemit gjyqësor, duke mos siguruar 0.8% të PKB-së së detyrueshme në asnjë buxhet të shtetit që nga miratimi i Ligjit për Buxhetin Gjyqësor në 2010.⁸⁸ Madje, buxheti i gjykatave shënoi rënie në krahasim me vitin e kaluar, ku për vitin 2021 ishte 0.39% e PKB-së, ndërsa për vitin 2022 ishte 0.3% e PKB-së, që është 60% më pak se kufiri i përcaktuar ligjor.⁸⁹ Për këtë arsye buxheti i gjykatave është i pamjaftueshëm për të mbuluar të gjitha nevojat e gjyqësorit dhe gjithashtu nuk lejon investime më të mëdha financiare për funksionalitet më të madh, prandaj gjykatat funksionojnë me kushte minimale të punës. Është e nevojshme të shtohen fondet që i ndahen Prokurorisë Publike, si organ kyç për luftimin e krimit dhe korrupsionit. Shuma e miratuar e mjeteve për Prokurorinë Publike për vitin 2021 është 0,18% e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut,⁹⁰ kundrejt 0,4% të përcaktuar me ligj të buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut,⁹¹ që është nën 50% të kufirit të përcaktuar ligjor.⁹²

Nga ana tjetër, pas marrëveshjes së arritur ndërmjet Qeverisë dhe Shoqatës së Gjyqtarëve⁹³ për rritjen e pagave të gjyqtarëve për 15% deri në vitin 2022 dhe nënshkrimi të rregullave për rritjen e pagave nga 8 në 18%,⁹⁴ Shoqata e Gjyqtarëve miratoi një Strategji për përmirësimin e gjendjes materiale të gjyqtarëve 2022-2024.⁹⁵ Strategjia

86 Ibid.

87 Ibid.

88 Qendra për Hulumtime dhe Analiza Juridike, "Plani për përmirësimin e punës dhe kushteve në gjykatat themelore", („План за подобрување на работата и условите во основните судови“), 2021, <https://bitly/3h0kZUN>.

89 Enti Shtetëror i Revizionit, "Raporti përfundimtar për revizionin e përputhshmërisë së buxhetit bazë të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2021", („Конечен извештај за извршената ревизија на усогласеност на основен буџет на Република Северна Македонија за 2021 година“), 2022, https://dzr.mk/sites/default/files/2022-09/01_Osnoven_budzet_RSM_KOMPLET_2021_0.

90 Ibid.

91 Ligji për Prokurorinë Publike, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 42/2020.

92 Enti Shtetëror i Revizionit, "Raporti përfundimtar për revizionin e përputhshmërisë së buxhetit bazë të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2021", („Конечен извештај за извршената ревизија на усогласеност на основен буџет на Република Северна Македонија за 2021 година“), 2022, https://dzr.mk/sites/default/files/2022-09/01_Osnoven_budzet_RSM_KOMPLET_2021_0.

93 Akademik.mk, "Rriten pagat e gjyqtarëve" (n 103).

94 Pravdiko, "Maričiq nënshkroi një rregullore për rritjen e pagave të policisë gjyqësore" („Маричик потпиша правилник за зголемување на платите на судската полиција“), (5 mars 2021) <<https://www.pravdiko.mk/marichik-potpisha-pravilnik-za-zgolemuвање-na-platite-na-sudskata-politsija/>>.

95 "Seanca e XI-të e Bordit drejtues të Shoqatës së Gjyqtarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut", („XI—тата sedница на Управниот одбор на Здружението на судиите на Република Северна Македонија“), Faqja zyrtare e Shoqatës së Gjyqtarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 10 shkurt 2022, <https://bitly/3zQ3NaV>.

është përgatitur si rezultat i zbatimit të parakohshëm të aktiviteteve të dakorduara me Qeverinë, me qëllim të vendosjes së kërkesave të reja me afate specifike për zbatim.⁹⁶ Në këtë drejtim, Qeveria përcaktoi paketën me katër ligje për paga më të larta në sistemin gjyqësor dhe në prokurori.⁹⁷ Më konkretisht, janë përcaktuar ligjet për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Pagat e Prokurorëve Publik, Ligjit për Shërbimin Gjyqësor, Ligjit për Shërbimin Prokurorial Publik dhe Ligjit për Pagat e Anëtarëve të Këshillit të Prokurorëve Publikë.⁹⁸

Së pari, me ndryshimet e propozuara në Ligjin për Pagat e Prokurorëve Publik, përshtatet koeficienti për përcaktimin e pagës së prokurorëve publik dhe angazhimi i përgjithshëm për përmirësimin e burimeve materiale dhe financiare në sistemin gjyqësor, duke përfshirë pagat dhe kompensimet e tjera të prokurorëve publik. Së dyti, me ndryshimet në Ligjin për Shërbimin Gjyqësor dhe Ligjin për Ndryshimin e Ligjit për Shërbimin Prokurorial Publik, arrihet barazia për punonjësit në sektorin privat dhe publik duke vendosur të njëjtën masë të pagës minimale ligjore dhe duke harmonizuar gradualisht pagat e tjera të zyrtarëve gjyqësorë dhe të prokurorëve publikë të të gjitha niveleve, si dhe duke siguruar vazhdimësinë e ndryshimeve të pagave në administratën gjyqësore dhe në administratën e prokurorisë publike në raport me pagën minimale në nivel kombëtar. Së treti, me tekstin e propozuar ligjor për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Pagat e Anëtarëve të Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë, ndryshohen koeficientët për përcaktimin e pagës së anëtarëve të Këshillit me qëllim të avancimit të sistemit të pagave të anëtarëve të Këshillit të Prokurorëve Publikë, në përputhje me rëndësinë dhe reputacionin e funksionit që ata kryejnë, rëndësinë e punës dhe përgjegjësinë e tyre.

Paketa e propozuar e ndryshimeve ligjore, e përmendur më sipër, i është dorëzuar Kuvendit për miratim.⁹⁹ Më 27 korrik 2022, Kuvendi miratoi ligjet e propozuara për ndryshimin e Ligjit për Shërbimin Gjyqësor dhe Ligjit për Prokurorinë Publike me procedurë të shkurtuar,¹⁰⁰ të cilat u shqyrtuan të nesërmen në seancën e Komisionit Juridik Ligjvënës¹⁰¹, ku pritet të kalojnë për votim në seancë plenare.¹⁰² Afatet e parashikuara

96 "Strategjia për përmirësimin e gjendjes materiale të gjyqtarëve 2022–2024", („Стратегија за подобрување на материјалниот статус на судиите 2022–2024”), Faqja zyrtare e Shoqatës së Gjyqtarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 18 shkurt 2022, <https://bit.ly/3Ubl1CT>.

97 "Qeveria miratoi pakon e ndryshimeve ligjore për paga më të larta në sistemin gjyqësor dhe në prokurori", („Владата го усвои пакетот законски измени за повисоки плати во правосудниот и обвинителскиот систем”), Uebfaqja zyrtare e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, 25 maj 2022, <https://vlada.mk/node/28948>.

98 Ibid.

99 Ibid.

100 "Pas procedurës së shkurtuar do të miratohen ligjet për rritjen e pagave në gjyqësor, prokurori dhe polici të burgjeve", („По скратена постапка ќе се донесат законите за зголемување на платите во судството, обвинителствата и на затvorskata policija"), A1 On, 27 korrik 2022, <https://a1on.mk/macedonia/po-skratena-postapka-kje-se-donesat-zakonite-za-zgolemuvanje-na-platite-vo-sudstvoto-obvinitelstvata-i-na-zatvorskata-policija/>.

101 "Detajet nga seanca e 140-të e Komisionit Juridik Ligjvënës", („Детали на седница 140 на Законодавно-правната комисија"), Uebfaqja zyrtare e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 28 korrik 2022, <https://www.sobranie.mk/detali-na-komisiska-sednica.aspx?sittingId=c871b7d3-efa9-47c8-a0b3-9c8590859141>.

102 Ndryshimet e përcaktuara ligjore u miratuan në seancën e 82-të të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, me procedurë të shkurtuar, e cila u mbajt më 03.11.2022. „U miratuan ligjet për shërbimin gjyqësor, prokurorial publik dhe ekzekutimin e sanksioneve", („Донесени законите за судска, јавнообвинителска служба и за извршување санкции"), Nezavisen, 3 nëntor 2022, <https://nezavisen.mk/doneseni-zakonite-za-sudska-javnoobvinitelaska-sluzhba-i-za-izvrshuvanje-sankcii/>.

në Strategjinë dhe Planin e veprimit për miratimin e këtyre ndryshimeve ligjore janë tejkaluar prej kohësh.

Me qëllim përmirsimin e profesionalizimit dhe kompetencës së gjyqtarëve, si dhe në drejtim të kryerjes së duhur të detyrave gjyqësore, është e nevojshme që gjyqtarët t'i drejtohen më shpesh Trupit Këshillëdhënës të Etikës Gjyqësore.¹⁰³ Që nga themelimi i tij në kuadër të Shoqatës së Gjyqtarëve,¹⁰⁴ deri në shtator 2022, Trupi Këshillëdhënës ka pranuar vetëm katër kërkesa për mendime këshilluese.¹⁰⁵ Me qëllim të përmirësimit të dukshmërisë për gjyqtarët dhe juristët, por edhe për publikun e gjerë, Trupi Këshillëdhënës i Etikës Gjyqësore në korrik 2022 ka promovuar edhe faqen www.sudiskaetika.mk, e cila është e shoqëruar edhe me profile në rrjetet sociale.¹⁰⁶

AKMIS dhe dixhitalizimi i gjyqësorit

Procesi i dixhitalizimit në gjyqësor është zbatuar në 12 muajt e fundit përmes Këshillit për koordinimin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit në organet gjyqësore (Këshilli i TIK) pranë Ministrisë së Drejtësisë. Në periudhën raportuese, në përputhje me Planin operativ për Dixhitalizimin e Organeve Gjyqësore, Këshilli i TIK përfundoi procesin e konsultimit dhe punoi për operacionalizimin e aktiviteteve për ndërlidhjen dhe shkëmbimin e të dhënave ndërmjet institucioneve gjyqësore dhe organeve dhe institucioneve shtetërore nëpërmjet Platformës Kombëtare për Interoperabilitet.¹⁰⁷ Më konkretisht, Ministria e Drejtësisë ka nënshkruar marrëveshje për interoperabilitet me nëntë organe dhe institucione shtetërore, të cilat në baza ditore realizojnë 50% të shkëmbimit të të dhënave me gjykatat – Ministrinë e Punëve të Brendshme, Prokurorinë Publike të Kosovës, Republikën e Maqedonisë së Veriut, Regjistrin Qëndror, Administratën Doganore, Komisionin Shtetëror Zgjedhor, Autoritetin e Policisë Financiare, Autoritetin për Inteligjencë Financiare, Komisionin Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit dhe Agjencinë e Aviacionit Civil.¹⁰⁸ Gjithashtu, në bashkëpunim me Misionin e OSBE-së në Shkup, pajisjet për gjykime online janë instaluar edhe në gjykatat e tjera

103 "Trupi Këshillëdhënës i Etikës Gjyqësore ka zhvilluar vetëm dy procedura për gjyqtarë", („Советодавното тело за судска етика спровело само две постапки за судии“), 24 Vesti, 22 shkurt 2022, <https://24.mk/details/sovetodavno-telo-za-sudska-etika-sprovelo-samo-dve-postapki-za-sudii>.

104 Për zbatimin e vazhdueshëm të parimeve të Kodit të Etikës Gjyqësore, Shoqata e Gjyqtarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut themloi një trup këshillues, i cili me kërkesë të gjyqtarëve ose Shoqatës së Gjyqtarëve u shpreh mendime këshilluese gjyqtarëve në Maqedoninë e Veriut në lidhje me një ose më shumë çështje që lidhen me sjelljen etike, pra kryerjen e duhur të detyrave gjyqësore dhe shmangien e konfliktit të interesit të gjyqtarëve në jetën e tyre private dhe ushtrimin e funksionit të tyre gjyqësor.

105 "Pyetje dhe përgjigje", („Поставени прашања и одговори“), Faqja zyrtare e Trupit Këshillëdhënës i Etikës Gjyqësore, <https://sudiskaetika.mk/#sudija>.

106 Konferenca "Funksionalizimi dhe operacionalizimi i Trupit Këshillëdhënës i Etikës Gjyqësore në Maqedoninë e Veriut", („Функционализација и операционализација на Советодавното тело за судска етика во Северна Македонија“), Faqja zyrtare e Shoqatës së Gjyqtarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 14 korrik 2022, <https://bit.ly/3UB6LrG>.

107 Peter Rajshedtter et al., „Komiza Kombëtare për Interoperabilitet në Maqedoni (KKIM) për shërbimet publike maqedonase“, („Македонска рамка за интероперабилност (МРВИ) за македонските јавни услуги“), 2016, https://mioa.gov.mk/sites/default/files/pbl_files/documents/Macedonian_Interoperability_Framework.pdf 0MIF_mk.v2.

108 „Tupancski: Përkushtimi për një gjyqësor modern dhe efikas, ngadalë por me siguri po jep rezultate“ („Тупанцки: Заложбата за модерно и ефикасно судство, полака но сигурно, дава резултати“) Uebfaqja zyrtare e Ministrisë së Drejtësisë, 10 mars 2022, <https://www.pravda.gov.mk/vest/6320>.

themelore pilot në Strumicë, Shtip, në Gjykatën Penale të Shkupit dhe në Gjykatën Civile të Shkupit.¹⁰⁹

Me qëllim që procesi i dixhitalizimit të ecë pa probleme, si dhe funksionimi i sistemit AKMIS me të gjitha përmirësimet, Gjykata Supreme ka lidhur kontratën për blerjen e serverëve të rinj për gjykatat në RMV, të cilët do të zëvendësojnë serverët ekzistues që ishin blerë në periudhën 2006-2010.¹¹⁰ Krahas kësaj, Këshilli Buxhetor Gjyqësor, me kërkesë të KGJRMV, mori vendim për ndarjen shtesë të mjeteve të nevojshme për vazhdimin e prokurimit publik të pajisjeve informatike për gjykatat dhe KGJRMV.¹¹¹

Me aplikimin e Ligjit për Dokumente Elektronike, Identifikim Elektronik dhe Shërbime të Besueshme¹¹², si dhe me bashkimin e gjykatave në Portalin e Shërbimeve Kombëtare, është ofruar shërbimi dixhital për personat fizikë dhe juridikë për lëshimin e certifikatave nga regjistri penal, i cili gjendet në Portalin Kombëtar uslugi.gov.mk.¹¹³ Në periudhën e ardhshme pritet të prezantohet edhe shërbimi i shpallur dixhital për dhënien e certifikatave nga regjistri penal, si dhe lëshimi i vërtetimit se nuk është vendosur sanksion, ndalesë për ushtrimin e profesionit, veprimtarisë apo detyrës.¹¹⁴ Në bazë të nenit 12 të Ligjit për Menaxhimin e Lëvizjes së Lëndëve,¹¹⁵ ka filluar edhe procesi për zhvillimin e zgjidhjes softuerike për publikimin e vendimeve dhe njoftimeve në uebfaqen e gjykatës në përputhje me propozim konkluzionet për shumën e kompensimit.¹¹⁶ Vazhdimisht po zhvillohen edhe aktivitete në kuadër të procesit të dixhitalizimit dhe dhënies së urdhrave gjyqësorë elektronik për zbatimin e masave të posaçme hetimore, monitorimin dhe regjistrimin e komunikimeve telefonike dhe komunikimeve të tjera elektronike, në bashkëpunim me Agjencinë Operative Teknike në gjashtë gjykatat themelore dhe shtatë prokuroritë themelore publike.¹¹⁷ Megjithatë, procesi i dixhitalizimit të gjyqësorit zhvillohet në mënyrë pjesërisht transparente dhe gjithëpërfshirëse. Duhet transparencë më e madhe në raportimin e procesit dhe hapave

109 „Tupaŋeski: Nga sot gjykimet online po bëhen realitet edhe për gjyqësorin e Maqedonisë“, („Тупанчески: Од денес онлајн судењата стануваат реалност и за македонското судство“), Uebfaqja zyrtare e Ministrisë së Drejtësisë, 02.03.2022, <https://www.pravda.gov.mk/vest/6316>.

110 „Gjykata Supreme ka lidhur marrëveshje me Neokomin në vlerë prej 705,1 mijë euro“, („Врховен суд склучи договор со Неком вреден 705,1 илјади евра“), EMagazin, 20 maj 2022, <https://emagazin.mk/vrhoven-sud-skluchi-dogovor-so-neokom-vreden-705-1-il-adi-evra/>.

111 „Njoftim nga seanca e 182-të e Këshillit Buxhetor Gjyqësor – 16.06.2022“, („Соопштение од 182-та седница на Судски буџетски совет – 16.06.2022 година“), Faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, <https://bit.ly/3Dm14XB>.

112 „Ligji për dokumente elektronike, identifikim elektronik dhe shërbime të besueshme“, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 101/2019; 275/2019.

113 „Lëshimi i vërtetimit nga regjistri penal për persona fizikë përmes Portalit Kombëtar për shërbime elektronike“, („Издавање потврда од казнена евиденција за физички лица преку Националниот портал за e-uslugi“), Akademik, 15 nëntor 2021, <https://akademik.mk/izdavane-potvrda-od-kaznena-evidentsija-za-fizicki-litsa-preku-natsionalniot-portal-za-e-uslugi/>.

114 „Qytetarët do të mund të përdorin shërbimet dixhitale të gjykatave për lëshimin e certifikatave“, („Граѓаните ќе можат да користат дигитални услуги на судовите за издавање на уверенија“), Akademik, 7 tetor 2021, <https://akademik.mk/graganite-ke-mozhat-da-koristat-digitalni-uslugi-na-sudovite-za-izdavane-na-uvereniya/>.

115 „Ligji për menaxhimin e lëvizjes së lëndëve“, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 42/2020.

116 Ardita Abazi Imeri et al., „Analizë – Vlerësim gjithëpërfshirës i zbatimit të Strategjisë për reformën e Sektorit Gjyqësor 2017–2022“, („Анализа – Сеопфатна оценка на спроведувањето на Стратегијата за реформа на правосудниот сектор 2017–2022“), (Instituti për Politikë Evropiane – Shkup, 10 nëntor 2022), <https://bit.ly/3X2nox8>.

117 Ibid.

të ndërmarrë, si dhe përfshirjen në proces të organizatave civile që janë të përfshira drejtpërdrejt në reformën në gjyqësor.¹¹⁸

Sipas raporteve¹¹⁹ dhe planit për mbikëqyrje mbi funksionalitetin e AKMIS-it,¹²⁰ mbikëqyrja e funksionimit të AKMIS-it kryhet rregullisht. Gjegjësisht, sipas të dhënave të publikuara nga Ministria e Drejtësisë, në gjykata për vitin 2021 është kryer mbikëqyrja e shtatë gjykatave,¹²¹ dhe deri në shtator 2022 është bërë mbikëqyrja e pesë gjykatave.¹²² Po ashtu, në raportin vjetor për zbatimin e Strategjisë së Ministrisë së Drejtësisë për vitin 2021, vërehet se mbikëqyrje të rregullta japin rezultate, përkatësisht se është shënuar progres në organizimin e gjykatave rreth sistemit AKMIS.¹²³ Dobësitë e vëna re janë kryesisht për shkak të vjetërsimit të sistemit, i cili ka nevojë për ndërhyrje më të mëdha.¹²⁴ Për shkak të kapacitetit të ulët të serverit, nuk ekziston mundësia e kërkimit të lëndëve, pra bazës së të dhënave për lëvizjen e lëndëve dhe të njëjtat ruhen sipas metodave lokale.¹²⁵ Për këtë qëllim, është e nevojshme të analizohet aplikimi aktual i sistemit AKMIS dhe të përcaktohet nëse duhet të futet një sistem i ri softuer ose të përmirësohet ai ekzistuesi. Në këtë drejtim, sistemi AKMIS duhet të harmonizohet me kornizën e re ligjore për punën e organit për menaxhimin e lëvizjes së lëndëve dhe rregullat për monitorimin dhe vlerësimin e punës së gjyqtarëve.

118 Ibid.

119 „Procesverbale nga këqyrje në gjykata”, („Записници од увид во судови”), Faqja zyrtare e Ministrisë së Drejtësisë, <https://www.pravda.gov.mk/resursi/22>.

120 Planit i mbikëqyrjes 08-1001/1 nga 12.02.2020 dhe Planit i mbikëqyrjes 08-33/4 nga 31.01.2022.

121 Ministria e Drejtësisë, „Raporti vjetor i zbatimit të Strategjisë për Reformën e Sektorit Gjyqësor 2017-2022 për vitin 2021”, („Годишен извештај за имплементација на Стратегијата за реформа на правосудниот сектор 2017-2022 за 2021 година”), 2022, <https://bit.ly/3h0YezG>.

122 „Procesverbale nga këqyrje në gjykata”.

123 Ibid.

124 „Diskutim për Raportin në hije për kapitullin 23 për periudhën tetor 2021 – shtator 2022”, („Дискусија за Извештајот во сенка за Поглавје 23 за периодот октомври 2021 – септември 2022 година”), Uebfaqja zyrtare e Institutit për Politikë Evropiane – Shkup, 25 nëntor 2022, <https://epi.org.mk/post/22609>.

125 Ibid.

Krahas kornizës ligjore të vendosur që së bashku me Kushtetutën e RMV-së garantojnë, para së gjithash, pavarësinë e gjyqësorit dhe parimin e ndarjes së pushtetit, besimi i qytetarëve tek gjyqësori nuk është në nivelin më të lartë, siç tregohet nga hulumtimi i fundit i Barometrit Ballkanik, ku krahasuar me vitin paraprak, Maqedonia e Veriut ka shënuar rritje të mosbesimit me 3%. As besimi në prokurorinë publike nuk është i lartë. Pushteti legjislativ, pushteti ekzekutiv, media dhe Këshilli Gjyqësor luajnë një rol kyç në forcimin e besimit të qytetarëve tek gjyqësori, duke inkurajuar transparencën e proceseve gjyqësore, zbatimin e vendimeve dhe duke ruajtur kështu besimin e publikut në pavarësinë dhe paanshmërinë e gjyqësorit.

Këshilli Gjyqësor plotëson kushtet bazë për funksionim publik dhe transparent të secancave të tij, por ende vazhdon praktika e marrjes së vendimeve për zgjedhjen dhe shkarkimin e gjyqtarëve pa argumentime dhe pas detyrë të mbyllura.

Publikimi i vendimeve të arsyetuara për zgjedhjen, ngritjen në detyrë dhe shkarkimin e prokurorëve publikë, si dhe vendimet e tjera të Këshillit të Prokurorëve Publikë, është i një rëndësie të veçantë për kthimin e besimit të qytetarëve në prokurorinë publike. Nevojitet transparencë aktive edhe në pjesën e marrëdhënieve me publikun dhe publikimin e informacionit në lidhje me aktivitetet e përditshme të Këshillit të Prokurorëve Publikë për afrimin e punës së këshillit me publikun dhe afirmimin e kompetencave të këshillit.

Nevojitet rritje e buxhetit të gjyqësorit dhe prokurorisë publike. Masat në Strategji, të cilat parashikojnë rritje të buxhetit të gjykatës, ende nuk janë përmbyllur. Ligji për buxhetin gjyqësor në lidhje me ndarjen e PKB-së për gjyqësorin nuk zbatohet prej vitesh. Gjyqtarët pajtohen që gjyqësori duhet të ketë buxhetin dhe sistemin e tij të trezorit me një organ që do të vendosë për punësimet dhe nevojat në gjyqësor. Kjo do të arrinte një pavarësi më të madhe në gjyqësor, dhe prokurimi dhe punësimi aktual do të kryheshin pa miratimin e pushtetit ekzekutiv.

Nevojitet të rriten pagat e gjyqtarëve dhe prokurorëve, e tëra me qëllim për të marrë paga të vazhdueshme që korrespondojnë me funksionin dhe kryerjen e kompetencave të tyre.

Procesi i dixhitalizimit të gjyqësorit, si një nga proceset më domethënëse të reformës në drejtësi, zhvillohet në mënyrë pjesërisht transparente dhe gjithëpërfshirëse. Nevojitet një transparencë më e madhe në raportimin e procesit dhe hapave të ndërmarrë, si dhe përfshirjen në proces të organizatave civile që janë të përfshira drejtpërdrejt në reformën në gjyqësor dhe që aktualisht mungojnë.

Nevojitet të analizohet aplikimi aktual i sistemit AKMIS dhe të përcaktohet nëse duhet të futet një sistem i ri softuer ose të përmirësohet ai ekzistuesi. Në këtë drejtim, sistemi AKMIS duhet të harmonizohet me kornizën e re ligjore për punën e organit për menaxhimin e lëvizjes së lëndëve dhe rregullat për monitorimin dhe vlerësimin e punës së gjyqtarëve. Gjithashtu nevojitet të krijohet dhe vendoset një zgjidhje softuerike për menaxhimin e automatizuar të lëndëve në Prokurorinë Publike që do të përmirësojë efikasitetin në trajtimin e padive penale, monitorimin e procesit të hetimit dhe ndjekjes penale dhe do të mundësojë qasjen dhe përpunimin e të dhënave.

PËRGJEGJËSI

Siç është theksuar në raportin e mëparshëm në hije,¹²⁶ ndryshimet në Ligjin për Gjykatat,¹²⁷ të vitit 2019 në lidhje me bazat e përgjegjësisë së gjyqtarëve janë në funksion të forcimit të pavarësisë së gjyqtarëve dhe gjyqësorit. Ndryshimet synojnë përmbushjen e rekomandimeve të dhëna në raportin e GRECO,¹²⁸ të vitit 2018, si dhe masat e përcaktuara në Strategjinë për Reformën e Sektorit Gjyqësor 2017-2022.¹²⁹ Gjithashtu, këto ndryshime janë miratuar nga Komisioni i Venecias.¹³⁰ Me to, kryhet shkallëzim i arsyeve për shkarkim,¹³¹ ku merret parasysh pesha e shkeljes së kryer dhe faji i gjyqtarit. Nga analiza e dispozitave ligjore, mund të konsiderohet se është braktisur koncepti i dënimit të ashpër të gjyqtarëve me shkarkim për shkak të punës së tyre jo-efikase dhe joprofesionale. Ligji për Këshillin Gjyqësor i vitit 2019 zbaton rekomandimet e bëra nga Komisioni i Venecias në fushën e përgjegjësisë.¹³² Ai definon procedurën për përcaktimin e përgjegjësisë së kryetarëve dhe gjyqtarëve, si dhe arsyet për procedurë disiplinore për një anëtar të Këshillit dhe për procedurën.¹³³ Me Ligjin për Këshillin Gjyqësor, për herë të parë u dha mundësia që gjyqtarët të mund të parashtrojnë drejtpërdrejt kërkesë për fillimin e procedurës për përgjegjësi disiplinore ndaj një anëtari të KGJRMV-së të cilin e kanë zgjedhur,¹³⁴ megjithatë, deri më tani nuk është paraqitur asnjë kërkesë për iniciimin e procedurës për përgjegjësi disiplinore ndaj një anëtari të KGJRMV-së.¹³⁵ Sipas ndryshimeve të reja ligjore, në periudhën raportuese janë marrë tri vendime për shkarkimin e gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave.¹³⁶ Nga vendimet për shkarkim, dy vendime i referohen ushtrues të detyrës - kryetarë të gjykatave dhe një vendim i referohet një gjyqtari.¹³⁷ Arsyeja e shkarkimit në dy prej vendimeve është

126 Conevska Vangellova dhe Kamberi, "Raport në hije për kapitullin 23 për periudhën prill 2020- shtator 2021", ("Извештај по сенка за Поглавје 23 за периодот април 2020- септември 2021") (Instituti për Politikë Evropiane - Shkup, 16 dhjetor 2021), <https://bit.ly/3lfn3ir>.

127 Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Gjykatat, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut", nr. 96/2019.

128 Miratuar nga GRECO në seancën e 80-të plenare, "Rundi i katërt i vlerësimit - Parandalimi i korrupsionit në lidhje me deputetët, gjyqtarët dhe prokurorët, raporti i dytë i pajtueshmërisë, Republika e Maqedonisë" ("Четврти круг на евалуација — Превенција на корупцијата во однос на пратениците, судиите и обвинителите, втор извештај за усогласеност, Република Македонија" (2018) <<https://rm.coe.int/-/80-18-22-/16808cc861>> .

129 Ministria e Drejtësisë, "Strategjia për Reformën e Sektorit Gjyqësor për periudhën 2017-2022 me Plan veprimi", ("Стратегија за реформа на правосудниот сектор за периодот 2017-2022 година со акциски план"), https://www.pravda.gov.mk/Upload/Documents/Strategija%20i%20akciski%20plan_MK-web.pdf.

130 Baret et al. (n 76).

131 Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Gjykatat, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut", nr. 96/2019.

132 "Ligji për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut", Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut", nr. 102/2019.

133 Ibid.

134 Një kërkesë të tillë mund të parashtrojnë të paktën 20 gjyqtarë ose secili anëtar i KGJRMV me të drejtë vote, nëse anëtar i KGJRMV: ndikon në pavarësinë e gjyqtarëve dhe ushtron presion në lidhje me vendimarrjen për lëndë të caktuara; neglizhon dhe nuk e kryen funksionin e tij në punën e KGJRMV; nëse ai refuzon të paraqesë një deklaratë të gjendjes pasurore dhe interesave në përputhje me ligjin ose nëse të dhënat e përfshira në deklaratë janë kryesisht të pavërteta ose shkelin rregullat për përjashtim në situata në të cilat anëtar i KGJRMV ka pasur në dijeni ose duhet të ketë pasur në dijeni ekzistencën e ndonjëres prej shkaqeve të përjashtimit të parashikuara në këtë ligj. Anëtar i KGJRMV shkarkohet nga detyra nëse shkelja është kryer me dashje ose me pakujdesi të dukshme me faj të anëtarit të KGJRMV-së pa arsye të justifikuar dhe/ose shkelja ka sjellë pasoja të rënda.

135 Ardita Abazi Imeri et al., "Analizë - Vlerësim gjithëpërfshirës i zbatimit të Strategjisë për Reformën e Sektorit Gjyqësor 2017-2022", ("Анализа — Сеопфатна оценка на спроведувањето на Стратегијата за реформа на правосудниот сектор 2017-2022"), (Instituti për Politikë Evropiane - Shkup, 10 nëntor 2022), <https://bit.ly/3X2nox8>.

136 Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut, "Përgjigje ndaj kërkesës për qasje të lirë në informacione publike", 28 nëntor 2022.

137 Ibid.

kryerja joprofesionale dhe e pakujdesshme e funksionit - tejkalimi dhe shkelja e kompetencave ligjore, ndërsa në vendimin e tretë, arsye për shkarkim është shkelje më e rëndë disiplinore.¹³⁸ Përveç kësaj, në periudhën raportuese, KGJRMV përcaktoi përgjegjësi disiplinore për tre gjyqtarë, përkatësisht një masë disiplinore - gjobë për kryetarin e gjykatës, një masë disiplinore - gjobë për një gjyqtar dhe një masë disiplinore - vërejtje me shkrim për një gjyqtar.¹³⁹ Në këtë drejtim, Këshilli për vendimmarrje për apele pranë Gjykatës së Lartë të Republikës së Maqedonisë së Veriut konfirmoi 2 vendime të KGJRMV-së nga tri apelet e pranuar nga gjyqtarët për të cilët ishte iniciuar procedurë për përcaktimin e përgjegjësisë dhe një vendim është kthyer për rivendim.¹⁴⁰ Gjithashtu, në nëntë muajt e parë të vitit 2022, KGJRMV nuk ka iniciuar procedurë për përcaktimin e përgjegjësisë disiplinore për gjyqtarë dhe/ose kryetar të gjykatës.¹⁴¹

Në periudhën raportuese, KGJRMV ka vepruar mbi 570 parashtresa nga qytetarët dhe personat juridikë për punën e gjykatave, kryetarëve të gjykatave dhe gjyqtarëve.¹⁴² Nga analizat e bëra të pretendimeve si bazë për paraqitjen e parashtresave, doli se shumica e parashtresave të paraqitura të diskutuara nga KGJRMV kanë të bëjnë me mënyrën e zhvillimit të procedurës nga ana e gjyqtarëve, periudhën kohore të zhvillimit të procedurës, veprimet joprofesionale dhe të pakujdesshme.¹⁴³ Mirëpo, nga numri i përgjithshëm i parashtresave që janë shqyrtuar në seancat e KGJRMV-së, vetëm 2,5% e tyre janë miratuar si të arsyeshme nga KGJRMV.¹⁴⁴ Numri më i madh i parashtresave rrëzohen ose refuzohen si të paarsyeshme.¹⁴⁵ Nga ana e KGJRMV-së, si arsyetim të kësaj situate tregohet fakti se qytetarët theksojnë pretendime në ankesa dhe i referohen gjendjes aktuale, dhe jo punës së gjyqtarëve.¹⁴⁶ Konkretisht, qytetarët besojnë se Këshilli Gjyqësor përfaqëson një lloj gjykate të shkallës më të lartë dhe në vend që të vënë në dukje pretendimet për punën e gjyqtarëve, të pakënaqurit me vendimin e gjyqtarëve sërish i vënë në dukje pretendimet në ankesat e parashtruara në procedurë.¹⁴⁷ Pra, është e qartë se me kalimin e viteve gjithmonë mbizotëron i njëjti problem, domethënë qytetarët nuk e kuptojnë konceptin dhe rolin e parashtresave, kështu që në atë drejtim është e nevojshme të shtohet përpjekja për edukimin e qytetarëve, se si mund ta shfrytëzojnë këtë mekanizëm në mënyrë të duhur. Ndryshe, mbetet përshtypja se paraqitja e parashtresës në Këshillin Gjyqësor është e kotë, duke qenë se të gjitha

138 Ibid.

139 Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut, "Përgjigje ndaj kërkesës për qasje të lirë në informacione publike", 16 nëntor 2022.

140 Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, "Përgjigje ndaj kërkesës për qasje të lirë në informacione publike", 7 nëntor 2022.

141 Ibid.

142 Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut, "Përgjigje ndaj kërkesës për qasje të lirë në informacione publike", 28 nëntor 2022.

143 Ibid.

144 Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut, "Përgjigje ndaj kërkesës për qasje të lirë në informacione publike", 21 dhjetor 2022.

145 Ibid.

146 "Diskutim për Raportin në hije për kapitullin 23 për periudhën tetor 2021 – shtator 2022," („Дискусија за Извештајот во сенка за Поглавје 23 за периодот октомври 2021 – септември 2022 година."), Uebfaqja zyrtare e Institutit për Politikë Evropiane – Shkup, 25 nëntor 2022, <https://epi.org.mk/post/22609>.

147 Ibid.

parashtresat refuzohen, duke ulur kështu besimin në gjyqësor.¹⁴⁸ Në lidhje me mënyrën se si KGJRMV vepron në lidhje me parashtresat, praktika e referimit të parashtresës nga një anëtar i Këshillit me disa fjali pa hyrë në pjesën thelbësore dhe arsyet pse parashtresa konsiderohet e arsyeshme ose e paarsyeshme dhe më pas e njëjta miratohet njëzëri nga anëtarët e KGJRMV-së sipas propozimit të raportuesit që e referon parashtresën.¹⁴⁹

Ligji për Prokuroritë Publike i vitit 2020 solli ndryshime pozitive në bazat për ndërprerjen, shkarkimin dhe përgjegjësinë disiplinore të prokurorëve publikë.¹⁵⁰ Ashtu si me ndryshimet në Ligjin për Gjykatat, ky ligj gradon arsyet e shkarkimit, më saktë varion nga një shkelje e lehtë në një shkelje më të rëndë disiplinore, me masë disiplinore ndaj prokurorit publik, në vend të shkarkimit.¹⁵¹ Sa i përket shkaqeve për shkarkimin e prokurorëve publikë, merret parasysh edhe pesha e shkeljes së kryer dhe fajësia e prokurorit publik.¹⁵² Ligji përcakton edhe mënyrën e fillimit të procedurës për përcaktimin e përgjegjësisë së prokurorëve publikë për shkelje të kryer disiplinore,¹⁵³ si dhe shumicën e nevojshme me të cilën KPPRMV mund të shkarkojë prokurorët.¹⁵⁴ Sa i përket procedurës, rregullorja për zbatimin e procedurës për përcaktimin e përgjegjësisë së prokurorit publik, me propozim të prokurorit publik të RMV-së, miratohet nga KPPRMV.¹⁵⁵

Sipas ndryshimeve ligjore, në periudhën raportuese vazhdon trendi rritës i parashtresave të paraqitura në KPPRMV.¹⁵⁶ Domethënë, në vitin 2021 ka pasur 231 parashtresa, që krahasuar me vitin 2020, paraqet një rritje të vëllimit të punës prej 8,65%.¹⁵⁷ Shumica e parashtresave janë dorëzuar nga personat e dëmtuar për shprehjen e pakënaqësisë së tyre me kohëzgjatjen e procedurës dhe mosveprimi në kohë nga ana e prokurorit publik që ka vepruar në një lëndë konkrete, si dhe vendimet e prokurorit publik për

148 Emilia Spasovska, "Raport nga monitorimi i Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë në vitin 2022" (Koalicioni "Të gjithë për gjykim të drejtë", 2022).

149 Ibid.

150 "Ligji për Prokurorinë Publike", Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 42/2020.

151 Ibid.

152 Prokuror publik mund të shkarkohet për shkak të një procedure më të rëndë disiplinore dhe anëtarësimit në parti politike.

153 Ndryshe nga Ligji për Këshillin Gjyqësor, ku kërkesë për fillimin e procedurës për përcaktim të përgjegjësisë për gjyqtar apo kryetar të gjykatës mund të parashtrohet nga kushdo, Ligji për Prokurorinë Publike parasheh që procedura për përcaktimin e përgjegjësisë së prokurorëve publik për shkelje të kryer disiplinore kryhet pas propozimit të arsyetuar të prokurorit publik të RMV për të gjithë prokurorët publik dhe pas propozimit të arsyetuar të prokurorit të lartë publik të Prokurorisë së Lartë Publike për prokurorët publik në Prokurorinë e Lartë Publike, për prokuror themelor publik të Prokurorisë Publike Themelore dhe për prokurorët publikë në Prokurorinë Themelore Publike, pas kryerjes së detyrës zyrtare ose pas marrjes së djes për shkelje të kryer. Drejt propozimit për fillimin e procedurës disiplinore, kërkesi është i detyruar të paraqesë dëshmi për shkeljen e kryer disiplinore.

154 Për dallim nga Ligji për Këshillin Gjyqësor, ku procedura zhvillohet në KGJRMV, në prokurorinë publike procedura për përcaktimin e përgjegjësisë së prokurorit publik në kryerjen e funksionit prokurorial e zhvillon komisioni i pesë anëtarëve ose zëvendësit e tyre, njëri prej të cilëve është nga prokuroritë më të larta publike dhe një anëtar nga PPRMV, të zgjedhur nga kolegjiunet e këtyre prokurorëve.

155 "Ligji për Prokurorinë Publike", Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 42/2020.

156 Këshilli i Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut, «Raporti vjetor për punën e Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2021».

157 Ibid.

refuzimin e rastit.¹⁵⁸ Ndryshe nga viti 2020, ka më pak parashtresa në të cilat personat e dëmtuar shprehin pakënaqësi për shkak të mosmarrjes së njoftimit për rrjedhën e procedurës pranë prokurorisë publike për një periudhë më të gjatë.¹⁵⁹ Në lidhje me trajtimin e parashtresave gjatë seancave, nga ana tjetër, mund të thuhet se KGJRMV rrallë paraqet, shpjegon apo drejton ndonjë lloj diskutimi në lidhje me një parashtresë gjatë seancave.¹⁶⁰ Gjithashtu, në raportet vjetore të Këshillit thuhet vetëm numri i parashtresave të paraqitura në nivel vjetor, por nuk thuhet se sa prej atyre parashtresave janë pranuar si të arsyeshme dhe sa janë refuzuar. Do të ishte e dëshirueshme që në të ardhmen të përfshihen këto shifra në raporte në mënyrë që të mund të analizohet nëse veprohet mbi parashtresat në përgjithësi dhe cili është rezultati, dhe nëse ato refuzohen, të shihet arsyeja e refuzimit të tyre. Po ashtu, në Raportin Vjetor të KPPRMV-së për vitin 2021, konstatohet vonesë me një pjesë të madhe të raporteve të dorëzuara nga prokuroritë më të larta publike nga mbikëqyrja e punës së prokurorëve publikë të përmendur në prokuroritë publike më të ulëta drejt të cilëve referohen parashtreat, me qëllim të kontrollit të pretendimeve të dorëzuara.¹⁶¹ Vonesa e raporteve ka të bëjë veçanërisht me PPRMV-në, e cila deri më 31 dhjetor 2021 nuk ka paraqitur raport pas 50 parashtresave.¹⁶²

Përveç numrit të parashtresave të paraqitura, KPPRMV gjatë periudhës raportuese ka zhvilluar edhe katër procedura disiplinore, nga të cilat një prokurorë publike është shkarkuar.¹⁶³ Në bazë të procesverbalit të publikuar, procedura për përcaktimin e përgjegjësisë është iniciuar me kërkesë të Prokurorit Publik të RMV për tri shkelje të rënda disiplinore.¹⁶⁴ Me propozimin e Komisionit për përcaktimin e përgjegjësisë disiplinore të prokurorit publik në kryerjen e funksionit të prokurorisë publike, të gjithë anëtarët e KPPRMV-it njëzëri morën vendim për shqiptimin e masës së shkarkimit nga detyra të prokurorit publik.¹⁶⁵

158 Ibid.

159 Ibid.

160 Emilia Spasovska, "Raport nga monitorimi i Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë në vitin 2022" (Koalicioni "Të gjithë për gjykim të drejtë", 2022).

161 Ibid.

162 Ibid.

163 Këshilli i Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, "Përgjigje ndaj kërkesës për qasje të lirë në informacione publike", 9 nëntor 2022.

164 Gjegjësisht, prokurorja publike ka shkuar në vendin e ngjarjes pasi është njoftuar për veprën e kryer, por nuk ka kryer këqyrje e as ka përgatitur procesverbal, ka hyrë në konflikt me punonjësit e policisë dhe më pas ka pasur komunikim të papërshtatshëm me kryeministrin e atëhershëm të Qeverisë. Gjithashtu, në vitin 2018, prokurorja publike në tri raste ka refuzuar padi penale, përkundër udhëzimeve të PPL Gostivar për vazhdimin e procedurës penale për shkak se vepra penale nuk është vjetruar, pas së cilës prokurorja ka lëshuar urdhër penal, pas së cilës është marrë vendim gjyqësor. Pas paraqitjes së kundërshtimit është caktuar seanca kryesore në të cilën pas paraqitjes së provave prokurorja publike pa ndryshim të gjendjes faktike ka hequr dorë nga ndjekja penale për shkak të vjetritimit relativ që ka rezultuar me aplikimin e gabuar të dispozitave të Kodit Penal në dëm të viktimës dhe në doli të të akuzuarit. Emilia Spasovska, "Raport nga monitorimi i Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë në vitin 2022" (Koalicioni "Të gjithë për gjykim të drejtë", 2022).

165 "Këshilli i Prokurorëve Publikë shkarkoi prokurorët Lejla Kadriu dhe Mile Arsenievski, i cili vetë kërkoi ndërprerjen e detyrës", („Советот на јавни обвинители ги разреши обвинителите Лејла Кадриу и Миле Арсениевски кој сам побарал прекин на функцијата") TV Telma, 29 mars 2022, <https://bit.ly/3YU5hfk>.

Procedurat e tjera disiplinore janë rezultat i procedurës së nisur nga Prokuroria Publike Republikenë pas padisë penale të Drejtorisë së Policisë Financiare¹⁶⁶ për bastisjen që hetuesit nga PTHPNKOK kanë kryer më 18 gusht 2022 në hapësirat e institucionit.¹⁶⁷ Gjegjësisht, pas mbikëqyrjes dhe këqyrjes së rastit, është konstatuar se me veprimin e padisë anonime penale, të cilën PTHPNKOK e ka pranuar në maj të vitit 2022, është cenuar kompetenca horizontale dhe organizimi i Prokurorisë Publike.¹⁶⁸ Domethënë, pasi që padia e pranuar penale u referohet personave nga Drejtoria e Policisë Financiare, të cilët në pajtim me nenin 33 paragrafi 2 të Ligjit për Prokuroritë Publike kanë kompetenca policore, pas atyre padive kompetenca për të vepruar i bie Departamentit të Specializuar për ndjekjen e krimeve të kryera nga personat me kompetenca policore dhe anëtarë të policisë së burgjeve.¹⁶⁹ Rrjedhimisht, tri prokuroret publike nga PTHPNKOK, të cilat kanë vepruar në këtë rast, dhe nuk janë pjesë e Departamentit të Specializuar, kanë vepruar pa autorizim në padinë penal.¹⁷⁰ Gjithashtu, me mbikëqyrjen, Prokuroria Publike e Republikës ka konstatuar se kërkesa për lëshimin e urdhrat për bastisje e dorëzuar në Gjykatën Themelore Penale Shkup është e pabazë.¹⁷¹ Pas kësaj, ndaj tre prokuroreve publikë filloi procedura disiplinore, e cila rezultoi me pezullimin e kreut të PTHPNKOK, si njëra prej tyre.¹⁷²

Në periudhën raportuese, sipas një hetimi të publikuar nga Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese (BIRN) Maqedoni, është konstatuar se Gjykata e Apelit në Shkup dhe KG-JRMV kanë vepruar në mënyrë jo të duhur në lidhje me nenin 53 të Ligjit për Këshillin Gjyqësor.¹⁷³ Përkatësisht, sipas hetimit të publikuar nga BIRN, nëntë juristë në Gjykatën e Apelit të Shkupit kanë vazhduar të gjykojnë edhe pas skadimit të mandatit të tyre në prill të vitit 2021.¹⁷⁴ Domethënë, pas një kontrolli është konstatuar se në bazën e të dhënave të Gjykatës së Apelit Shkup ka lëndë nga juritë e përmendur për muajin nëntor dhe dhjetor 2021.¹⁷⁵ Për juristët e përmendur, KGJRMV caktoi ndërprerjen e mandatit

166 "Policia Financiare ka paraqitur parashtrësë në PP për bastisje të hapësirave të saj", („Финансиската полиција поднесе претставка до ЈО за извршениот претрес во нејзините простории“) 360 stepeni, 25 korrik 2022, <https://360stepeni.mk/finansiskata-politsija-podnese-pretstavka-do-jo-za-izvrsheni-pretres-vo-nejzinite-prostorii/>.

167 „Bastisje në Policinë Financiare, Ruskovska nuk zbulon detaje“, („Претрес во Финансиска полиција, Русковска не открива детали“), Radio Slobodna Evropa, 18 korrik 2022, <https://www.slobodnaevropa.mk/a/31948748.html>.

168 "Njoftim", („Соопштение“), Uebfaqja zyrtare e Prokurorisë Publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 1 gusht 2022, <https://jorm.gov.mk/soopshtenie-108/>.

169 Ibid.

170 Ibid.

171 Ibid.

172 "Vilma Ruskovska suspendohet, procedurë disiplinore edhe për dy prokurore", („Вилма Русковска суспендирана, дисциплинска за уште две обвинители“), 16 gusht 2022, <https://netpress.com.mk/vilma-ruskovska-suspendirana-disciplinska-za-ushte-dve-obvinitelki/>.

173 Ligji për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

174 Vasko Magleshev, "Me mandat të skaduar e dhanë drejtësinë për një vit – dhjetëra gjykime të Apelit të Shkupit vëhen në pyetje, njofton BIRN", („Со истечен мандат година дена делене правда- Десетина пресуди на Скопска апелација доведени во прашање, дознава БИРН“), PRIZMA, 5 prill 2022, <https://prizma.mk/so-istechen-mandat-godina-dena-delele-pravda/>.

175 Ibid.

më 29.03.2022,¹⁷⁶ duke theksuar se propozimi për ndërprerjen e mandatit, i paraqitur nga Gjykata e Apelit në Shkup, ka ardhur më 28.03.2022.¹⁷⁷ Gjykata e Apelit në Shkup, nga ana tjetër, nuk ka dhënë përgjigje konkrete për këtë pyetje, por vetëm ka bërë me dije se deri në skadimin e mandatit të jurisë, seancat janë mbajtur me pjesëmarrjen e gjyqtarëve aktivë juristë,¹⁷⁸ që tregon se nuk do të ketë pasoja të lëndëve me kryerjen e shkeljes thelbësore në procedimin e zhvilluar pranë kësaj gjykate. Po ashtu, në raportin e vizitës së punës në Gjykatën e Apelit në Shkup nga ana e Komisionit për Këqyrje të KGJRMV-së, nuk u konstatua asgjë kontestuese në pjesën e jurisë.¹⁷⁹ Sipas raportit, në seancën e mbajtur më 8 qershor 2022, KGJRMV ka miratuar konkluzionet e propozuara nga vizita e punës, të cilat janë në drejtim të udhëzimeve që gjykatat të respektojnë ligjin.¹⁸⁰

176 "Njoftim nga seanca e 398-të e Këshillit Gjyqësor të RMV - 29.03.2022", („Коопштение од 398-та седница на Судскиот совет на РСМ – 29.03.2022 година"), Faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, <https://bit.ly/3UDYH9L>.

177 Vasko Magleshev, "Me mandat të skaduar e dhanë drejtësinë për një vit – dhjetëra gjykime të Apelit të Shkupit vëhen në pyetje, njofton BIRN", („Со истечен мандат година дена делеле правда- Десетина пресуди на Скопска апелација доведени во прашање, дознава БИРН"), PRIZMA, 5 prill 2022, <https://prizma.mk/so-istechen-mandat-godina-dena-delele-pravda/>.

178 Ibid.

179 Vasko Magleshev, "Si e huqi vitin kontrolli i Këshillit Gjyqësor", („Како контролата на Судскиот совет ја утна годината"), PRIZMA, 9 qershor 2022, <https://prizma.mk/kako-kontrolata-na-sudskiot-sovet-ja-utna-godinata/>.

180 "Njoftim nga seanca e 405-të e Këshillit Gjyqësor të RMV - 08.06.2022", („Коопштение од 405-та седница на Судски совет на РСМ – 08.06.2022 година"), Faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, <https://bit.ly/3tbqtyz>.

Këshilli Gjyqësor vazhdon të refuzojë shumicën e parashtresave të qytetarëve, kryesisht për shkak të edukimit të pamjaftueshëm të qytetarëve për qëllimin e parashtresave. Prandaj është e nevojshme të punohet në edukimin e qytetarëve, dhe hap pozitiv në këtë drejtim është aktiviteti i parashikuar në Programin dhe planin e veprimit për parandalimin dhe monitorimin e korrupsionit në gjyqësor për edukimin e qytetarëve përmes broshurave dhe faqes së internetit për mënyrën dhe qëllimin e paraqitjes së parashtresave.

Vazhdoi trendi rritës i parashtresave të paraqitura në Këshillin e Prokurorëve Publikë, por Këshilli nuk luan rol të madh në mbikëqyrjen e punës së prokurorëve publikë, duke pasur parasysh se nëse anëtarët e Këshillit konsiderojnë se parashtresat janë të arsyeshme, thjesht dërgojnë ato te Prokurori Publik i RMV-së, i cili më pas duhet të ndër-marrë veprime për kontrollimin e prokurorëve publik. Nga ana tjetër, edhe Prokuroria Publike ka kompetencë për pranimin e parashtresave nga qytetarët, kështu që shtrohet pyetja, cila është nevoja që të ketë dy institucione kompetente për të vepruar mbi parashtresat? Kjo mund të jetë gjithashtu habitëse për qytetarët që nuk do të dinin se ku të paraqesnin një parashtresë. Në atë drejtim duhet dhënë më shumë kompetencë në trajtimin e parashtresave Këshillit të Prokurorëve Publikë, aq më tepër që është vërejtur se PPRMV nuk u përgjigjet parashtresave të paraqitura dhe në të njëjtën kohë do të ishte më racionale dhe efikase si për qytetarët ashtu edhe për prokurorët publikë, të paraqiten përmes një institucioni.

Është e nevojshme që të dy këshillat të paraqesin, shpjegojnë ose udhëheqin një diskutim në lidhje me parashtresat gjatë seancave, si dhe shpalljen e rezultatit të procedurës pas një parashtrese që është miratuar si e arsyeshme. Kjo do të rriste transparencën në punën e dy këshillave, si dhe besimin e qytetarëve tek gjyqësori.

PROFESIONALIZMI DHE KOMPETENCA

Kuadri ligjor, si dhe garancitë për zbatimin e drejtë të sistemit të meritës, tashmë janë krijuar¹⁸¹ dhe janë shënuar në raportet e mëparshme në hije.

Me qëllim të futjes së një sistemi cilësor të meritës, në përputhje me Ligjin për Këshillin Gjyqësor¹⁸² dhe zbatimin e vazhdueshëm të tij, KGJRMV në periudhat e mëparshme raportuese filloi përgatitjen dhe miratimin e një sërë aktesh nënligjore për përmirësimin e sistemit për vlerësimin e gjyqtarëve. Para së gjithash, u miratua Rregullorja e punës së Këshillit Gjyqësor,¹⁸³ dhe më pas Rregullorja për përzgjedhjen e gjyqtarëve nga radhët e Akademisë së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë,¹⁸⁴ duke specifikuar procedurën e përzgjedhjes dhe Rregulloren për renditjen e kandidatëve për përzgjedhjen e gjyqtarëve në gjykatat më të larta.¹⁸⁵ Me qëllim të vlerësimit objektiv dhe të paanshëm të gjyqtarëve, KGJRMV miratoi Metodologjinë e vlerësimit të punës së gjyqtarit bazuar në përbushjen e kriterëve cilësorë për punën e gjyqtarit dhe Formularin për vlerësimin e përbushjes së kriterëve cilësorë për punën e gjyqtarit.¹⁸⁶ Gjithashtu, miratoi Metodologjinë për vlerësimin cilësor të kryetarëve të gjykatave, Formularin për vlerësimin cilësor të kryetarëve të gjykatave¹⁸⁷ dhe Udhëzimin për mënyrën e llogaritjes së orarit efektiv të punës,¹⁸⁸ dhe më 29 mars 2022 miratoi edhe Rregulloren për themelimin dhe funksionimin e komisioneve të KGJRMV për vlerësimin e rregullt dhe të jashtëzakonshëm,¹⁸⁹ si akt i fundit nënligjor për fillimin e vlerësimit të gjyqtarëve.¹⁹⁰

181 Me miratimin e ndryshimeve dhe plotësimeve të fundit në Ligjin për Gjykatat, Ligjin e ri për Këshillin Gjyqësor, Ligjin për Prokurorinë Publike dhe ndryshimet dhe plotësimet në Ligjin për Këshillin e Prokurorëve Publikë, u krijua një kuadër ligjor që është kryesisht në përputhje me standardet ndërkombëtare në lidhje me përzgjedhjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë bazuar në një sistem meritash. Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë është e vetmja pikë hyrëse për krijimin e personelit të ri në gjyqësor dhe prokurorinë publike. Përsa i përket mbrojtjes ligjore të gjyqtarëve për masa të caktuara që ndërmerren ndaj gjyqtarëve, si një lloj garancie u fut e drejta e apelit në Këshillin e Apelit pranë Gjykatës së Lartë, si në lidhje me (mos)zgjedhjen e gjyqtarëve edhe të kryetarëve të gjykatave ashtu edhe në lidhje me vendimin për vlerësim.

182 Ligji për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, neni 36, paragrafi 1.

183 "Aktet nënligjore", („Подзаконски акти“), Faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, <https://bit.ly/3sMy7iE>.

184 Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut, "Rregullorja për mënyrën e renditjes së kandidatëve për gjyqtarë nga Akademia e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë", („Правилник за начинот на rangiranje на кандидатите за судии од Академијата за судии и јавни обвинители“), 26 dhjetor 2019, <https://bit.ly/3flebe>.

185 Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut, "Rregullat për mënyrën e renditjes së kandidatëve për zgjedhjen e gjyqtarit në gjykatën më të lartë", („Правилникот за начинот на rangiranje на кандидатите за избор на судија во повисок суд“), 4 shkurt 2020, <https://bit.ly/3DqM8aC>.

186 Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut, „Metodologjia për vlerësimin e punës së gjyqtarit në bazë të përbushjes së kriterëve cilësorë për punën e gjyqtarit dhe formularit për vlerësimin e përbushjes së kriterëve cilësorë për punën e gjyqtarit“, („Методологија за оценување на работата на судија врз основа на исполнетост на kualitativните критериуми за судиското работење и Образец за оценување и бодување на исполнетост на kualitativните критериуми за работата на судијата“), 18 dhjetor 2020, <https://bit.ly/3FycwCs>.

187 Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut, „Metodologjia për vlerësimin cilësor të kryetarëve të gjykatave dhe Formulari për vlerësimin cilësor të kryetarëve të gjykatave“, („Методологија за kualitativno оценување на претседателите на судовите и Образец за kualitativno оценување претседателите на судовите“), 18 dhjetor 2020, <https://bit.ly/3WfHN2J>.

188 Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut, „Udhëzime për llogaritjen e orarit efektiv të punës“, („Упатство за начинот на пресметување на ефективни работни часови“), 18 dhjetor 2020, <https://bit.ly/3sLewL0>.

189 Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut, „Rregullat për themelimin dhe funksionimin e komisioneve të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut për vlerësim të rregullt dhe të jashtëzakonshëm“, („Правилник за формирање и работење на komisiите на Судскиот Совет на Република Северна Македонија за редовно и vonredno оценување“), 29 mars 2022, <https://bit.ly/3DMsNSV>.

190 Në këtë drejtim gjatë vitit 2021 është miratuar Metodologjia me tregues për përcaktimin e kompleksitetit të lëndëve dhe Rregullorja për mënyrën e formimit të komisioneve për vlerësimin e punës së gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave.

Me miratimin e akteve nënligjore u plotësua masa për ripërcaktimin e kriterëve për ngritjen në detyrë të gjyqtarëve¹⁹¹ dhe u krijuan kushtet për zbatimin praktik të dispozitave ligjore. Në këtë drejtim, më 5 prill 2022, u formuan komisionet për inspektim dhe vlerësim të gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave për gjykatat themelore, gjykatat e apelit dhe për Gjykatën Administrative, të cilat përbëheshin nga pesë anëtarë dhe që do të bëjnë vlerësimin e rregullt të të gjithë gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave.¹⁹² Në të njëjtën kohë u formuan komisione për vlerësimin e punës së gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave, të cilat duhet të bëjnë një vlerësim të jashtëzakonshëm të kandidatëve që aplikuan për ngritje në detyrë, përkatësisht për kryetar gjykate.¹⁹³ Formimi i komisioneve solli shumë paqartësi në lidhje me funksionimin e tyre praktik dhe për këtë arsye u organizuan takime me ekspertë, të cilët u përfshinë në procesin e zhvillimit të metodologjive,¹⁹⁴ me qëllim zbatimin më të lehtë të tyre dhe njëkohësisht kryerjen e trajnimeve të anëtarëve të komisioneve.¹⁹⁵ KGJRMV i kushtoi një kohë të gjatë aktiviteteve përgatitore për zbatimin e vlerësimit të gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave, gjë që është e kuptueshme, duke qenë se është një proces i ndërlikuar dhe kompleks vlerësimi.¹⁹⁶ Megjithatë, aktet nënligjore nuk e përcaktojnë formën specifike të vendimeve për përzgjedhje dhe ngritje në detyrë të gjyqtarëve.¹⁹⁷ Përmbajtja e tyre, nga ana tjetër, ishte përcaktuar në një farë mënyre në disa rregullore.¹⁹⁸ Sipas kësaj, në çdo vendim për përzgjedhje dhe ngritje në detyrë, duhet theksuar se cilat janë kriteret që e dallojnë gjyqtarin e përzgjedhur apo të avancuar nga kandidatët e tjerë, apo të tregohen poenat apo pikët e marra nga secili kandidat që është përzgjedhur gjyqtar në një gjykatë themelore, pra i avancuar në një gjykatë më të lartë.¹⁹⁹ Gjithashtu, procesi i miratimit të akteve nënligjore dhe të gjitha aktiviteteve të tjera përgatitore në këtë drejtim, nga ana tjetër, ndikoi negativisht në ngritjen në detyrë të gjyqtarëve të cilët iu përgjigjën njoftimeve të shpallura më shumë se një vit më parë, dhe për të cilët procedura ishte filluar në gusht të vitit 2021 dhe që ende nuk është zbatuar plotësisht.²⁰⁰ Kjo vonesë në përzgjedhjen e gjyqtarëve të gjykatave më të larta dhe të kryetarëve të gjykatave u arsyetua me nevojën e kryerjes së një vlerësimi të jashtëzakonshëm

191 Masa 2.2.3.-1, 2.2.3.-2, Ministria e Drejtësisë, "Strategjia për Reforma të Sektorit Gjyqësor për periudhën 2017-2022 me Plan veprimi".

192 "Njoftim nga seanca e 399-të e Këshillit Gjyqësor të RMV - 04.05.2022", („Соопштение од 399-та седница на Судскиот совет на РСМ – 05.04.2022 година"), Faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, <https://bit.ly/3TSVJ13>.

193 Ibid.

194 Instituti për të Drejtat e Njeriut Shkup, "Raport nga monitorimi i punës së Këshillit Gjyqësor Janar-Qershor 2022" („Извештај од следењето на работата на Судскиот совет: јануари-јуни 2022 година"), <https://bit.ly/3liMvYV>.

195 "Trajnim i komisioneve për këqyrje dhe vlerësim të gjyqtarëve", („Обука на комисиите за увид и оцена на судиите"), Faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 19 prill 2022, <https://bit.ly/3Nmy5Yf>.

196 Instituti për të Drejtat e Njeriut Shkup, "Raport nga monitorimi i punës së Këshillit Gjyqësor janar-qershor 2022" („Извештај од следењето на работата на Судскиот совет: јануари-јуни 2022 година"), <https://bit.ly/3liMvYV>.

197 Ibid.

198 Ibid.

199 Ibid.

200 Мë 06 gusht 2021 është shpallur konkursi për përzgjedhjen e gjyqtarëve për Gjykatën Supreme, Gjykatën e Apelit Shkup, Gjykatën e Apelit Gostivari, si dhe përzgjedhjen e gjyqtarëve për Gjykatën Themelore Shtip dhe Gjykatën Themelore Penale Shkup.

të kandidatëve,²⁰¹ duke aplikuar Metodologjinë e vlerësimit cilësor të gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave,²⁰² por nevoja për të plotësuar vendet e zbrazura gjyqësore në gjykata është më se e nevojshme, sidomos pas pensionimit të 42 gjyqtarëve për shkak të hyrjes në fuqi të ndryshimeve në Ligjin për Marrëdhëniet e Punës.²⁰³

Në periudhën raportuese janë zgjedhur 19 prokurorë publikë në prokuroritë e Republikës së Maqedonisë së Veriut.²⁰⁴ Vazhdoi praktika e zgjedhjes së njerëzve pa diskutim, pra vetëm duke votuar “PËR” dhe “KUNDËR”.²⁰⁵ Sa i përket procesit të zgjedhjes së prokurorëve publikë, ai zhvillohet shumë ngadalë, shpesh me shtyrje të seancave kur duhet të bëhen zgjedhje dhe e gjithë kjo në një situatë ku ende ekzistojnë prokurori publikë ku nuk ka asnjë prokuror publik.²⁰⁶ Sa i përket mënyrës së përzgjedhjes dhe ngritjes në detyrë të prokurorëve publik, vazhdon tendenca e KPPRMV në uebsajtin e tij²⁰⁷ të mos publikojë publikisht vendime të arsyetuara për përzgjedhjen dhe ngritjen në detyrë të prokurorëve publikë, me përjashtim të atyre në formë të shpalljeve në të cilat janë të publikuara vetëm emrat e prokurorëve publikë, të cilët zgjidhen ose ngrihen në detyrë.²⁰⁸ Arsyetimi i vendimeve të KPPRMV në lidhje me përzgjedhjen dhe ngritjen në detyrë të prokurorëve publik është i një rëndësie të jashtëzakonshme për rikthimin e besimit të qytetarëve në prokurorinë publike.²⁰⁹ Përveç kësaj, periudha raportuese u pasua me ndërprerjen e detyrës së 17 prokurorëve publikë.²¹⁰ Më konkretisht, 15 prokurorëve publik iu është ndërprerë për shkak të plotësimit të kushteve për pension të pleqërisë, kryesisht për shkak të hyrjes në fuqi të ndryshimeve dhe plotësimeve në Ligjin për Marrëdhëniet e Punës.²¹¹ Dy prokurorëve të tjerë publik iu është ndërprerë detyra me kërkesë të tyre.

Për shkak të skadimit të mandatit të pesë prokurorëve publikë nga PTHPNKOK në janar 2022, KPPRMV publikoi shpalljen për zgjedhjen e prokurorëve të rinj publik më 15 nëntor 2021.²¹² Ndonëse zgjedhja e prokurorëve të rinj publikë ishte paraparë të mbahej

201 Ligji për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, neni 77.

202 „Červenkovska për MIA: Komisionet nga gjykatat më të larta do të zgjedhin gjyqtarët nga gjykatat më të ulëta”, („Црвенковска за МИА: Комисии од повисоките судови ќе ги избираат судиите од пониските судови”), Agjencia Informative Mediatike – MIA, 5 prill 2022, <https://bit.ly/3TJWcTf>.

203 “Ligji për marrëdhëniet e punës pa ndryshimet e miratuara pensionon 42 gjyqtarë dhe 11 prokurorë”, („Законот за работни односи без донесените измени пензионира 42 судии и 11 обвинители”), TV Telma, 1 korrik 2022, <https://telma.com.mk/2022/07/01/zakonot-za-rabotni-odnosi-bez-donesenite-izmeni-penzionira-42-sudii-i-11-obviniteli/>.

204 Këshilli i Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, “Përgjigje ndaj kërkesës për qasje të lirë në informacione publike”, 9 nëntor 2022.

205 Ardita Abazi Imeri et al., “Analizë – Vlerësim gjithëpërfshirës i zbatimit të Strategjisë për Reformën e Sektorit Gjyqësor 2017–2022”, („Анализа – Сеопфатна оценка на спроведувањето на Стратегијата за реформа на правосудниот сектор 2017–2022”), (Instituti për Politikë Evropiane – Shkup, 10 nëntor 2022), <https://bit.ly/3X2nox8>.

206 Emilia Spasovska, “Raport nga monitorimi i Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë në vitin 2022” (Koalicioni “Të gjithë për gjykim të drejtë”, 2022), <http://sjorm.gov.mk/>.

207 Ibid.

208 Ibid.

209 Instituti për Politikë Evropiane – Shkup, “Dialog për Politika” Zbatimi i Strategjisë për Reforma në Sektorit Gjyqësor 2017–2022 me Plan veprimi – Ku jemi dhe çfarë më pas?”, („Дијалог за политики “Имплементација на Стратегијата за реформа на правосудниот сектор 2017–2022 година со Акциски план – До каде сме и што понатаму?”), 15 shtator 2021, <https://epi.org.mk/post/17822>.

210 Këshilli i Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, “Përgjigje ndaj kërkesës për qasje të lirë në informacione publike”, 9 nëntor 2022.

211 Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për marrëdhëniet e punës, “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut”, nr. 151/2021, neni 104.

212 “Shpallje për zgjedhjen e 38 PP në seancën e 38-të të PTHPNKOK”, („Орлас за избор на 38 ЈО Во ОЈОГОКК од 38 седница”), Uebfaqja zyrtare e Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 15 nëntor 2021, <http://sjorm.gov.mk/%d0%be%d0%b3%d0%bb%d0%bd1%81-5/>.

jo më vonë se 31 janar 2022, ajo u shty disa herë, kryesisht për shkak të vlerësimit joadekuat.²¹³ Përkatësisht, kandidatë të caktuar kanë dërguar vërejtje në KPPRMV për marrjen e notave që nuk janë në përputhje me formularët e vlefshëm, të publikuar dhe të miratuar nga prokurori publik i RMV-së.²¹⁴ KPPRMV konstatoi kundërshtimet si të arsyeshme, si dhe konstatoi mospërputhje ndërmjet shpjegimit të notave të dhëna dhe pikëzimit të kandidatëve.²¹⁵ Nga dhjetë prokurorët publikë që aplikuan në konkurs, më 17 mars 2022, u zgjodhën ata pesë të cilëve u skadoi mandati, të cilët konkurruan në përputhje me të drejtën ligjore për rizgjedhje edhe për një mandat katërvjeçar.²¹⁶ Në anën tjetër, zgjedhja e katër prokurorëve të rinj publikë në PTHPNKOK, pozitat e të cilëve u liruan në qershor dhe gusht 2022 si rezultat i pensionimit të prokurorëve të mëparshëm publik, u shty tri herë.²¹⁷ Si arsye kryesore për shtyrjen, KPPRMV përmend mungesën e të gjitha materialeve të nevojshme që janë kërkuar nga prokuroria kompetente për kandidatët dhe nevojën për një analizë më të detajuar të punës së tyre të mëparshme.²¹⁸

Pika e vetme e hyrjes në gjyqësor dhe në prokurorinë publike mbetet Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë (AGJPP). Pas një procesi të gjatë, i cili zgjati më shumë se një vit, i ndjekur me apele dhe kundërshtime,²¹⁹ Komisioni i Provimit Pranues pranë Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë, përgatiti renditjen përfundimtare për pranimin e gjeneratës së tetë të kandidatëve për trajnim fillestar në AGJPP.²²⁰ Në këtë drejtim, për hir të transparencës së procesit, përfshirë rrjedhën e procedimeve administrative dhe administrative-gjyqësore, AGJPP publikoi një raport të shkurtër kronologjik për të gjithë rrjedhën e provimit.²²¹ Pritja e gjeneratës së re u bë më 11 maj 2022.²²² Pjesëmarrësit e rinj të trajnimit fillestar brenda gjeneratës së tetë filluan të

213 „Një përpjekje e re për përzgjedhje të prokurorëve në ekipin e Ruskovskës: Dhjetë kandidatë në garë për pesë vende pune”, („Нов обид за избор на обвинители во тимот на Русковска: Десет кандидати во трка за пет места”), 360 stepeni, 17 mars 2022, <https://360stepeni.mk/nov-obid-za-izbor-na-obviniteli-vo-timot-na-ruskovska-deset-kandidati-vo-trka-za-pet-mesta/>.

214 „Jolevski: Nëse ka kushte për përzgjedhje, Këshilli të mërkurën do të mbajë seancë për përzgjedhjen e prokurorëve publikë”, („Јолевски: Ако има услови за избор, Советот ќе одржи седница за избор на јавни обвинители во среда”), TV Telma, 24 shkurt 2022, <https://bit.ly/3sLwTUS>.

215 Ibid.

216 „Ruskovska qëndron me të njëjtin ekip, nuk ka prokurorë të rinj”, („Русковска си останува со истиот тим, нема нови обвинители”), A1 on, 17 mars 2022, <https://a1on.mk/macedonia/ruskovska-si-ostanuva-so-isti-tim-ne-se-izbrani-novi-obviniteli/>.

217 „Për herë të tretë shtyhet seanca për përzgjedhjen e 4 prokurorëve të rinj në prokurorinë për ndjekjen e krimit të organizuar”, („По третпат одложена седницата за избор на 4 нови обвинители во обвинителството за goneње организиран криминал”), TV Telma, 20 shtator 2022, <https://telma.com.mk/2022/09/20/po-tret-pat-odlozheni-sednicata-za-izbor-na-4-novi-obviniteli-vo-obvinitelstvoto-za-gonenje-organiziran-kriminal/>.

218 Zgjedhja u mbajt në seancën e KPPRMV më 27 tetor 2022, por nuk pati sukses. Domethënë KPPRMV nuk ka përzgjedhur asnjë nga gjashtë kandidatët, ndaj pritet që të shpallet shpallje e re për përzgjedhje. „Dështoi përzgjedhja e prokurorëve për krim të organizuar”, („Пропадна изборот на обвинители за организиран криминал”), TV Sitel, 27 tetor 2022, <https://sitel.com.mk/propadna-izborot-na-obviniteli-za-organiziran-kriminal>.

219 „Raporti vijtor për punën e Akademisë së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë për vitin 2021”, („Годишен извештај за работата на Академијата за судии и јавни обвинители за 2021 година”), <https://jpacademy.gov.mk/reports/>.

220 „Shpallje e renditjes së pjesëmarrësve në gjeneratën VIII të studentëve të trajnimit fillestar në Akademinë e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë”, („Објавување на ранг-листа на слушатели во VIII-та генерација слушатели на почетна обука во Академијата за судии и јавни обвинители”), Faqja zyrtare e Akademisë së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë „Pavel Shatev”, 15 prill 2022, <https://bit.ly/3WcFIVv>.

221 Ibid.

222 „Është shënuar pritja e gjeneratës së tetë të pjesëmarrësve në trajnimin fillestar në Akademinë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë”, („Одбележан приемот на осмата генерација слушатели во почетната обука во Академијата за судии и јавни обвинители”), Faqja zyrtare e Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë „Pavel Shatev”, 11 maj 2022, <https://jpacademy.gov.mk/odbelezhan-priemot-na-osmata-generaczija-slushateli-vo-pochetnata-obuka-vo-akademijata-udii-javni-obiteli/>.

ndjekin trajnimin më 16 maj 2022. Kjo gjeneratë numëron 97 kandidatë dhe është gjenerata më e madhe që nga viti 2006.²²³ Ndërkohë, boshllëqet e personelit në gjyqësor dhe në prokurori, veçanërisht pasi në Kuvend nuk kaloi propozimi për zgjatjen e punësimit për mbi 60 gjyqtarë dhe prokurorë publikë edhe për tre vjet, pritet të plotësohen pjesërisht deri në fund të vitit 2022 me 59-të gjyqtarë dhe prokurorë publikë të rinj të gjeneratës së shtatë të pjesëmarrësve të pjesës praktike të trajnimit fillestar në AGJPP. Në këtë drejtim, drejtori i AGJPP shpreson që deri në fund të vitit 2022 të hapet një thirrje e re publike për grupin e nëntë, edhe më të madh të kandidatëve, për t'iu përgjigjur nevojave të sistemit gjyqësor dhe prokurorisë.²²⁴

Propozim ligji i ri për Akademinë e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publik, i cili u finalizua²²⁵ nga grupi i punës i krijuar në Ministrinë e Drejtësisë²²⁶ dhe i miratuar nga Qeveria në qershor të vitit 2021, është ende në procedurë parlamentare.²²⁷ Propozim ligji është bllokuar nga partia opozitare VMRO-DPMNE, me pretendimin se me këtë propozim ligj janë shkelur procedurat dhe keqpërdoret procedura për nxjerrjen e ligjeve me flamur evropian, me të cilën kërkon që propozimi të tërhiqet.²²⁸ Në shtator 2022, propozim ligji u rikthye në axhendën e Komisionit të Çështjeve Evropiane.²²⁹ Nevoja për miratimin e ligjit të ri për AGJPP përcaktohet në raportin e fundit të Komisionit Evropian për RMV.²³⁰ Në këtë drejtim, Komisioni Evropian i kushton vëmendje miratimit të tij.²³¹ Të respektohen rekomandimet e misionit vlerësues të TAIEKS nga viti 2018 dhe që AGJPP përsëri të mbetet pika e vetme e hyrjes në gjyqësor dhe prokurori, si dhe të sigurohet një qasje e drejtë dhe transparente ndaj këtyre profesioneve.²³²

223 Ibid.

224 „59 prokurorë dhe gjyqtarë të rinj – Gaber: Do të ketë thirrje të re deri në fund të vitit”, („59 нови обвинители и судии – Габер: До крајот на годинава ќе има нов повик”), 22 shtator 2022, <https://mk.tv21.tv/59-novi-obviniteli-i-sudii-gaber-do-krajot-na-godinava-ke-ima-nov-povik/>.

225 Qëllimi i ndryshimeve dhe plotësimeve në ligj ishte trajtimi i disa mospërpjethjeve në lidhje me organet drejtuese dhe udhëheqëse, si dhe u bënë ndryshime në kriteret e pranimit të pjesëmarrësve në AGJPP.

226 Më 8 shkurt 2019, në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë u krijua një grup pune për përgatitjen e propozimit për Ligjin e ri për Akademinë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë. Grupi i punës përbëhet nga dhjetë anëtarë, duke përfshirë drejtorin e AGJPP-së, përfaqësues nga Ministria e Drejtësisë, gjyqtarë, prokurorë publikë dhe përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile. Përgatitja e këtyre ndryshimeve të propozuara kishte për qëllim heqjen e pengesave me të cilat përballlej AGJPP. Në maj 2019, në ENER u publikua drafti fillestar i propozim ligjit për AGJPP, si dhe njoftimi për përgatitjen e ligjit dhe draft raportit për vlerësimin e ndikimit të rregullores. Raporti përfundimtar mbi vlerësimin e ndikimit të rregullores nuk u publikua. ENER ka katër komente për propozim ligjin e vitit 2019. Megjithatë, ky version nuk ishte miratuar nga përbërja e mëparshme parlamentare dhe është kthyer në Ministrinë e Drejtësisë për rishikim (versioni i ri nuk është publikuar në ENER).

227 Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, „Materiale – Propozim ligji për Akademinë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë”, („Материјали – предлог-закон за Академија за судии и јавни обвинители”), <<https://www.sobranie.mk/materialdetails.aspx?materialId=543628f3-2109-4bd5-8b99-22d543901888>> .

228 „Situatë e tensionuar në Komisionin Parlamentar për Sistem Politik, VMRO-DPMNE nuk lejon debat për propozim ligjin për Akademinë e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë”, („Тензијо на собраниската Комисија за политички систем, ВМРО-ДПМНЕ не дозволува расправа за предлог-законот за Академија на судии и јавни обвинители”), TV Telma, 9 shkurt 2022, <https://bit.ly/3hJdDt8>.

229 „Seanca e Komisionit Parlamentar për Çështje Evropiane”, („Седница на собраниската Комисија за европски прашања”), 24 Vesti, 26 shtator 2022, <https://24.mk/details/sednica-na-sobraniskata-komisiya-za-evropski-prashanja-2>.

230 Komisioni Evropian, „DOKUMENTI I PUNËS I KOMISIONIT – Raporti i Maqedonisë së Veriut 2022”, („COMMISSION STAFF WORKING DOCUMENT – North Macedonia 2022 Report”), 12 tetor 2022, https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/north-macedonia-report-2022_en.

231 Ibid.

232 Instituti për Politikë Evropiane-Shkup, „Një tjetër raport i KE-së: prizma e re, dhimbje të vjetra – Analizë e shkurtër e raportit të KE-së për Maqedoninë e Veriut 2022”, („Уште еден извештај на ЕК: нова призма, стари болки – Куса анализа на извештајот на ЕК за Северна Македонија 2022 година”), 13 tetor 2022, <https://epi.org.mk/post/22317>.

Këshilli Gjyqësor miratoi edhe aktin e fundit nënligjor për fillimin e vlerësimit të gjyqtarëve, i cili plotësoi masën për ripërcaktimin e kriterëve për ngritjen në detyrë të gjyqtarëve dhe krijoi kushte për zbatimin praktik të dispozitave ligjore. Megjithatë, aktet nënligjore nuk e përcaktojnë formën specifike të vendimeve për përzgjedhjen dhe ngritjen në detyrë të gjyqtarëve. Sipas kësaj, në çdo vendim për përzgjedhje dhe ngritje në detyrë, duhet theksuar se cilat janë kriteret që e dallojnë gjyqtarin e përzgjedhur apo të avancuar nga kandidatët e tjerë, apo të tregohen poenat apo pikët e marra nga secili kandidat që është përzgjedhur gjyqtar në një gjykatë themelore, pra i avancuar në një gjykatë më të lartë. Është gjithashtu e nevojshme që vlerësimi të kryhet sa më shpejt që të jetë e mundur, duke qenë se pritja e gjatë për zbatimin e këtyre metodologjive ka ndikuar negativisht në ngritjen në detyrë të gjyqtarëve që janë paraqitur në shpallje prej më shumë se një viti. Nevoja për plotësimin e pozitave të zbrazura të gjyqtarëve në gjykata është më se e nevojshme, veçanërisht pas pensionimit të 42 gjyqtarëve për shkak të hyrjes në fuqi të ndryshimeve dhe plotësimeve në Ligjin për Marrëdhëniet e Punës.

Është e nevojshme që Këshilli i Prokurorëve Publik të zhvillojë një diskutim dhe të japë shpjegime për arsyet e zgjedhjes ose moszgjedhjes së një prokurori të caktuar publik, si dhe të publikojë vendimet e marra për zgjedhjen në faqen e internetit të Këshillit, me qëllim të rikthen besimin e qytetarëve në prokurorinë publike.

Duhet reagim i shpejtë i Këshillit të Prokurorëve Publikë për zgjedhjen e disa prokurorëve publikë për të parandaluar zvarritjen e procedurës dhe uljen e efikasitetit dhe cilësisë së punës së prokurorëve publikë.

Është e nevojshme të miratohet ligji i ri për AGJPP duke respektuar rekomandimet e misionit vlerësues të TAIEKS nga viti 2018, si dhe duke u siguruar që AGJPP përsëri të mbetet pika e vetme e hyrjes në gjyqësor dhe prokurori, duke siguruar një qasje të drejtë dhe transparente ndaj këtyre profesioneve.

CILËSIA E DREJTËSISË

Akademia e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë (AGJPP) punon vazhdimisht në drejtim të përmirësimit të cilësisë së trajnimeve dhe prezantimit të temave të nevojshme të trajnimit bazuar në vlerësimet e trajnimeve dhe temave të propozuara të paraqitura nga Këshilli Gjyqësor, Këshilli i Prokurorëve Publikë, ekspertët dhe organizatat joqeveritare. Në periudhën raportuese ka një rritje të ndjeshme të numrit të trajnimeve të realizuara. Pra, kundrejt 130 trajnimeve të realizuara në vitin 2020,²³³ në vitin 2021, AGJPP ka realizuar 214 trajnime në kuadër të trajnimit të detyrueshëm për gjyqtarët dhe prokurorët publik, si dhe në kuadër të trajnimit vullnetar të shërbimeve profesionale në gjykata dhe prokurori.²³⁴ Po ashtu, numri i trajnimeve të realizuara nga viti 2020 tejkalohet me trajnimet e realizuara në nëntë muajt e parë të vitit 2022, ku nga janari deri në shtator 2022 janë realizuar gjithsej 159 trajnime.²³⁵ Në kuadër të trajnimeve është rritur dukshëm edhe numri i gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë që kanë kryer trajnime për praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, përkatësisht numri i gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë që i janë nënshtruar trajnimeve të tilla në vitin 2021 është rritur për 37% krahasuar me vitin 2020.²³⁶ Megjithatë, ka një rënie të numrit të trajnimeve të mbajtura që kanë të bëjnë me fëmijët viktime, pra në vitin 2021 janë mbajtur vetëm 5 trajnime,²³⁷ ndërsa në vitin 2020 janë mbajtur 17 trajnime.²³⁸

Për sa i përket bashkëpunimit me organe dhe institucione të tjera, AGJPP, gjatë periudhës raportuese ka nënshkruar memorandume bashkëpunimi me disa institucione përkatëse, organizata ndërkombëtare dhe joqeveritare.²³⁹ Më konkretisht, për realizimin e aktiviteteve që synojnë forcimin e kapaciteteve institucionale, sipas të cilave do të sigurohet një cilësi më e lartë në realizimin e trajnimeve të destinuara për gjyqtarët dhe prokurorët publikë, si dhe për pjesëmarrësit e trajnimit fillestar, AGJPP rinovoi memorandumin për bashkëpunim në nëntor 2021 me Akademinë Gjyqësore të Republikës së Turqisë,²⁴⁰ dhe në maj 2022 nënshkroi një memorandum bashkëpunimi me Qendrën për Trajnime dhe Studime Gjyqësore (SSR) të Mbretërisë së Holandës.²⁴¹ Gjithashtu, me nënshkrimin e

233 Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë, "Përgjigje ndaj kërkesës për qasje të lirë në informacionin publik", 12 prill 2021.

234 Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë, "Përgjigje ndaj kërkesës për qasje të lirë në informacionin publik", 1 nëntor 2022.

235 Ibid.

236 Numri i gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë që kanë kryer trajnime për praktikën gjyqësore të GJEDNJ për vitin 2021 është 592, krahasuar me vitin 2020 ku ishte 431.

237 Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë, "Përgjigje ndaj kërkesës për qasje të lirë në informacionin publik", 1 nëntor 2022.

238 Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë, "Përgjigje ndaj kërkesës për qasje të lirë në informacionin publik", 12 prill 2021.

239 Akademia për gjyqtarë dhe prokurorë publikë, "Memorandume për bashkëpunim", („Меморандуми за соработка“), <<https://jpacademy.gov.mk/cooperation/>>.

240 «Ештë nëнshkruar memorandum bashkëpunimi ndërmjet Akademisë së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë dhe Akademisë Gjyqësore të Republikës së Turqisë», („Потпишан меморандум за соработка помеѓу Академијата за судии и јавни обвинители и Правосудната академија на Република Турција“), Faqja zyrtare e Akademisë së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë "Pavell Shatev", 24 nëntor 2021, <https://bit.ly/3SXvJn>.

241 «Ештë nëнshkruar memorandum bashkëpunimi ndërmjet Akademisë së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë dhe Qendrës për Trajnime dhe Studime Gjyqësore (SSR) të Mbretërisë së Holandës», („Потпишан меморандум за соработка помеѓу Академијата за судии и јавни обвинители и Центарот за обука и правосудни студии (SSR) на Краљството Холандија“), Faqja zyrtare e Akademisë së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë "Pavell Shatev", 10 maj 2022, <https://bit.ly/3S0dc9z>.

memorandumit për bashkëpunim me Qendrën AIRE, AGJPP u bë pjesë e nismës për krijimin e një Rrjeti Rajonal të Gjyqtarëve e dedikuar për forcimin e barazisë gjinore.²⁴² Me qëllim të zgjerimit të vazhdueshëm të njohurive mbi legjislacionin evropian të gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë, AGJPP vazhdoi bashkëpunimin me Rrjetin Evropian të Trajnimit të Gjyqtarëve (EJTN) dhe Akademinë e Drejtësisë Evropiane (ERA).²⁴³

Ekipimi kadrovik dhe teknik, si dhe sigurimi i kushteve të përshtatshme hapësinore, mbeten ende sfidë dhe janë të një rëndësie të jashtëzakonshme për përmirësimin e cilësisë së trajnimeve të zhvilluara nga AGJPP. Nevoja për përmirësimin e kushteve hapësinore të AGJPP-së, në radhë të parë të dhomave të trajnimit, por edhe ekipimit kadrovik dhe rritjes së buxhetit, përcaktohet si rekomandim i përgjithshëm në raportin e misionit vlerësues të TAIKS-it.²⁴⁴ Nevoja për forcimin e kapaciteteve të AGJPP-së, veçanërisht përmirësimin e buxhetit dhe autonomisë së AGJPP-së, përcaktohet në Planin e veprimit për realizimin e prioritetëve urgjente të reformës.²⁴⁵ Në drejtim të përmirësimit të buxhetit të miratuar të AGJPP-së, kundrejt luhatjeve të vërejtura të shumave të miratuara në nivel vjetor në pesë vitet e fundit, në vitin 2022 vihet re një rritje e ndjeshme e buxhetit të miratuar vjetor.²⁴⁶ Përkatesisht, për shkak të pranimit të gjeneratës së tetë të kandidatëve për trajnim fillestar në AGJPP, buxheti i AGJPP-së për vitin 2022 është 131.793.000,00 denarë, krahasuar me vitin paraprak, ku ishte 72.200.000,00 denarë.²⁴⁷

Në prag të skadimit të mandatit të drejtorit aktual të AGJPP në nëntor 2022, Bordi Drejtues i AGJPP publikoi më 14 korrik 2022 shpalljen për zgjedhjen e drejtorit të ri.²⁴⁸ Ndonëse u tha se kandidatët e regjistruar në shpalljen për zgjedhjen e drejtorit plotësojnë kushtet për pozicionin, si dhe të gjitha kriteret e dhëna, asnjëri prej tyre nuk ka marrë pesë votat e kërkuara me ligj nga anëtarët e Bordit Drejtues²⁴⁹ në seancën e mbajtur më 30 gusht 2022.²⁵⁰ Për sa i përket transparencës dhe llogaridhënies së Bordit Drejtues të

242 "Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë, pjesë e Rrjetit Rajonal të Gjyqtarëve/Gjyqtareve për Barazi Gjinore", („Академијата за судии и јавни обвинители дел од Регионалната мрежа на судии/судији за родова еднаквост”), Faqja zyrtare e Akademisë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë “Pavell Shatev”, 13 korrik 2022, <https://bit.ly/3WkMt7o>.

243 Akademia për gjyqtarë dhe prokurorë publikë, “Memorandume për bashkëpunim”, („Меморандуми за соработка”), <<https://jpacademy.gov.mk/cooperation/>>.

244 Raport nga misioni vlerësues i TAIKS për trajnimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë në Republikën e Maqedonisë, gjyqtari Lenart Johanson dhe gjyqtari Dragomir Jordanov, (i papublikuar).

245 “Plani i veprimit për realizimin e prioritetëve urgjente reformuese 2015 (Dokumenti i punës)”, („План на активности за реализација на итните реформски приоритети 2015 (Работен документ)”), <https://www.sep.gov.mk/post/?id=862>.

246 Ardita Abazi Imeri et al., “Analizë – Vlerësim gjithëpërfshirës i zbatimit të Strategjisë për Reformën e Sektorit Gjyqësor 2017-2022”, („Анализа – Сеопфатна оценка на спроведувањето на Стратегијата за реформа на правосудниот сектор 2017-2022”), (Instituti për Politikë Evropiane – Shkup, 10 nëntor 2022), <https://bit.ly/3X2nox8>.

247 Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë, “Përgjigje ndaj kërkesës për qasje të lirë në informacionin publik”, 26 gusht 2022.

248 “Shpallje për zgjedhjen e drejtorit të AGJPP”, “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut”, nr. 160/2022.

249 “Pesë anëtarë të Bordit Drejtues të Akademisë së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë shtynë zgjedhjen e drejtorit, nuk thanë pse nuk votuan”, („Петмина членови на Управниот одбор на Академијата за судии и јавни обвинители го бутнаа изборот на директор, не кажаа зошто не гласале”), Sakam Da Kazam, 30 gusht 2022, <https://bit.ly/3gKZhtQ>.

250 “Bordi Drejtues i Akademisë së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë nuk ka zgjedhur drejtor, do të publikojë shpallje të re”, („Управниот одбор на Академијата за судии и јавни обвинители не избра директор, ќе распишува нов оглас”), 360 gradë, 30 gusht 2022, <https://360stepeni.mk/upravniot-odbor-na-akademijata-za-sudii-i-javni-obviniteli-ne-izbra-direktor-ke-raspishuva-nov-oglas/>.

AGJPP-së, nuk u shpjegua pse nuk votuan anëtarë individualë dhe as pse abstenuan nga votimi.²⁵¹ Thirrja dështoi dhe Bordi i Drejtorëve do të shpall shpallje të re për drejtor.²⁵²

Në lidhje me barazimin e praktikës gjyqësore, Departamenti i Praktikës Gjyqësore në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut (GJSRMV) ka mbajtur katër seanca në vitin 2021, ndërsa nga janari deri në shtator 2022 ka mbajtur tri seanca.²⁵³ Për ndryshim nga viti 2020, kur gjyqtarë nga zona të ndryshme të apelit dhe GJSRMV (për praktikën gjyqësore) nuk mbajtën asnjë mbledhje,²⁵⁴ në vitin 2021 mbajtën një mbledhje.²⁵⁵ Takimet e punës për barazimin e praktikës gjyqësore vazhduan me intensitet edhe më të madh në vitin 2022, ku deri më tani janë mbajtur tre takime,²⁵⁶ me mbledhjen e fundit në fillim të qershorit 2022.²⁵⁷ Mbështetja financiare për organizimin e këtyre takimeve mbetet me ndihmën e jashtme dhe realizimin e projekteve përmes të cilave në takime përfshihet edhe sektori civil.²⁵⁸ Për të arritur një barazi më të madhe të praktikës gjyqësore, nevojitet një numër më i madh i takimeve të GJSRMV me gjykatat e apelit, si dhe një rritje e aktivitetit të departamenteve të praktikës gjyqësore. Për të ndjekur drejtimet dhe qëndrimet e gjykatave të apelit në mbledhjet e tyre, konkluzionet e këtyre mbledhjeve duhet të jenë më transparente, gjë që do të thjeshtojë zbatimin e praktikës gjyqësore.²⁵⁹ Gjithashtu, procesi i publikimit të vendimeve gjyqësore vazhdon pa probleme dhe të gjitha vendimet gjyqësore publikohen në ueb portalin e gjykatave sud.mk, por procesi nuk është i strukturuar në mënyrë që vendimet të përdoren në mënyrë të lehtë dhe të qasshme. Kjo për faktin se nuk ekziston mundësia e gjetjes së saktë dhe të shpejtë të një praktike gjyqësore specifike dhe as metodologjia për nxjerrjen e vendimeve kyçe në lidhje me krijimin e praktikës gjyqësore.²⁶⁰

251 "Pesë anëtarë të Bordit Drejtues të Akademisë së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë shtynë zgjedhjen e drejtorit, nuk thanë pse nuk votuan", („Петмина членови на Управниот одбор на Академијата за судии и јавни обвинители го бутнаа изборот на директор, не кажаа зошто не гласале“), Sakam Da Kazam, 30 gusht 2022, <https://bit.ly/3gKZHtQ>.

252 "Akademia për gjyqtarë dhe prokurorë nuk zgjodhi drejtoreshë mes Gaber Damjanovskës dhe Ristovës", („Академијата за судии и обвинители не избра директорка меѓу Габер Дамјановска и Ристова“), 30 gusht 2022, <https://fokus.mk/akademijata-za-sudii-i-obviniteli-ne-izbra-direktorka-megu-gaber-damjanovska-i-ristova/>.

253 Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, "Përgjigje ndaj kërkesës për qasje të lirë në informacione publike", 7 nëntor 2022.

254 Iva Conevska Vangellova dhe Zlatica Stamboliska-Popovska, "Raport për vitin 2020 për rezultatet e zbatimit të Strategjisë për Reformën e Sektorit Gjyqësor 2017-2022" („Извештај за 2020 година за резултатите од спроведувањето на Стратегијата за реформа на Правосудниот сектор 2017-2022 година“), (Instituti për Politika Evropiane – Shkup, Shqoqata ZENIT, 20 shtator 2021), <https://epi.org.mk/post/19920>.

255 Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, "Përgjigje ndaj kërkesës për qasje të lirë në informacione publike", 7 nëntor 2022.

256 Ibid.

257 Takimi u mbajt në datat 7 dhe 9 qershor 2022 me të gjitha gjykatat e apelit në vend. Ai u organizua nga Qendra për Hulumtime dhe Analiza Juridike, në bashkëpunim me Akademinë për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë. Në takim u shqyrtuan çështjet juridike nga fusha penale dhe civile e gjykatave të apelit, për të cilat është i nevojshëm harmonizimi i qëndrimeve me qëllim të harmonizimit në zbatimin e ligjit nga gjykatat në Republikën e Maqedonisë së Veriut. "Takimi i Gjykatës së Lartë dhe Gjykatave të Apelit", („Средба на Врховниот суд и апелациските судови“), Faqja zyrtare e Gjykatës së Lartë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 16 qershor 2022, <https://bit.ly/3FDHJnA>.

258 Ardita Abazi Imeri et al., "Analizë – Vlerësim gjithëpërfshirës i zbatimit të Strategjisë për Reformën e Sektorit Gjyqësor 2017-2022", („Анализа – Сеопфатна оценка на спроведувањето на Стратегијата за реформа на правосудниот сектор 2017-2022“), (Instituti për Politikë Evropiane – Shkup, 10 nëntor 2022), <https://bit.ly/3X2nox8>.

259 Dushko Georgievski, "Analiza e cilësisë dhe barazisë së vendimeve gjyqësore në fushën e së drejtës civile", („Анализа на квалитетот и изедначеноста на судските одлуки во граѓанско правната област“), (Instituti për Politikë Evropiane dhe Shqoqata "Zenit", gusht 2021) <<https://bit.ly/3UfOKPz>>.

260 Ardita Abazi Imeri et al., "Analizë – Vlerësim gjithëpërfshirës i zbatimit të Strategjisë për Reformën e Sektorit Gjyqësor 2017-2022", („Анализа – Сеопфатна оценка на спроведувањето на Стратегијата за реформа на правосудниот сектор 2017-2022“), (Instituti për Politikë Evropiane – Shkup, 10 nëntor 2022), <https://bit.ly/3X2nox8>.

Në periudhën raportuese ka vazhduar roli proaktiv i departamentit të praktikës gjyqësore për miratimin e qëndrimeve parimore dhe opinioneve parimore ligjore. Gjegjësisht, departamenti i praktikës gjyqësore regjistroi qëndrimet e vendosura parimore dhe mendimet parimore juridike të seancës së përgjithshme të GJSRMV-së, mendimet dhe konkluzionet juridike të departamenteve të specializuara dhe pranoi vendimet gjyqësore të këshillave duke i sistemuar ato sipas fushave ligjore dhe i publikoi në faqen e internetit të GJSRMV-së në seksionin për praktikën gjyqësore. Pra, gjatë periudhës raportuese në ueb faqen e GJSRMV janë publikuar dy opinione parimore juridike, një qëndrim parimor, nëntë mendime juridike, 24 konkluzione dhe nëntë vendime gjyqësore.²⁶¹

Pas një vonese prej më shumë se një viti dhe tejkalimit të afatit të përcaktuar në Planin e veprimit në Strategjinë për Reformën e Sektorit Gjyqësor 2017-2022,²⁶² Ligji i ri për Ndërmjetësimin u miratua më 27 dhjetor 2021.²⁶³ Grupi i punës²⁶⁴ përpunoi versionin e propozim ligjit të ndërmjetësimit që ishte përgatitur nga grupi i mëparshëm i punës në vitin 2018 dhe i cili nuk ishte miratuar nga përbërja e mëparshme parlamentare.²⁶⁵ Propozim ligji i ri i ndërmjetësimit nuk u publikua në ENER, kështu që Raporti i Vlerësimit të Ndikimit të Rregullativës (VNR) dhe të gjitha komentet e publikuara në ENER i referohen propozim ligjit të publikuar në vitin 2018.²⁶⁶ Megjithatë, propozimet e propozim ligjit u dorëzuan nga palë të ndryshme në Ministrinë e Drejtësisë dhe ato u konsultuan me grupin e punës.²⁶⁷ Ligji ndjek Direktivën 2008/52/EC për ndërmjetësimin në kon-testet civile dhe tregtare²⁶⁸ dhe Mjetet e Zhvillimit të Ndërmjetësimit CEPEJ të vitit 2018,²⁶⁹ të cilat e afrojnë Republikën e Maqedonisë së Veriut me standardet evropiane të ndërmjetësimit. Theksi kryesor në ligj vendoset pikërisht në forcimin e integritetit dhe cilësisë së ndërmjetësuesve, i cili rezultoi të jetë një faktor kyç për nxitjen e ndërmjetësimit dhe përdorimin e tij në praktikë.²⁷⁰ Rrjedhimisht, ligji rishikoi mënyrën e dhënies së provimit për ndërmjetës, prezantoi mundësinë e fillimit të procedurës së ndërmjetësimit në mënyrë elektronike dhe futi regjistrimin e detyrueshëm të të gjitha kërkesave

261 Monitorim i faqes së Gjykatës së Lartë të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

262 Ministria e Drejtësisë, "Strategjia për Reformën e Sektorit Gjyqësor për periudhën 2017-2022 me Plan veprimi".

263 "Ligji për ndërmjetësim", "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut", nr. 294/2021.

264 Në Ministrinë e Drejtësisë u formua grupi punues, në të cilin ishin drejtoresha e AGJPP-së, përfaqësues i sektorit joqeveritar, përfaqësues nga Oda e Ndërmjetësues të Republikës së Maqedonisë së Veriut (ONRMV), përfshirë edhe kryetarin e ONRMV-së.

265 Ardita Abazi Imeri et al., "Analizë – Vlerësim gjithëpërfshirës i zbatimit të Strategjisë për Reformën e Sektorit Gjyqësor 2017-2022", („Анализа – Сеопфатна оценка на спроведувањето на Стратегијата за реформа на правосудниот сектор 2017-2022"), (Instituti për Politikë Evropiane – Shkup, 10 nëntor 2022), <https://bit.ly/3X2nox8>.

266 Ibid.

267 Ibid.

268 Direktiva 2008/52/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 21 maj 2008 mbi disa aspekte të ndërmjetësimit në çështjet civile dhe tregtare, CELEX 32008L0052, OJ L 136, 24.5.2008, <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/en/TXT/?uri=CELEX:32008L0052>, f. 3-8.

269 Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ), "Paketa e mjeteve për zhvillimin e ndërmjetësimit - Sigurimi i zbatimit të udhëzimeve të CEPEJ mbi ndërmjetësimin", (Mediation Development Toolkit – Ensuring Implementation of the CEPEJ Guidelines on Mediation), CEPEJ()7REV 2018, <https://rm.coe.int/mediation-development-toolkit-ensuring-implementation-of-the-cepej-gui/16808c3f52>.

270 "Debat: Numri i rasteve të zgjidhura me ndërmjetësim është në rritje, por ende ka mungesë të informimit për këtë", ("Дебата: Расте бројот на предмети решени со медијација, но сè уште постои слаба информираност за истата"), Faqja zyrtare e Institutit për Politikë Evropiane (EPI) – Shkup, 16 shtator 2022, <https://epi.org.mk/post/22207>.

të pranuar për ndërmjetësim në Regjistrin Elektronik, i inkuadruar nga Ministria e Drejtësisë në gusht të vitit 2020,²⁷¹ si dhe futja e detyrueshme e të dhënave për ecurinë e mëtejshme të procedurës.²⁷² Gjithashtu, ligji rregullon funksionimin dhe kompetencat e organit të ngarkuar me sigurimin, monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë së ndërmjetësimit, pra vendoset Këshilli Kombëtar i Ndërmjetësimit.²⁷³ Në këtë drejtim, në seancën e 54-të të Qeverisë, nënkryetarja e Odës Ekonomike të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe kryetarja e Shoqatës për Ndërmjetësim pranë Odës, Jelisaveta Georgieva-Jovevska, u emërua koordinatorja e parë kombëtare për ndërmjetësim.²⁷⁴ Më pas, Qeveria publikoi njoftim publik për shprehjen e interesit për pjesëmarrje në Këshillin Kombëtar të Ndërmjetësimit, me afat regjistrimi deri më 5 gusht 2022,²⁷⁵ dhe në seancën e mbajtur më 6 shtator 2022, miratoi Vendimin për emërimin e katër anëtarëve dhe sekretarin e Këshillit Kombëtar të Ndërmjetësimit, nga radhët e nëpunësve administrativë në administratën shtetërore pranë Ministrisë së Drejtësisë.²⁷⁶

Me qëllim të zbatimit të vazhdueshëm të Ligjit të ri për Ndërmjetësimin, në prill të vitit 2022 u miratuan aktet nënligjore të parapara, si: Rregullorja për kriteret më të afërta, mënyrën e subvencionimit, pagesën, formularin për shpërblimin e paguar, shpenzimet e ndërmjetësuesit, formularin e kërkesës për subvencionim dhe dokumentacioni i nevojshëm që paraqitet krahas kërkesës për subvencionim të pjesës së shpenzimeve të ndërmjetësimit;²⁷⁷ Rregullorja për mënyrën e mbikëqyrjes së punës së Odës së ndërmjetësve të Republikës së Maqedonisë së Veriut;²⁷⁸ Rregullorja për përmbajtjen e Regjistrit të kërkesave të pranuar për ndërmjetësim dhe mënyrën e regjistrimit të kërkesave të pranuar për ndërmjetësim²⁷⁹ dhe Rregullorja për programin e dhënies së provimit për ndërmjetësues, mënyrën e organizimit dhe dhënies së provimit, mënyrën e zhvillimit të provimit, si dhe formën dhe përmbajtjen e certifikatës së dhënies së provimit.²⁸⁰

271 Ministria e Drejtësisë, “E-regjistër për regjistrimin e lëndëve të ndërmjetësimit”, („E-регистар за евидентирање предмети на медијација”), 17 gusht 2020, <http://mediation.pravda.gov.mk/login>.

272 “Rruga e ndërmjetësimit në Republikën e Maqedonisë së Veriut”, („Патот на медијацијата во Република Северна Македонија”), (Instituti për Politikë Evropiane – Shkup, 17 gusht 2022), <https://epi.org.mk/post/22023>.

273 Këshilli Kombëtar sipas ligjit ka buxhetin e tij, ndërsa ka edhe kriterë që duhet të plotësojnë koordinatori kombëtar dhe anëtarët për t'u zgjedhur nga Qeveria e RMV-së.

274 “Procesverballi i seancës së 54-të të Qeverisë”, („Записник од 54-та седница на Владата”), Uebfaqja zyrtare e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, 21 qershor 2022, <https://vlada.mk/2022-54>.

275 “Shpallje publike për shprehje të interesit për pjesëmarrje në Këshillin Kombëtar për Ndërmjetësim”, („Јавен оглас за искажување на интерес за учество во Националниот совет за медијација”), Uebfaqja zyrtare e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, 5 gusht 2022, <https://vlada.mk/node/29660>.

276 Anëtarë të Këshillit Kombëtar për Ndërmjetësim u emëruan Ljupčo Sotirovski, Ivana Talevska-Trendafilova, Zoran Petkovik-Bakli dhe Miljizam Mustafa, ndërsa sekretar i Këshillit Kombëtar për Ndërmjetësim nga radhët e nëpunësve administrativë në administratën shtetërore u emërua Vasko Nellovski nga Ministria e Drejtësisë. “Vendim për emërimin e anëtarëve dhe sekretarit të Këshillit Kombëtar për Ndërmjetësim”, “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut”, nr. 201/2022.

277 Rregullore për kriteret më të afërta, mënyrën e subvencionimit, pagesën, formularin për shpërblimin e paguar, shpenzimet e ndërmjetësuesit, formularin e kërkesës për subvencionim dhe dokumentacionin e nevojshëm që dorëzohet krahas kërkesës për subvencionim të pjesës së shpenzimeve të ndërmjetësimit (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut”, nr. 91/2022).

278 „Rregullore për mënyrën e mbikëqyrjes së punës së Odës së Ndërmjetësve të Republikës së Maqedonisë së Veriut” “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut”, nr. 100/2022.

279 „Rregullore për përmbajtjen e Regjistrit të kërkesave të pranuar për ndërmjetësim dhe mënyrën e regjistrimit të kërkesave të pranuar për ndërmjetësim”, “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut”, nr. 100/2022.

280 “Rregullore e Programit të dhënies së provimit për ndërmjetës, mënyra e organizimit dhe dhënies së provimit, mënyra e zhvillimit të provimit, si dhe forma dhe përmbajtja e certifikatës së dhënies së provimit”, “Gazeta Zyrtare e Republika e Maqedonisë së Veriut”, nr. 101/2022.

Efikasiteti i gjykatave për vitin 2021 është përmirësuar krahasuar me vitin 2020. Megjithatë, vazhdoi trendi i mospërputhshmërisë të të dhënave mbi vëllimin e punës së gjykatave të Ministrisë së Drejtësisë, me të dhënat e Këshillit Gjyqësor. Prandaj, është e nevojshme të ngrihet një mekanizëm për të mbajtur një statistikë të vetme dhe absolutisht të saktë mbi vëllimin e punës së gjykatave, me qëllim që të kryhen analiza të sakta dhe të ndërmerren aktivitete të përshtatshme për të kapërcyer joefikasitetin e gjykatave.

Prokurorët publikë, në vitin 2021 kanë vepruar në mënyrë efikase dhe profesionale, duke arritur të kapërcejnë fluksin e padive të reja penale dhe të zvogëlojnë numrin e lëndëve në pritje pavarësisht nga mungesa e personelit.

Më shumë fonde, një rritje në burimet njerëzore dhe një rritje në kushtet hapësinore dhe teknike janë të nevojshme për të rritur efikasitetin e gjyqësorit dhe prokurorisë publike.

Këshilli i Prokurorëve Publikë duhet të krijojë një metodologji në lidhje me të cilën do të përcaktojë numrin e saktë të prokurorëve publikë në një prokurori publike, si dhe të përcaktojë nevojën për bashkëpunëtorë profesionalë në mënyrë që të funksionojë siç duhet shërbimi i prokurorit publik.

Është e nevojshme të miratohet rregullim ligjor për funksionim elektronik të gjykatave, pasi rregullorja ligjore që rregullon menaxhimin elektronik dhe shërbimet elektronike nuk mbulon gjykatat, domethënë ajo rregullon vetëm shërbimet administrative. E patjetërsueshme është të zëvendësohen pajisjet e vjetruara të TI të shumicës të shërbimit të prokurorit publik.

Është e nevojshme që me Strategjinë e re për Reformën e Sektorit Gjyqësor 2023-2027, të parashikohen hapa afat-shkurtër për krijimin e një Qendre funksionale të Teknologjisë së Komunikimit-Informativ, Analitikës dhe Statistikës, brenda Këshillit Gjyqësor, duke filluar kështu procesin e kryerjes së statistikave të njëjta dhe përpunimit të të gjitha të dhënave përkatëse që dalin nga puna e gjykatave.

Për një gjyqësor efikas, nevojitet gjithashtu një Rregullore e përditësuar e Punës të Gjykatës, e cila do t'i përgjigjet vazhdimisht nevojave të gjyqësorit në një periudhë të caktuar.



2. Lufta kundër korrupsionit



Maqedonia e Veriut u rendit e 87-ta në botë me 39 pikë indeksi, ndërsa në vitin e mëparshëm vendi ishte i 111-ti me 35 pikë sipas Indeksit më të fundit të Perceptimit të Korrupsionit të Transparency International.³⁷³ Ndjekja penale e rasteve të korrupsionit me profil të lartë dhe organet e forcuara të mbikëqyrjes shihen si thelbësore për parimin e Maqedonisë së Veriut dhe përmirësimin e renditjes së saj.³⁷⁴

Sipas vlerësimit të "Freedom House" (2/4)³⁷⁵, shqetësimi nga viti i kaluar mbetet për sa i përket efikasitetit dhe pavarësisë së gjyqësorit dhe luftës kundër korrupsionit. Sipas raportit të "Freedom House" (2/4)³⁷⁶, Maqedonia e Veriut ende po lufton me luftën kundër korrupsionit dhe klientelizmit, dhe problem i veçantë është mosndëshkimi i zyrtarëve të korruptuar të qeverisë, përfshirë anëtarët e parlamentit dhe gjyqësorit.

Në Raportin e vitit të kaluar të Komisionit Evropian për Maqedoninë e Veriut, është shënuar progres në luftën kundër korrupsionit dhe konfliktit të interesit në vend, por po ashtu theksohet se kapacitetet institucionale të PPRMV, qendrave dhe njërive hetimore duhet të forcohen për të hetuar korrupsionin. Përveç kësaj, sektorët më të ndjeshëm ndaj korrupsionit duhet t'i nënshtrohen vlerësimit të rrezikut dhe aktiviteteve të duhura. Rekomandimet kryesore janë: rritja e mbështetjes së institucioneve shtetërore që zbatojnë Strategjinë Kombëtare për Luftimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit dhe zbatimi efektiv i rekomandimeve të Grupit të Shteteve kundër Korrupsionit (GRECO), ndarja e burimeve të mjaftueshme për PTHPNKOK, përfshirë dhe ekspertë financiarë, me qëllim të sigurohet përgjegjësi efektive për rastet e korrupsionit të nivelit të lartë dhe për të vazhduar rritjen e numrit të aktëgjykimave përfundimtare në rastet e korrupsionit të nivelit të lartë.³⁷⁷

Pozita zëvendëskryetar i Qeverisë përgjegjës për luftën kundër korrupsionit dhe krimin, zhvillimit të qëndrueshëm dhe burimeve njerëzore, e emëruar për herë të parë në shtator 2020, ndryshoi titullin në këtë periudhë raportuese, dhe me rikonstruimin e Qeverisë në mesin e janarit të këtij viti u emërua zëvendëskryetare e Qeverisë përgjegjëse për politika dhe qeverisje të mirë.³⁷⁸ Në fillim të korrikut, me propozim të zëvendëskryetares, është miratuar Informata për përcaktimin e sjelljes etike për anëtarët e Qeverisë dhe bartësit e funksioneve publike të emëruar nga Qeveria me

373 Transparency International, Indeks për Perceptim të Korrupsionit 2021, (Индекс за перцепција на корупцијата 2021) < 2021 Corruption Perceptions Index – Explore the... – Transparency.org

374 Ibid.

375 Freedom House, "Liria në botë 2022 – Maqedonia e Veriut" („Слобода во светот 2022 – Северна Македонија“), (2022), <https://freedomhouse.org/country/north-macedonia/freedom-world/2022>.

376 Ibid.

377 Komisioni Evropian, "DOKUMENTI I PUNËS I KOMISIONIT – Raporti i Maqedonisë së Veriut 2022", ("COMMISSION STAFF WORKING DOCUMENT – North Macedonia 2022 Report"), 12 tetor 2022, https://neighbourhood-enlargement.ec.europa.eu/north-macedonia-report-2022_en.

378 "Nikolovski dorëzoi postin e zëvendëskryeministër të Grkovska", („Николовски ја предаде функцијата вицепремиер на Грковска“), Uebfaqja zyrtare e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, 17 janar 2022, <https://vlada.mk/node/27401>.

Kodin e Sjelljes Etike të anëtarëve të Qeverisë dhe bartësve të funksioneve publike të emëruara nga qeveria. Ndryshimet në Kod janë rezultat i komenteve dhe rekomandimeve të GRECO dhe i referohen përmirësimit të përkushtimit të qeverisë ndaj sjelljes etike të anëtarëve të qeverisë dhe zyrtarëve tjerë, të cilët janë të detyruar të punojnë në interes të qytetarëve të Republikës.³⁷⁹

Plani për luftën kundër korrupsionit për vitin 2022 mbështetet në katër shtylla kryesore: dixhitalizimi, gjyqësor i pavarur dhe efikas, profesionalizëm i institucioneve dhe masa parandaluese për luftën kundër korrupsionit.³⁸⁰

GRECO miratoi Shtojcën e Raportit të Dytë të për përputhshmërinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut në kuadër të Raundit të katërt të vlerësimit dhe u konkludua se Maqedonia e Veriut ka arritur njëfarë progresi në zbatimin e rekomandimeve të përfshira në Raportin nga Raundi i katërt i vlerësimit - nga gjithsej nëntëmbëdhjetë rekomandime, nëntë janë zbatuar në masë të kënaqshme, nëntë janë zbatuar pjesërisht dhe vetëm një rekomandim është i pazbatuar.³⁸¹

379 “U miratua informacioni për përcaktimin e sjelljes etike për anëtarët e Qeverisë dhe bartësit e posteve të emëruara publike”, („Усвоена Информацијата за утврдување на етичко однесување за членовите на Владата и носителите на именувани јавни функции“), Kurir, 5 korrik 2022, <https://bit.ly/3hGukRL>.

380 Ibid.

381 „Raport i GRECO: Nga 19 rekomandime, 9 janë zbatuar në masë të kënaqshme, 9 janë zbatuar pjesërisht dhe vetëm 1 nuk është zbatuar“, („Извештај на ГРЕКО: Од 19 препораки, 9 се имплементирани во задоволителна мера, 9 се делумно, а само 1 не е имплементирана“), Faqja zyrtare e Ministrisë së Drejtësisë, 4 korrik 2022, <https://pravda.gov.mk/vest/6381>.

KUADRI INSTITUCIONAL

Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit dhe

Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit (KSHPK) gjatë vitit 2021 ka pranuar 720 kallëzime nga qytetarët me dyshime për sjellje korruptive, shpërdorim detyre publike, konflikt interesi, ka ngritur 84 raste me iniciativë të vetën dhe ka iniciuar 710 procedime kundërvajtëse për paraqitje të vonuar të Deklaratave të gjendjes pasurore dhe interesave. Në fushën e korrupsionit ka marrë vendime në 390 raste, në fushën e konfliktit të interesit ka marrë vendime në 152 raste, në fushën e mos respektimit të ndalimeve gjatë procesit zgjedhor ka vendosur në 41 raste, në fushën e kontrollit të të dhënave nga listat e anketimit ka vendosur për 92 kallëzime dhe ka dhënë 85 mendime për kërkesa për konflikt të mundshëm interesi (675 vendime në total).³⁸²

Në prill 2022, KSHPK publikoi Raportin Vjetor mbi Zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit për vitin 2021, duke arritur në përfundimin se vetëm 20% e të gjitha aktiviteteve të planifikuara për vitin 2021 janë zbatuar plotësisht, 27% janë në proces zbatimi, dhe 53% nuk janë zbatuar fare, ndërsa zbatimi më i madh i aktiviteteve është në sektorin e drejtësisë (78%), pasuar nga media dhe sektori i shoqërisë civile (67 %), fusha horizontale e prokurimit publik (33%) dhe sektori i arsimit (22%).³⁸³

Në raportin e vitit të kaluar të KE-së për Maqedoninë e Veriut, vërehet progres në luftën kundër korrupsionit dhe konfliktit të interesit në vend. Vlerësimi pozitiv bazohet në rritjen e qasjes proaktive të KSHPK-së, në disa segmente, si hapja e një numri të madh lëndësh, përfshirë ato për personat në pozita të larta në institucionet shtetërore, dhënien e drejtimeve institucioneve shtetërore, si dhe rëndësinë e forcimit të kapaciteteve profesionale të KSHPK-së (hapësirat e reja dhe shtatë punësime të reja profesionale në vitin e kaluar).³⁸⁴

Në përputhje me kompetencën e përcaktuar ligjore në Ligjin për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, KSHPK nënshkroi Politikën e Integritetit, e cila duhet të motivojë institucionet e tjera që të përfshihen në politikat kundër korrupsionit dhe për momentin në proces është programi pilot për mentorimin e pesë institucioneve – Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës, Enti Shtetërore

382 Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, "Raporti vjetor për punën e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit për vitin 2021", („Годишен извештај за работата на Државната комисија за спречување на корупција за 2021 година“), mars 2022, <https://dksk.mk/wp-content/uploads/2022/03/%D0%93%D0%98-2021-final.pdf>.

383 Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, "Raport vjetor për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, planifikuar për zbatim në vitin 2021", („Годишен извештај за спроведување на Националната стратегија за спречување на корупцијата и судирот на интереси предвидени за realizacija во 2021 година“), mars 2022, <https://bit.ly/3gdvXQk>.

384 "KE thekson progres në luftën kundër korrupsionit KSHPK - me bashkëpunim më të madh ndërinstitucional mund të arrijmë rezultate më të mëdha", („ЕК констатира напредок во борбата против корупцијата ДКСК – со поголема меѓуинституционална соработка можеме до поголеми резултати“), Faqja zyrtare e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, 25 tetor 2021, <https://bit.ly/3GgvLRf>.

për Revizion, Këshilli Inspektues, Agjencia për Mbrojtjen e të Drejtës për Qasje të Lirë në Informacionin Publik dhe KSHPK.³⁸⁵

Në fillim të vitit 2022, me iniciativën e saj, KSHPK-ja hapi tri raste kundër prokurorit publik të Gostivarit.³⁸⁶ Gjithashtu, në seancën e mbajtur më 15 shkurt 2022, KSHPK-ja deklaroi se do të analizojë dhënien e bonove sportive dhe kërkoi nga Prokuroria Publike që të fillojë procedimin penal ndaj kryetarëve komunal aktual dhe të mëparshëm.³⁸⁷

KSHPK ka paraqitur iniciativë për padi penale në Prokurorinë Publike ndaj dy ish-sekretarëve të përgjithshëm të qeverisë, për shpërdorim detyre duke lidhur marrëveshje për të drejtën e autorit me persona të jashtëm për pagesën e kompensimit për të cilin është shpenzuar buxheti i paraparë për pesë vjet në periudhën ndërmjet 2019 dhe fillimit të 2022.³⁸⁸

Në mes të gushtit 2022 KSHPK publikoi Raportin e Dytë Tremujorësh për zbatimin e rekomandimeve nga vlerësimi i cënueshmërisë ndaj korrupsionit në institucionet shtetërore dhe pushtetin lokal në fushën e planifikimit hapësinor, urbanizmit dhe ndërtimit.³⁸⁹

Në të njëjtin muaj u hap qendra e trajnimit në kuadër të KSHPK-së, e cila parashikon ndërmarrjen e aktiviteteve për edukimin e autoriteteve përgjegjëse për zbulimin dhe ndjekjen penale të korrupsionit dhe llojeve të tjera të krimit. Përkatësisht, qendra e trajnimit do të sigurojë forcimin e ndërgjegjësimit dhe njohurive në luftën kundër korrupsionit për punonjësit e institucioneve të pushtetit qendror dhe lokal, si dhe publikun e gjerë. Për mbarëvajtjen e kësaj qendre trajnimi është zhvilluar një program trajnimi për luftën kundër korrupsionit, konfliktit të interesit dhe integritetit, si dhe një program trajnimi për trajnerë për ekipin e KSHPK-së.³⁹⁰

Në korrik 2022 KSHPK ka lidhur memorandum për bashkëpunim me Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut.³⁹¹

385 “KSHPK, si lider në sistemin e integritetit, nënshkroi Politikën e Integritetit”, („ДКСК како предводник во системот на интегритет, ја потпиша Политиката на интегритет”), Faqja zyrtare e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit, 11 shkurt 2022, <https://bit.ly/3NAuJBi>.

386 “Komisioni kundër korrupsionit ka tre lëndë të hapura kundër prokurorit të Gostivarit Arsrim Ademi”, („Антикорупциската комисија има три отворени предмети за гостиварскиот обвинител Арсим Адеми”), Telma TV, 14.03.2022, <https://bit.ly/3vOshig>.

387 “KSHPK do të analizojë dhënien e bonove sportive, kërkon që PTHP-ja të nisë procedimin penal ndaj kryetarëve komunal aktual dhe të mëparshëm”, („ДКСК ќе ro анализира доделувањето на спортските ваучери, бара ОЈО да поведе кривична постапка против поранешни и сегашни градоначалници”), Civil media, 15 shkurt 2022, <https://bit.ly/3KhKKcl>. “Çështja e Palermos: Kur do të tregojnë dëshmi zyrtarët e lartë që kanë paguar vetë?”, („Афера Палермо: Кога ќе покажат високите функционери докази дека сами платиле?”), 24 Vesti, 26 mars 2022, <https://bit.ly/3U0ZqSz>.

388 “Komisioni kundër korrupsionit ka dorëzuar iniciativë në PTHP për ndjekje penale të Zeqirit dhe Rashkovskit”, („Антикорупциска поднесе иницијатива до ОЈО за кривично гонење на Зекири и Рашковски”), 360 stepeni, 1 qershor 2022, <https://360stepeni.mk/antikorrupsiska-podne-se-itsijativa-doj-o-za-krivichno-gonene-na-ze-kiri-rashkovski/>.

389 Transparency International, “Raporti i dytë tremujorësh për zbatimin e rekomandimeve nga vlerësimi i cënueshmërisë ndaj korrupsionit në institucionet shtetërore dhe pushtetin vendor në fushën e planifikimit hapësinor, urbanizmit dhe ndërtimit”, („Втор квартален извештај за имплементацијата на препораките од процената на ранливост од корупција во државните институции и локална власт во областа просторно планирање, урбанизам и градежништво”), 18 gusht 2022, <https://bit.ly/3fzZ8c>.

390 “Për një shoqëri pa korrupsion dhe institucione me integritet të fortë, nevojitet edukim i vazhdueshëm dhe angazhim i plotë i secilit prej nesh”, („За општество без корупција и институции со силен интегритет, потребна е континуирана едукација и целосна посветеност на секој од нас”), Faqja zyrtare e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, 22 gusht 2022, <https://bit.ly/3h4n7e6>.

391 “Memorandum për bashkëpunim ndërmjet Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit dhe Bankës Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut”, („Склучен Меморандум за соработка помеѓу Државната комисија за спречување на корупцијата и Народната банка на Република Северна Македонија”), Faqja zyrtare e Komisionit Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit, 18 korrik 2022, <https://bit.ly/3DUqVHL>.

Prokuroria Publike

Raporti i fundit për punën e Prokurorive Publike thekson faktin se stafi i pamjaftueshëm i Prokurorive Publike ndikon në efikasitetin dhe veprimet e disa prej Prokurorive Publike, veçanërisht në punën e PPNKOK. Gjegjësisht, në PTHPNKOK, ku në fund të vitit kanë mbetur padi penale kundër 247 personave ose 35.6%, gjendja është pasojë e numrit të pamjaftueshëm të prokurorëve publikë dhe stafit profesional si dhe pajisjet teknike të pamjaftueshme, të nevojshme për kryerjen e funksionit të ndjekje penale me efikasitet dhe në kohë, duke pasur parasysh strukturën e veprave penale që janë në juridiksionin e kësaj prokurorie publike dhe që kryhen në grup të organizuar, për të cilat është e nevojshme kryerja e procedurave të gjera dhe komplekse parahetimore e hetimore, dhe në disa raste zbatimi i masave të posaçme hetimore.³⁹²

Në Prokurorinë Publike deri më tani janë krijuar katër qendra hetimore, përkatësisht në PTHPNKOK, Prokurorinë Themelore Publike Shkup, Prokurorinë Themelore Publike Tetovë dhe Prokurorinë Themelore Publike Kumanovë me çka mund të konstatohet se nuk ka progres në ngritjen e qendrave hetimore në prokuroritë publike nga viti 2018 deri tani.³⁹³ Gjithashtu duhet theksuar se për forcimin e kapaciteteve të qendrave hetimore tashmë të krijuara është e nevojshme ripajisja e tyre.³⁹⁴

Në periudhën raportuese është publikuar edhe Rregullorja për mënyrën e shpërndarjes së lëndëve në prokuroritë publike përmes sistemit për shpërndarje elektronike të lëndëve.³⁹⁵

Tre ditë pas publikimit të filmit dokumentar “Sekretet Zvicerane” nga Laboratori Investigativ Reporter,³⁹⁶ PTHPNKOK hapi procedurën hetimore paraprake për llogaritë e dy personave nga Maqedonia e Veriut (njëri prej të cilëve është ish zëvendës kryetar i Qeverisë) dhe një investitor suedez. Në veçanti, filmi dokumentar i publikuar përmban informacione sipas të cilave dy biznesmenët maqedonas kanë llogari private në Zvicër dhe kanë kryer transaksione milion dollarëshe me to.³⁹⁷

Sa i përket rasteve të ndërmarra nga ish-Prokuroria Speciale Publike (PSP) dhe efikasitetit të procedimit penal, ka pasur një përparim në rastet “Toplik” dhe “Titanik”. Në veçanti, pranimet e fajësisë së tetë anëtarëve të grupit të gjykuar në çështjen Titan-

392 Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut, “Raport për punën e prokurorive publike të Republikës së Maqedonisë së Veriut në vitin 2021”, („Извештај за работата на јавните обвинителства на Република Северна Македонија во 2021 година”), qershor 2022, <https://bit.ly/3EOkkM7>.

393 Ardita Abazi Imeri et al., “Analizë – Vlerësim gjithëpërfshirës i zbatimit të Strategjisë për Reformën e Sektorit Gjyqësor 2017-2022”, („Анализа – Сеопфатна оценка на спроведувањето на Стратегијата за реформа на правосудниот сектор 2017-2022”), (Instituti për Politikë Evropiane - Shkup, 10 nëntor 2022), <https://bit.ly/3X2nox8>.

394 Ibid.

395 “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 31/2022.

396 https://www.youtube.com/watch?v=CHTWJ_1SRUw&t=17s

397 “Prokuroria hap procedurë para-hetimore për llogaritë e Jordanov, Mehanxhiski dhe Kling”, („Обвинителството отвора предистражна постапка за сметките на Јорданов, Механџиски и Клиг”), nezavisen.mk, 23 shkurt 2022, <https://bit.ly/3Km99xN>.

iku³⁹⁸ u pasuan me gjykime.³⁹⁹ Procedurat gjyqësore kundër ish-kryetarit të Qeverisë, Nikolla Gruevski dhe të akuzuarve të tjerë të cilët nuk e kanë pranuar fajësinë, vazhdojnë.⁴⁰⁰ Gjithashtu, për të kërkohet sërish ekstradimi, pra kthimi në vend, ku e presin tre dënime me burg, dy të plotfuqishme dhe një të shkallës së parë, por edhe procese gjyqësore që janë në vijim. Ish-kryeministri u dënua ligjërisht me një vit e gjysmë burg për çështjen “Dhuna në qendër”, dy vjet burg për çështjen “Tenk” për blerjen e Mercedesit luksoz qeveritar dhe në shkallë të parë nëntë vite burg për çështjen “TNT” për shembjen të “Kosmos”.⁴⁰¹

Seanca kryesore për çështjen “Toplik” është mbajtur më 16 shkurt 2022, në të cilën⁴⁰² prokurori, sipas provave të paraqitura në fjalën përfundimtare të seancës, ka kërkuar nga ish-ministri i Transportit dhe Lidhjeve dhe pesë ish-anëtarët e tjerë të Komisionit të Prokurimit Publik në të njëjtën ministri të dënohen me burg.⁴⁰³

Në mars të vitit 2022, Prokurori i Përgjithshëm i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Kryerevizori shtetëror nënshkruan një Memorandum për forcimin e komunikimit institucional.⁴⁰⁴

Në mars të vitit 2022, më shumë se një vit pas marrjes së gjykimit të shkallës së parë, në Gjykatën e Apelit – Shkup filloi gjykimi për rastin e përgjimit masiv “Target-Tvrdina”.⁴⁰⁵

Në periudhën raportuese, është shënuar progres në efikasitetin e procedimeve penale në disa raste të korrupsionit të profilit të lartë dhe shpërdorimit të kompetencës zyrtare nga zyrtarë të lartë shtetërorë. Në mars 2022, në dy rastet e profilit të lartë u ndërmorën këto hapa: në rastin “Software”⁴⁰⁶ pati argumente hapëse,⁴⁰⁷ ndërsa në rastin “Bashkimi Ndërkombëtar”⁴⁰⁸ fjalë mbyllëse.⁴⁰⁹ GJSRMV ka konfirmuar dënimin me burg për të pandehurit e parë në rastin “Reket”, ku ish-prokurorja speciale publike

398 “Kush do të fundoset me Titanikut”: Janakieski, Jankuloska dhe Protogjer pranojnë fajësinë për keqpërdorime zgjedhore,” („Koj ќе потоне со „Титаник”: Јанакиески, Јанкулошка и Протоѓер признаа вина за изборните злоупотреби”), Deutsche Welle, 11 shkurt 2022, <http://bitly.ws/vVWWh>.

399 “Gjykimi i “Titanikut”: Janakieski dënohet me 4,5 vjet, Jankuloska me 2,5 vjet burg,” („Пресуда „Титаник”: Јанакиески осуден на 4,5 години, Јанкулошка на 2,5 години затвор”), Deutsche Welle, 28 shkurt 2022, <http://bitly.ws/vVWWh>.

400 Ibid.

401 “Gruevskin e presin 12 vjet e gjysmë burg dhe një tjetër kërkesë për ekstradim,” („Груевски Го Чекаат 12 и Пол Години Затвор и Уште Едно Барање За Екстрадиција”), mkd.mk (12.09.2022) <<https://www.mkd.mk/makedonija/sudstvo/gruevski-go-chekaat-12-i-pol-godini-zatvor-i-ushte-edno-baranje-za-ekstradicija>> .

402 “Rasti “Toplik” para zgjidhjes gjyqësore,” („Случајот „Топлик” пред судска разрешница”), TV 24, 16 shkurt 2022, <https://bit.ly/3r8bSn3>.

403 Ibid.

404 Akademik.mk, “Forcim i komunikimit institucional ndërmjet Prokurorisë Publike dhe Entit Shtetëror të Revizionit,” („Закјакнување на институционалната комуникација меѓу Јавното обвинителство и Државниот завод за ревизија”), 10 mars 2022, <https://bit.ly/3NR1kSZ>.

405 “Dëgjimi publik mbi përgjimet masive në Gjykatën e Apelit,” („Во Апелација Тече Јавна Седница За Пресудата За Масовното Прислушување”), 360 stepeni, mars 2022, <https://bit.ly/3DN7T8r>.

406 Sloboden pečat, “Fjalët hyrëse në rastin “Software,” („Воведни зборови во случајот „Софтвери”), 14 mars 2022, <https://bit.ly/3uglZi0>.

407 Ish-sekretari i përgjithshëm i Qeverisë Rashkovski thekson se nuk ndihet fajtor, ndërsa prokurorja Ruskoska pohon se do të dëshmojë se ai e ka keqpërdorur detyrën për përfitime personale.

408 “I pandehuri Bojan Jovanovski thekson se nuk ndihet fajtor”.

409 “Fjalët e fundit të Bojan Jovanovskit në rastin “Bashkimi Ndërkombëtar,” („Завршни зборови на Бојан Јовановски во случајот „Меѓународен сојуз”), TV Telma, 18 mars 2022, <https://bitly/36Uu01S>.

është dënuar me shtatë vjet burgim, ndërsa personazhi i njohur televiziv me nëntë vjet burg.⁴¹⁰ Po ashtu, ish-ministri i Transportit dhe Lidhjeve, si i akuzuar i parë në rastin “Toplik”, është shpallur fajtor nga Gjykata Themelore Penale Shkup dhe është dënuar me tre vjet e gjysmë burg.⁴¹¹ Në të njëjtin rast, kryetari i Komisionit të Prokurimit Publik është dënuar me tre vjet burg, ndërsa të akuzuarit e tjerë anëtarë të Komisionit janë dënuar me dy vite burgim me kusht.⁴¹² Gjithashtu, Gjykata Themelore Penale Shkup i shpalli fajtorë ish-kryeministrin dhe ish-sekretarin e përgjithshëm të qeverisë për keqpërdorim të detyrës dhe autorizimeve në rastin “Talir 2”, ku i pari u dënua me gjashtë vjet burgim, ndërsa i dyti mori një dënim me kusht.⁴¹³ Në periudhën raportuese ka vazhduar gjykimi i rastit “Software”, ku i akuzuari i parë është ish-Sekretari i Përgjithshëm i Qeverisë. Domethënë, procesi gjyqësor është në procedurë provash, me të cilën janë mbajtur një sërë dëshmish për rastet në të cilat ai akuzohet – blerje të softuerit për kundërvajtje në komunikacion⁴¹⁴ dhe blerje të softuerit për identifikim biometrik.⁴¹⁵

Për aferën “Palermo”, e cila shkaktoi reagime në opinion, në një deklaratë për mediat, ministri i Drejtësisë pranoi se ka paguar vetëm akomodimin dhe se nuk ka paguar biletë ose fluturim charter, as hyrje për ndeshjen e futbollit ndërmjet Italisë dhe Maqedonisë së Veriut.⁴¹⁶ Prokuroria Publike ka thënë se derisa të ketë shkresë zyrtare nga Qeveria nuk do të punojë në këtë rast, sepse deri më tani nuk është shprehur dyshimi për vepër penale, por është shkelje e kodit etik të Qeverisë, gjyqtarëve dhe prokurorëve.⁴¹⁷ Edhe KSHPK-ja deklaroi se për momentin nuk do të paraqesin iniciativë, por se do ta monitorojnë me kujdes rastin.⁴¹⁸ Sipas të lartpërmendurës, Zëvendëskryeministri për Politikën Ekonomike dhe Qeverisjen e Mirë, bazuar në informacionet dhe të dhënat e marra nga Ministri i Drejtësisë, i ka dërguar një paralajmërim me shkrim Ministrit të Drejtësisë për shkelje të nenit 12 dhe 17 të Kodit të Etikës të anëtarëve të Qeverisë,⁴¹⁹ pra për

410 “Gjykata Supreme ia konfirmoi dënimin me burg Katica Janevës dhe Bojan Jovanovskit për “Reket”, („Врховен им ги потврди затворските казни на Катица Јанева и Бојан Јовановски за „Рекет“”), A1 On, 1 qershor 2022, <https://a1on.mk/macedonia/i-vrhoven-im-gi-potvrdi-zatvoranite-kazni-na-katica-janeva-i-bojan-jovanovski-za-reket/>.

411 „Tre vjet e gjysmë burg për Janakieskin në “Toplik”, („Три и пол години затвор за Јанакиевски во „Топлик“”), 360 stepeni, 5 prill 2022, <https://360stepeni.mk/tri-i-pol-godini-zatvor-za-janakieski-vo-toplik/>.

412 Ibid.

413 „6 vjet burg për Gruevskin për ndërtimin e selisë së VMRO-DPMNE, dënim me kusht për Bozhinovskin”, („6 години затвор за Груевски за изградбата на седиштето на ВМРО-ДПМНЕ, условна за Божиновски”), MKD, 8 qershor 2022, <https://www.mkd.mk/makedonija/sudstvo/presuda-za-talir-2>.

414 “Gjykimi për “Software”: Ekspert dëshmoi se softueri i Rashkovskit nuk ishte funksional”, („Судење за „Софтвери”: Вештак сведоче дека софтверот на Рашковски не бил функционален”), 360 stepeni, 21 shtator 2022, <https://360stepeni.mk/sudene-za-softveri-veshtak-svedocheshe-deka-softverot-na-rashkovski-ne-bil-funktsionalen/>.

415 „AMDHP i dërgoi Rashkovskit një udhëzim përpara se të prokuronte softuerin e identifikimit biometrik”, („ДЗЛП Му Пратила Укажување На Рашковски Пред Да Го Набави Софтверот За Биометриска Идентификација”), 360 stepeni, 28 shtator 2022, <https://360stepeni.mk/dzlp-mu-pratila-ukazuvane-na-rashkovski-pred-da-go-nabavi-softverot-za-biometriska-identifikatsija/>.

416 “Tupançeski pranoi se nuk ka paguar për fluturimin charter dhe biletat për tribunën VIP”, („Тупанчески призна дека не го платил charter-летот и картите за ВИП-трибината”), A1 On, 5 prill 2022, <https://bit.ly/3GkRS97>.

417 “Prokuroria në pritje të Komisionit Kundër Korrupsionit për rastin “Palermo”, („Обвинителството ја чека Антикорупциската комисија за случајот „Палермо“”), 24 Vesti, 02.04.2022, <https://24.mk/details/obvinitelstvoto-ja-cheka-antikorupciska-komisija-za-sluchajot-palermo>.

418 Ibid.

419 “Kodi i sjelljes etike për anëtarët e Qeverisë dhe bartësit e funksioneve publike të emëruar nga Qeveria” („Кодекс за етичко однесување за членовите на Владата и носителите на јавни функции именувани од страна на Владата”), (Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, 22 shtator 2020), <https://bit.ly/3gUeqIq>.

përplasje të interesit publik dhe privat dhe marrjen e dhuratës – në kundërshtim me kodin.⁴²⁰ Gjithashtu, Këshilli Gjyqësor, i cili shqyrtoi nëse është shkelur kodi i etikës⁴²¹ nga kryetari i Gjykatës Themelore Kavadar, konstatoi se nuk ka konflikt interesi.⁴²²

PTHP tërhoqi një pjesë të akuzës për shpërdorim të pozitës zyrtare dhe kompetencave ndaj ish-ministrit të Transportit dhe Lidhjeve për rastin “TNT”, që i referohet prishjes së paligjshme të objektit “Kosmos” në Gazi Babë në vitin 2011.⁴²³ PTHP ka theksuar se nga provat e paraqitura deri më tani nuk rezulton se i akuzuari ka kryer veprën penale të keqpërdorimit të tenderit për prishjen e objektit.⁴²⁴ Në gjykimin e shkallës së parë i pandehuri është dënuar me tre vjet burg.⁴²⁵

PTHPNKOK ka lëshuar urdhër për zhvillimin e procedurës hetimore ndaj ish-sekretarit të përgjithshëm në Qeveri për keqpërdorim të pozitës zyrtare dhe autorizimit në dëm të buxhetit të Maqedonisë së Veriut. Procedura hetimore është duke vazhduar.⁴²⁶ Hetimi për ish-sekretarin e përgjithshëm të Qeverisë ka mundur të zgjerohet sepse gjatë dhënies së provave është gjetur dokumentacion shkresor që tregon se i dyshuari ka kryer edhe një vepër tjetër penale keqpërdorim i pozitës dhe autoritetit zyrtar, për çka Gjykata e Apelit – Shkup ka vendosur se hetimi do të duhej të zgjerohet edhe për atë ngjarje penalo-juridike.⁴²⁷ Në gusht të vitit 2022, Prokuroria për Krimin e Organizuar zgjeroi hetimin edhe për një tjetër ngjarje penalo-juridike – kontratë e lidhur me një person juridik për shërbime konsulce për riorganizimin e një ndërmarrje publike, e cila dyshohet se është lidhur pa procedurë tenderi⁴²⁸

Prokuroria Publike e Republikës së Maqedonisë së Veriut (PPRMV), me ankesë nga Drejtoria e Policisë Financiare (DPF), ka kryer mbikëqyrje dhe kontroll në një lëndë të regjistruar në PTHPNKOK. Në përputhje me situatën e krijuar, prokurori publik i

420 “Vërejtje me shkrim për ministrin Tupançeski, ka shkelur kodin etik të qeverisë”, („Писмена опомена за министерот Тупанчески, го прекршил владиниот етички кодекс“), 24 Vesti, 6 prill 2022, <https://24.mk/details/pismena-opomena-za-ministerot-tupanchevski-go-prekrshil-vladaniot-etichki-koдекс>.

421 “Kodi i etikës për gjyqtarët dhe juristët”, („Кодекс за етика на судиите и судските поротници“), (Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, shtator 2019), <http://bitly.ws/vVX4>.

422 “Tupançeski pranoi se nuk ka paguar për fluturimin çarter dhe biletat për tribunën VIP”, („Тупанчески призна дека не го платил чартер-летот и картите за ВИП-трибината“), A1 On, 5 prill 2022, <https://bit.ly/3GkRS97>.

423 “TNT: Prokurori kërkoj dënime me burg për Gruevskin dhe të pandehurit e tjerë, për Janakieskin ka tërhequr një pjesë të akuzës”, („THT: Обвинителот побара казни затвор за Груевски и другите обвинети, за Јанакиевски повлече дел од обвинението“), 360 stepeni, 27 prill 2022, <https://bit.ly/3sSK5Y8>.

424 Ibid.

425 “Mbetën akuzat kundër ish-kryeministrit Nikolla Gruевski si i pandehur i parë, ish-kryetari i komunës së Gazi Babës, Toni Trajkovski, Elizabeta Najdovska, atëherë e punësuar si inspektore e ndërtimit në komunë, si dhe tre zyrtarë nga komuna e Gazi Babës. Për këtë, i akuzuari i parë është dënuar me nëntë vjet burgim nga Gjykata Penale e Shkupit, ndërsa të akuzuarit e tjerë të përmendur janë dënuar me katër vjet burgim. “Nëntë vjet burg për Gruевskin dhe tre për Janakieskin, të dënuar në rastin TN”, („Девет години затвор за Груевски и три за Јанакиевски, пресудени во случајот ТН“), Nova Makedonija, 20 maj 2022, <https://www.novamakedonija.com.mk/featured/devet-godini-zatvor-za-gruevski-za-tnt/>.

426 “Zequiri mbetet në paraburgim – Apeli e refuzoi ankesën”, („Зекири останува во притвор – Апелација ја одби жалбата“), 360 stepeni, 31 maj 2022, <https://360stepeni.mk/zequiri-ostanuva-vo-pritvor-apelatsija-ja-odbi-zhalbata/>.

427 “Hetim i ri për Zeqirin për vepër penale të ngjashme”, („Нова истрага за Зекири за слично кривично дело“), vesti.mk, 8 korrik 2022, <https://www.vesti.mk/article/62c85602075b2192cacefb36>.

428 “Zgjerohet hetimi kundër ish-sekretarit të përgjithshëm të qeverisë Muhamed Zeqiri”, („Проширена истрагата против поранешниот генерален секретар на владата Мухамед Зекири“), Skopje 24, 8 gusht 2022, <http://bitly.ws/vVXb>.

Republikës së Maqedonisë së Veriut ka lëshuar një udhëzim për PTHPNKOK, ku përmended parregullsitë e konstatuara në trajtimin e rastit konkret.⁴²⁹ Në përgjigje të kësaj, kreu i PTHPNKOK u bëri thirrje institucioneve kompetente në vend dhe institucioneve ndërkombëtare, si dhe ambasadave, para së gjithash Ambasadës Amerikane dhe Zyrës së BE-së, që të kontrollojnë të gjitha faktet dhe të sqarojnë se kush në vend po lufton krimin dhe kush e ka kryer krimin.⁴³⁰ Lidhur me këtë letër të hapur ka reaguar ashpër Shoqata e Prokurorëve Publikë, e cila thekson se dëmton reputacionin e prokurorisë publike dhe cenon rëndë Kodin e Etikës së Prokurorëve Publikë.⁴³¹ Më pas, DPF ka paraqitur kallëzim penal në Prokurorinë Themelore Publike Shkup në lidhje me bastisjen e kryer nga PTHPNKOK në rastin kontestues.⁴³² Një javë më vonë, PPRMV njoftoi se është paraqitur propozim për procedim disiplinor ndaj tre prokuroreve (njëra prej tyre është kryetare e PTHPNKOK, e cila është pezulluar përkohësisht nga pozita e saj), të cilat qëllimisht kanë bërë një gabim të madh profesional.⁴³³ Në të njëjtën kohë, drejtori i DPF-së ka dhënë dorëheqje nga pozita e tij, duke thënë se këtë vendim e ka marrë për të mos pasur asnjë dyshim në opinion për integritetin, paanshmërinë dhe pavarësinë e procedurës që vazhdon të zhvillohet në PTHPNKOK.⁴³⁴ Kryetarja e PTHPNKOK e ankmoi pezullimin para Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut (KPPRMV),⁴³⁵ por edhe pse KPPRMV vendos për pezullimin e saj të përkohshëm, një komision i posaçëm disiplinor në kuadër të PPRMV do ta zhvillojë procedurën dhe eventualisht mund të paraqet propozim për shkarkim tek KPPRMV, pas së cilës do të marrin vendim përfundimtar.⁴³⁶ KPPRMV njëzëri e refuzoi ankesën si të pabazuar, ndërsa kryetari i KPPRMV vlerësoi se kanë marrë një nga vendimet më të vështira në punën e tyre, sepse është një rast i ndjeshëm, i cili ka një reagim të madh në opinion,⁴³⁷ me ç'rast kreu i PTHPNKOK u përgjigj se ajo nuk ka ndikuar asnjëherë në

429 "Njoftim nga PP: Veprim sipas parashtrës nga Drejtoria e Policisë Financiare", („Соопштение од ЈО: постапување по претставка од Управата за финансиска полиција"), Akademik, 1 gusht 2022, <https://akademik.mk/soopshtenie-od-jo-postapuvane-po-pretstavka-od-upravata-za-finansiska-politsija/>.

430 „Muaremi tek Ruskovska: Krimi vërtetohet në institucione", („Муареми до Русковска: Криминал се докажува во институциите"), Deutsche Welle, 4 gusht 2022, <https://www.dw.com/mk/muaremi-do-ruskovska-kriminal-se-dokazuva-vo-instituciite/a-62704465>.

431 „Shoqata e Prokurorëve Publikë për Ruskovskën: Asnjë prokuror publik nuk duhet të konsiderohet i gjithëfuqishëm", („Здружение на јавни обвинители до Русковска: Ниту еден јавен обвинител не смее да се смета за семоќен"), Pravdiko, 4 gusht 2022, <http://bit.ly/3XOGGo9>.

432 „Policia financiare me padi penale kundër Ruskovskës dhe prokuroreve, drejtori Muaremi nuk bën me dije për cilën veprë", („Финансиската полиција со кривични пријави за русковска и обвинителките, директорот Мурем не открива за кое дело"), Sakam da kazam, 8 gusht 2022, <https://bit.ly/3UVufl8>.

433 „Joveski pezullon Vllima Ruskovskën, procedurë disiplinore ndaj dy prokuroreve të tjera", („Јовески ја суспендира Вилма Русковска, дисциплинска постапка против уште две обвинители"), Siloboden Peçat, 16 gusht 2022, <https://bit.ly/3XOGGo9>.

434 „Muaremi tërhiqet nga pozita e ushtuesit të detyrës - drejtor i Drejtorisë së Policisë Financiare", („Муареми се повлекува од позицијата в.д. директор на Управата за финансиска полиција"), Fokus, 16 gusht 2022, <https://fokus.mk/muaremi-se-povlekuva-od-pozitsijata-vd-direktor-na-upravata-za-finansiska-politsija>.

435 „Ruskovska paraqiti apel për vendimin për suspendimin e saj në Këshillin e Prokurorëve Publikë", („Русковска поднесе жалба за одлуката за нејзината суспензија до Советот на јавни обвинители"), Kanal 5, 19 gusht 2022, <https://kanal5.com.mk/ruskovska-podne-se-zhalba-za-odlukata-za-nejzinata-suspenzija-do-sovetot-na-javni-obviniteli/a543256>.

436 „Për suspendimin e Ruskovskës do të vendosë Këshilli i Prokurorëve Publikë, por jo për shkarkimin e saj", („Советот на јавни обвинители ќе решава за суспензијата на Русковска, но не и за разрешување"), Fokus, 18 gusht 2022, <https://fokus.mk/sovetot-na-javni-obviniteli-ke-reshava-za-suspenzija-ta-na-ruskovska-no-ne-i-za-razreshuvane/>.

437 „Apeli i Ruskovskës u refuzua, pezullimi mbetet", („Отфрлена жалбата на Русковска, суспензијата останува"), Deutsche Welle, 24 gusht 2022, <https://bit.ly/3Nqo3h>>.

asnjë rast.⁴³⁸ Pas këtij vendimi, në detyrë u zgjodh një prokuror i ri për kohëzgjatjen e pezullimit dhe deri në përfundim të mandatit aktual në nëntor 2022.⁴³⁹ Më 30 shtator 2022, KPPRMV publikoi shpalljen për kreun e ri të PTHPNKOK para përfundimit të mandatit dhe më 7 nëntor 2022, me votën e të gjithë prokurorëve të shtetit do të votohet për kreun e ri.⁴⁴⁰

Prokuroria Publike e Strugës ka paraqitur ankesë kundër një prokurori nga Ohri, për punë të papërgjegjshme – vjetrim të qëllimshëm të më shumë se 14 lëndëve.⁴⁴¹ Në aktakuzën thuhet se ish-prokurori ka shpërdoruar detyrën zyrtare duke lejuar që me vetëdije të skadojnë 14 raste që kanë të bëjnë me vjedhje të energjisë elektrike, dëshmi të rreme, vjedhje dhe vjedhje të rënda.⁴⁴² Prokurori me veprimin e tij ka ndikuar në shkurtimin e të drejtave të palëve, duke ua pamundësuar të drejtën e apelit dhe konsiderohet se këto veprime kanë ndodhur në periudhën 2013-2021.⁴⁴³ Ish-prokurori i akuzuar ishte një nga kandidatët e opozitës për gjyqtar kushtetues, i cili nuk mori mbështetje nga Komisioni për Zgjedhje dhe Emërime.⁴⁴⁴

438 „Ruskovska pas pezullimit të konfirmuar: Nuk kam ndikuar në asnjë çështje, mund të pyesni çilin do prokuror“, („Русковска по потврдната супспензија: На ни еден предмет не сум влијаела, можете да прашате било кој обвинител“), A1 On, 24 gusht 2022, <https://bit.ly/3GI4j5b>.

439 „Trajce Pelivanov emërohet shef i përkohshëm në vend të Ruskovskës së suspenduar“, („Трајче Пеливанов назначен за привремен шеф на местото на супсцендираната Русковска“), 360 stepeni, 29 gusht 2022, <https://360stepeni.mk/trajche-pelivanov-naznachen-za-privremen-na-shef-mestoto-na-suspendiranata-ruskovska/>.

440 „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 216/2022.

441 „Prokurori me dashje ka vjetëruar 14 lëndë gjyqësore“, („Обвинител намерно застарил 14 судски предмети“), Alsat M, 19 shtator 2022, <https://alsat.mk/mk/obvinitel-namerno-zastaril-14-sudski-predmeti/>.

442 „Gjyqtari kushtetues i pagjykuar Voislav Dimovski u akuzua për lëndë të vjetëruara“, („Несудениот уставен судија Воислав Димовски доби обвинение за застарени предмети“), TV Telma, 19 shtator 2022, <https://telma.com.mk/2022/09/19/nesudeniost-ustaven-sudija-voislav-dimovski-dobi-obvine-nie-za-zastareni-predmeti/>.

443 „Prokurori me dashje ka vjetëruar 14 lëndë gjyqësore“, („Обвинител намерно застарил 14 судски предмети“), Alsat M, 19 shtator 2022, <https://alsat.mk/mk/obvinitel-namerno-zastaril-14-sudski-predmeti/>.

444 „Voislav Dimovski nuk ka marrë mbështetje për gjyqtar kushtetues nga Komisioni për Zgjedhje dhe Emërime“, („Воислав Димовски не доби поддршка за уставен судија од Комисијата за прашања на изборите и именувањата“), Nova Makedonija, 9 shtator 2022, <https://bit.ly/3UltKS3>.

KUADRI LIGJOR

Ndryshimet në Kodin Penal (KP), për të cilat Kuvendi në dhjetor 2021 filloi një debat publik, parashikon harmonizimin e plotë me Konventën e Stambollit.⁴⁴⁵ Është veçanërisht e rëndësishme që propozimi zbaton Konventën e Stambollit duke vendosur vepra të reja penale që përfshijnë dhunën me bazë gjinore, duke ripërcaktuar ato ekzistueset, si dhe duke shtrënguar politikën penale në lidhje me këto krime, si dhe ndërhyjnë në krimet që lidhen me sigurinë e gazetarëve, ndryshohen dispozita të caktuara në sferën e konfiskimit dhe torturës dhe KP është harmonizuar me Direktivën (BE) 2017/1371 për luftimin e mashtrimit në lidhje me interesat financiare të Bashkimit duke zbatuar ligjin penal.

Krahas këtyre ndryshimeve që janë në procedurë parlamentare, paralelisht grupi i punës i ngritur në Ministrinë e Drejtësisë punoi për përgatitjen e një kodi penal krejtësisht të ri. Drafti i ri i tekstit të KP u publikua në ENER në korrik 2022.⁴⁴⁶ Përgatitja e kodit të ri penal synon të sigurojë harmonizim me direktivat e BE-së në fushën e dënimit, duke ripërcaktuar krimet që lidhen me terrorizmin në përputhje me standardet ndërkombëtare, si dhe krimet e reja që lidhen me mbrojtjen e mjedisit.⁴⁴⁷ Arsyet për afrimin e hartimit të një KP të ri janë: rikodifikimi i të gjitha veprave penale të parashikuara nga ligje të tjera, ripërcaktimi i politikës ekzistuese penale në caktimin e dënimeve, përafrimi me instrumentet ndërkombëtare (Konventa e Stambollit, Direktiva e BE-së për mashtrimin financiar dhe të tjera), ripërcaktimi i krimeve që lidhen me mbrojtjen e mjedisit, ripërcaktimi i dispozitave për konfiskimin, përmirësimi i dispozitave për sigurinë e mjekëve dhe gazetarëve, por edhe tejkalimi i mangësive të tjera të evidentuara.⁴⁴⁸

Grupi punues për hartimin e Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurë penale (LPP) ende është duke punuar në përgatitjen e tekstit, me mbledhjen e fundit të grupit punues të mbajtur në maj të vitit 2022 dhe do të vazhdojë punën në periudhën e ardhshme duke filluar nga shtatori 2022, kështu që një draft tekst duhet të përgatitet në fund të vitit 2022.⁴⁴⁹ Qëllimet kryesore që duhet të arrihen me këto ndryshime janë: harmonizimi me direktivat e BE-së lidhur me të drejtën e përkthimit dhe interpretimit në procedurë penale, të drejtën e informimit në procedurën penale, mbrojtjen e të

445 Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, "Materiale - Propozim për Ligjin për ndryshim dhe plotësim të Kodit Penal", („Материјали — Предлог на Закон за изменување и дополнување на Кривичниот законик“), <https://www.sobranie.mk/materijali-parlament.nspx>.

446 Regjistri Kombëtar Elektronik i Rregulloreve të Republikës së Maqedonisë së Veriut - ENER, "Propozimi i Kodit Penal", ("Предлог на Кривичниот Законик"), 7 korrik 2022, https://ener.gov.mk/Default.aspx?item=pub_regulation&subitem=view_reg_detail&itemid=74071.

447 Elena Georgievska et al., "Zbatimi i Strategjisë për Reforma në Sektorin Gjyqësor (2018–2022) në 2021: Raport në hije", („Спроведувањето на Стратегијата за реформа на правосудниот сектор (2018–2022) во 2021 година: Извештај во сенка“), mars 2022, <https://myla.org.mk/wp-content/uploads/2022/05/Sproveduvanjeto-na-strategijata-za-reforma-na-pravosudniot-sektor-2018-2022-lzvestaj-vo-senka.pdf>.

448 Ardita Abazi Imeri et al., "Analizë - Vlerësim gjithëpërfshirës i zbatimit të Strategjisë për Reformën e Sektorit Gjyqësor 2017–2022", („Анализа — Географна оценка на спроведувањето на Стратегијата за реформа на правосудниот сектор 2017–2022“), (Instituti për Politikë Evropiane - Shkup, 10 nëntor 2022), <https://bit.ly/3X2nox8>.

449 Ibid.

dhënave personale në kuadër të bashkëpunimit në çështjet penale, standardet për të drejtat, mbështetjen dhe mbrojtjen e viktimave të krimeve, tejkalimin e interpretimit të pabarabartë dhe zbatimit praktik të pabarabartë të disa dispozitave, saktësimin e dispozitave lidhur me caktimin, zgjatjen dhe anulimin e masës së paraburgimit dhe specifikimin e dispozitave për zgjidhjen e sanksionit penal.

Ligji për origjinën e pronës⁴⁵⁰ është ende në përgatitje⁴⁵¹, dhe është planifikuar të dërgohet për mendim tek Komisioni i Venecias. Zëvendëskryetarja e Qeverisë e ngarkuar për politikat dhe qeverisjen e mirë në maj 2022 bëri të ditur se ligji do të miratohet me kujdes sepse fusha është e ndjeshme dhe duhet të dëgjohen mendime për aspekte të ndryshme. Njëkohësisht, ajo nuk saktësoi se kur mund të pritet miratimi i ligjit, i cili paralajmëroi se do të shkojë në seanca të gjera publike, jo vetëm në Kuvend.⁴⁵²

Në fillim të nëntorit 2021, ENER publikoi propozim ligjin për Zyrën e Rimëkëmbjes të Pronës. Deri më tani, në Republikën e Maqedonisë së Veriut, çështja e Zyrës për Rimëkëmbjen e Pronës nuk ishte e rregulluar me ligj. Duke marrë parasysh standardet e shumta ndërkombëtare në këtë fushë, u imponua nevoja për rregullimin ligjor të kësaj çështjeje dhe inkorporimin e të gjitha standardeve ndërkombëtare në një kornizë ligjore. Ky ligj ka për qëllim të rregullojë themelimin, kompetencat, autorizimet dhe strukturën organizative të Zyrës së Rimëkëmbjes së Pronës, përgjegjëse për ndërmarrjen e aktiviteteve në lidhje me gjetjen dhe identifikimin e të ardhurave, pronës ose shfrytëzim pronësor që kanë rezultuar ose janë të lidhura me një vepër penale që mund të jetë objekt i ndalimit të përkohshëm të përdorimit ose konfiskimit, shshkëmbimi i praktikave më të mira dhe mbajtjes së të dhënave statistikore.⁴⁵³

Më 15 korrik 2022 ENER publikoi propozim ligjin për menaxhimin e pronës së konfiskuar, shfrytëzimit pronësor dhe mjeteve të konfiskuar në procedurë penale dhe kundërvajtëse. Zbatimi i zgjidhjes së mëparshme ligjore ka shfaqur disa dobësi dhe zbrazëtira ligjore të cilat janë tejkaluar me disa ndryshime dhe plotësime në ligj, por nevojitet edhe një tekst i ri ligjor për të trajtuar ato dobësi dhe zbrazëtira. Ndryshimet kryesore të propozuara në ligj janë: përmirësimi terminologjik dhe barazimi i shprehjeve të ligjit me propozimet për ndryshime dhe shtesa të reja në KP dhe LKP, të cilat janë në fazën përgatitore, përmirësimi terminologjik i dispozitave të ligjit në drejtimin e harmonizimit

450 Iva Conevska Vangellova dhe Ismail Kamberi, "Raport në hije për kapitullin 23 për periudhën nga prilli 2020 deri në shtator 2021", („Извештај во сенка за Поглавје 23 за периодот од април 2020 до септември 2021“), Shkup 2021, <https://bit.ly/3DQ0hOx>.

451 „Ivanovska: Shteti duhet të mbrojë qytetarët në emër të të cilëve politikanët duan të transferojnë pronat“, („Ивановска: Државата да ги заштити граѓаните на чие име политичарите бараат да префрлат имот“), Sloboden Peçat, 11 shkurt 2022, <https://bit.ly/3L0o448>.

452 „Grkovska: Ligji për origjinën e pronës do të miratohet me kujdes“, („Грковска: Законот за потекло на имот ќе се донесува внимателно“), Fokus, 20 maj 2022, <https://fokus.mk/grkovska-zakonot-za-poteklo-na-imot-ke-se-donesuva-vnimatelno/>.

453 Regjistri Kombëtar Elektronik i Rregulloreve të Republikës së Maqedonisë së Veriut – ENER, „Propozim i Ligjit për Zyrën për Rimëkëmbje të Pronës“, („Предлог на Закон за канцеларија за поврат на имот“), 1 nëntor 2021, https://ener.gov.mk/default.aspx?item=pub_regulation&subitem=view_reg_detail&itemid=68445.

të tij me legjislacionin përkatës të BE-së dhe përmirësimin e afateve dhe mënyrës së veprimit në procedura të veçanta të Agjencisë për menaxhimin e pronës së konfiskuar në përputhje me aktet nënligjore. Qëllimi i këtij propozim ligji është tejkalimi i problemeve dhe sfidave që dalin në praktikën aktuale, të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin e pronës së konfiskuar, shfrytëzimi pronësor dhe mjeteve të konfiskuara në procedurë penale dhe kundërvajtëse, si dhe mundëson funksionimin funksional të Agjencisë për Menaxhimin e Pronës të Konfiskuar.⁴⁵⁴

E rëndësishme është të ndiqen udhëzimet e KE në Raportin vjetor për progresin e shtetit në pjesën e luftës kundër korrupsionit: të rritet mbështetja e institucioneve shtetërore që zbatojnë Strategjinë Kombëtare për Luftimin e Korrupsionit dhe Konfliktit të Interesit dhe të zbatohen në mënyrë efektive rekomandimet e GRECO-s, të ndahet burime të mjaftueshme për PTHPNKOK, përfshirë dhe ekspertë financiarë, me qëllim që të sigurohet llogaridhënie efektive për rastet e korrupsionit të nivelit të lartë dhe për të vazhduar rritjen e numrit të dënimeve përfundimtare në rastet e korrupsionit të nivelit të lartë.

Është e nevojshme të punohet për vlerësimin e rreziqeve të klientelizmit dhe kronizmit dhe, sipas këtij vlerësimi, të bëhen ndryshime në ligjet përkatëse të fushës.

Raporti i fundit për punën e Prokurorive Publike vë në dukje se mungesa e personelit të Prokurorive Publike ndikon në efikasitetin dhe veprimet e disa prej Prokurorive Publike, prandaj duhet të punohet mbi këtë problem. Në të njëjtën kohë, nevojitet progres në ngritjen e qendrave të reja të hetimit dhe ripajisjen e qendrave ekzistuese.

Statistikë të ngjashme tregojnë edhe Raporti vjetor për efikasitetin e mbrojtjes ligjore të drejtave të njeriut në Republikën e Maqedonisë së Veriut për vitin 2021, i publikuar nga Shoqata e Juristëve të Rinj Maqedonas: buletinet ditore të MPB-së treguan se gjatë vitit paraprak, janë regjistruar gjithsej 29 krime kundër lirisë seksuale dhe moralit seksual, dhe nga numri i përgjithshëm, 11 raporte i referohen viktimave femra.⁵⁹²

Në bazë të ankesës së paraqitur ndaj autorëve dhe redaktuesve të tekstit të Sociologjisë për vitin e tretë të arsimit të mesëm të reformuar dhe ndaj Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (MASH), KSZD konstatoi ngacmime të vazhduara dhe të shumëfishta në bazë

589 “Higjiena menstruale nuk është privilegj!” – Protesta para Ministrisë së Financave”, („Менструалната хигиена не е привилегија! – Протест пред Министерството за финансии”), Faqja zyrtare e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 30 maj 2022, <https://mh.org.mk/news/rodova-ednakvost/menstrualnata-higiena-ne-e-privilegija-protest-pred-ministerstvoto-za-finansii/>.

590 “Avokati i Popullit mbështeti fushatën për të luftuar dhunën në internet ndaj grave”, („Народниот правобранител ја поддржа кампањата за борба против онлајн-насилството врз жените”), Faqja zyrtare e Avokatit të Popullit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 13 qershor 2022, <https://bit.ly/3TAxeok>.

591 „Komiteti i Helsinkit: Trajtimi joprofesional i 33 rasteve të dhunës me bazë gjimore në vitin 2021”, („Хелсиншки: Непрофесионално постапување по 33 случаи на родово-базирано насилство во 2021”), Radio MOF, 13 korrik 2022, <https://www.radiomof.mk/helsinki-neprofesionalno-postapuvanje-po-33-sluchai-na-rod-bazirano-nasilstvo-vo-2021/>.

592 Shoqata Maqedonase e Juristëve të Rinj, “Raport vjetor për efikasitetin e mbrojtjes ligjore të drejtave të njeriut në Republikën e Maqedonisë së Veriut – 2021”, („Годишен извештај за ефикасноста на правната заштита на човековите права во Република Северна Македонија – 2021 година”), dhjetor 2021, <https://bit.ly/3TXs0sU>.

të gjinisë, orientimit seksual, identitetit gjinor, origjinës sociale dhe përkatësisë së një grupi të marginalizuar dhe i rekomandoi MASH-it maksimumi brenda gjashtë muajve të tërheqë nga përdorimi i tekstit e diskutueshëm dhe në të ardhmen të mos miratojë përdorimin e teksteve, përmbajtja e të cilave shkakton ngacmime mbi çdo bazë diskriminuese nga Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara.⁵⁹³ Ministria e Arsimit dhe Shkencës ngriti një komision për tërheqjen e librit të kontestuar.⁵⁹⁴

Në mars të vitit 2022, çështja "Dhoma Publike"⁵⁹⁵ u zgjidh në shkallë të parë, ku autorët u dënuan me katër vite burg.⁵⁹⁶ Organizatat civile shprehën pakënaqësi të thellë për mënyrën e zgjidhjes së çështjes nga gjykata, e cila caktoi një dënim me burg dy herë më pak se sa minimumi i përcaktuar ligjor.⁵⁹⁷ Në qershor, në lidhje me çështjen "Dhoma Publike", u soll një vendim i ri që sanksiononte një person që shpërndante foto eksplicite të viktimës. Edhe pse ky vendim është një sinjal pozitiv nga gjykatat, ndryshimet në KP që u shpallën zgjidhje për këtë lloj çështjesh ende kanë ngecur në Kuvend.⁵⁹⁸

Pas raportimit të rrahjes dhe përdhunimit të një gruaje nga Velesi dhe ndërprerjes së procedurës nga Prokuroria Publike e Velesit, për shkak se nuk kishte dëshmi se i akuzuari e ka kryer dhunimin, KHDNJ-ja dhe SHMJR kanë reaguar për mënyrën e trajtimit të rastit nga autoritetet kompetente.⁵⁹⁹ Të dyja organizatat theksuan se e gjithë procedura hetimore dhe para-hetimore është shoqëruar me shumë mospërputhje: viktimat nuk është trajtuar me vëmendje dhe kujdes të veçantë nga autoritetet pjesëmarrëse në procedurë, ajo është dashur të ritregojë situatën në të cilën është sulmuar disa herë dhe kur është bërë testi me poligraf ajo ka qenë nën ndikimin e ilaçeve. E gjithë kjo në përgjithësi shkakton viktimizimin e dyfishtë për viktimën sipas këtyre organizatave.⁶⁰⁰ Rrjeti kombëtar kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje pati një reagim në

593 "KPMД konstatoi ngacmime të vazhdueshme dhe të përsëritura në librin e Sociologjisë për vitin e tretë", („КСЗД утврди продолжено и повеќекратно вознемирување во учебникот по Социологија за трета година“), Faqja zyrtare e Komisionit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi, 28 dhjetor 2021, <https://bit.ly/3E7C9r7>.

594 "MASH tërheq librin kontrovers të sociologjisë për vitin e dytë", („МОH по повлекува спорниот учебник по социологија за втора година“), TV Sitel, 9 gusht 2022, <https://sitel.com.mk/mon-go-povlekuva-sporni-ot-uchebnik-po-sociologija-za-vtora-godina>.

595 Grupi privat i aplikacionit "Telegram", në të cilin publikoheshin foto dhe të dhëna personale të grave me konotacione pornografike, u zbulua në fillim të vitit 2021. Publikisht, rasti u bë i njohur si "Dhoma Publike", kur viktimat e abuzimit në rrjetet sociale ngritën alarmin për abuzimin nga ndjekësit e rrjeteve sociale, përvojnë poshtëruese për ta dhe mosveprimin e policisë.

596 "Të pandehurit për "Dhomën publike" morën nga katër vjet burg", („Обвинетите за „Јавна соба“ добија по четири години затвор“), Radio MOF, 11 mars 2022, <https://www.radiomof.mk/obvinetite-za-javna-soba-dobija-po-chetiri-godini-zatvor/>.

597 Kodi Penal, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut, nr. 37/1996, neni 193.

598 "Rruga e ashpër drejt drejtësisë për viktimat e Dhomës Publike", („Трнлив пат до правда за жртвите од Јавна соба“), Radio Slobodna Evropa, 9 qershor 2022, <https://bit.ly/3WZmVx0>.

599 "Rikonstrukcioni i veprimeve të organeve të zbatimit të ligjit në raste të përdhunimit", („Реконструкција на постапувањето на органите на прогонот во случај со силување“), 360 stepeni, 5 prill 2022, <https://bit.ly/3hlaA0h>.

600 Ibid.

gusht, për rastet e dhunës në familje në Gostivar,^{601, 602} Negotinë^{603, 604} dhe Strumicë^{605 606}, e cila hapi çështjen se si shteti mbron gratë që vuajnë çdo ditë dhunë në familje dhe dhunë me bazë gjinore. Përkatesisht, organizatat e shoqërisë civile që janë pjesë e Rrjetit reagues ndaj mosveprimit të institucioneve kompetente në lidhje me viktimat, përkundër faktit se Republika e Maqedonisë së Veriut ka ratifikuar Konventën e Stambollit dhe ka miratuar Ligjin e ri për Parandalim dhe Mbrojtjen nga Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Familje në fillim të vitit 2021. Femicidi i 46-vjeçares nga Negotina plotëson statistikën humbëse sipas të cilave më shumë se 80% e viktimave në vend nuk kanë raportuar më parë dhunë në institucionet kompetente.⁶⁰⁷ Mosraportimi i dhunës dhe trajtimi jo adekuat nga institucionet në rastet e dhunës në familje dhe në bazë gjinore rrit drejtpërdrejt gjasat që dhuna të kulmojë me vrasje, dhe nga ana tjetër, shkalla e lartë e mosbesimit në veprimet e institucioneve kompetente, përfshirë policinë, qendrat e punës sociale dhe gjyqësorin, ndikon ndjeshëm që qytetarët të demotivohen për të raportuar dhunën. Sipas Rrjetit, sistemi i përgjithshëm për parandalimin e dhunës nuk funksionon dhe vë në pikëpyetje seriozisht qëllimin e Konventës së Stambollit dhe Ligjit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Familje. Ky reagim ka ardhur nga një rast tjetër i mosveprimit institucional, kësaj radhe nga Qendra Ndërkomunale për Çështje Sociale të Qytetit të Shkupit në një rast konkret, ku edhe pas katër muajsh nga raportimi i viktimës, nuk janë marrë masa të mbrojtjes ndaj dhunës psikologjike në familje të ushtruar nga bashkëshorti i saj, në formën e kërcënimit me jetë, mesazheve shqetësuese, përndjekjes, stresit dhe presioneve të përditshme.⁶⁰⁸

601 Gruaja 27-vjeçare nga Gostivari, nënë e një fëmije të mitur, prej pesë vitesh ka pësuar dhunë në familje nga ish-partneri i saj, përkundër faktit se e ka raportuar në mënyrë të rregullt në institucionet kompetente. Ndaj autorit, i cili është punonjës policie, ka 6 procedime penale aktive, por rruga drejt drejtësisë për viktimën rezultoi e pasuksesshme, për shkak të vendimit të vetëdijshëm të gjykatës për të mbrojtur autorin. Edhe pse Gjykata Themelore e Gostivarit shqiptoi dënime të ulëta, të papërshtatshme për veprën e kryer, problem tjetër është se ato vendime janë shfuqizuar në mënyrë të përsëritur nga Gjykata e Apelit të Gostivarit, kështu që autori mbetet i pandëshkuar, gjë që kontribuon në viktimizimin dytësor për personat që raportojnë dhunën në familje.

602 “Gjykata e Apelit të Gostivarit duhet urgjentisht të nxjerrë vendim gjyqësor me të cilin do të mbrohet Elena Jovicoska dhe do të dënohet autori i dhunës në familje”, („Апелациониот суд Гостивар итно да донесе судска пресуда со која ќе ја заштити Елена Јовицоска и ќе го осуди сторителот на семејно насилство”),- Faqja zyrtare e Rrjetit Kombëtar kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, 5 gusht 2022, <https://bit.ly/3GnCubU>.

603 Pas një grindjeje, burri që jetonte në bashkësi jashtëmartesore me një grua nga Negotina, ka ushtruar dhunë në familje ndaj saj, duke e goditur disa herë në kokë dhe më pas e ka shtyrë drejt banjes, pas së cilës viktima ka rënë dhe ka pësuar lëndime të rënda, nga të cilën ajo ra në koma dhe më vonë, ka vdekur.

604 “Gruaja vdiq pasi u rrah nga Negotinasi me të cilin ishte në bashkim jashtëmartesor, ai do të ndiqet penalisht për një krim më të rëndë”, („Почина жената претепана од неготинецот со кој била во вонбрачна заедница, тој ќе се гони за потешко кривично дело”), Sloboden Pecat, 7 gusht 2022, <https://bit.ly/3hDyeLe>.

605 Një 35 vjeçar nga Strumica është arrestuar për dhunë në familje pasi ka sulmuar me lëndë të mprehtë gruan e tij dhe ka plagosur djalin e tyre të mitur. “Edhe një rast i dhunës në familje në Strumicë”, („Уште еден случај на семејно насилство во Струмица”), MKD, 7 gusht 2022, <https://www.mkd.mk/crna-hronika/ushte-eden-sluchaj-na-semejno-nasilstvo-vo-strumica>.

606 “Njeriu nga Strumica sulmoi gruan e tij me lëndë të mprehtë, plagosi edhe fëmijën e mitur”, („Струмичанец ја нападнал сопругата со остар предмет, го повреди и малолетното дете”), Faktor, 7 gusht 2022, <https://faktor.mk/strumichanec-ja-napadnal-soprugata-so-ostar-predmet-go-povedil-i-maloletno-to-dete>.

607 “Femicidet janë produkt i heshtjes së shoqërisë dhe mosbesimit në institucionet”, („Фемидите се производ на молкот на општеството и недовербата во институциите”), Faqja zyrtare e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut të Republikës së Maqedonisë, 8 gusht 2022, <https://bit.ly/3hCdTWG>.

608 „Rrjeti Kombëtar Kundër Dhunës: A i mbron vërtet shteti gratë viktime të dhunës në familje dhe të dhunës me bazë gjinore”, („Национална мрежа против насилство: Дали државата навистина ги штити жените жртви на семејно и родово базирано насилство”), 24 Vesti, 15 gusht 2022, <https://bit.ly/3UGaFjx>.

KHDNJ, në emër të një vajze që ka kërkuar ndihmë juridike, ka paraqitur një ankesë në KPMD ndaj një prezantuesi televiziv për ngacmim seksual në bazë të seksit dhe gjinisë në fushën e informimit publik dhe medias. Duke vepruar në bazë të kësaj parashprese, KPMD-ja në një episod të emisionit të tij ka prurë një mendim me të cilin ka vërtetuar ngacmimin seksual, nëpërmjet objektivizimit seksual të pamjes së vajzës, duke cenuar dinjitetin e saj dhe duke krijuar një mjedis kërcënues, armiqësor dhe poshtërues. Më pas, KPMD ka dhënë rekomandim që brenda 30 ditëve nga marrja e mendimit dhe rekomandimit të hiqet episodi konkret me përmbajtjen e mësipërme dhe të kërkohet falje publike në emisionin e tij, si dhe të përmbahet nga shfaqja e përmbajtjeve shqetësuese në të ardhmen.⁶⁰⁹

609 „Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në qershor 2022, në emër të një vajze që ka kërkuar ndihmë juridike, ka paraqitur ankesë në Komisionin për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi ndaj Sergej Varoshlia për ngacmim seksual në bazë të seksit dhe gjinisë në fushën e informimit publik dhe medias”, („Хелсиншкиот комитет за човекови права во јуни 2022 година, во име на девојка која побара правна помош, поднесе претставка до Комисија за спречување и заштита од дискриминација против Сергеј Варошлија за сторено сексуално вознемирување врз основа на пол и род во областа на јавно информирање и медиуми“), Faqja zyrtare në Facebook e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 22 shtator 2022, <https://bit.ly/3GcX7aV>.

GJUHA E URREJTJES

Ndryshimet e pritshme të Kodit Penal për krimet e urrejtjes parashikojnë edhe krimin e urrejtjes “në bazë të një ligji ose një marrëveshjeje ndërkombëtare të ratifikuar”, për shkak të luftës kundër gjuhës së urrejtjes, e cila është ndër segmentet kryesore të protokollit dypalësh të nënshkruar së fundmi nga Bullgaria dhe Maqedonia e Veriut. Me këto ndryshime gjuha e urrejtjes nuk do të hyjë në kompetencën e diplomacisë, por vetëm institucionet kompetente do të vlerësojnë se çfarë është gjuhë e urrejtjes dhe në një rast të tillë do të veprojnë sipas ligjit dhe ky akt nuk duhet të lidhet vetëm me Bullgarinë siç shpjeguan Ministri i Punëve të Jashtme dhe Ministri i Drejtësisë.⁶¹⁰

KHDNJ në 2021 ka vërejtur një numër të madh të rasteve të gjuhës së urrejtjes në mediat sociale – 877 raportime në portalin www.govornaomraza.mk, nga të cilat 34% janë raste të gjuhës së urrejtjes sipas përkatësisë etnike, 33% janë raportuar në bazë të orientimi seksual dhe identiteti gjinor, dhe një e pesta e raporteve i referoheshin gjuhës së urrejtjes lidhur me përkatësinë politike.⁶¹¹

Një raport nga monitorimi i gjuhës së urrejtjes në internet kundër romëve, i kryer nga Instituti për Hulumtime dhe Analiza Politike “Romalitiko” dhe Shoqata Rajonale e Rinisë për Arsimin e Romëve,⁶¹² përcaktoi se gjuha e urrejtjes në internet kundër romëve ndodh kryesisht në “Facebook”. Rekomandohet që institucionet të familjarizohen me termin “anticiganizëm”, si një formë specifike e racizmit ndaj romëve. Ky term është pranuar zyrtarisht nga Qeveria në Strategjinë e re për Romët.⁶¹³

Vendbanimi i përkohshëm i anëtarëve të grupit fetar hebre “Lev Tahor”, të cilët mbërritën në Maqedoninë e Veriut nga Bosnja dhe Hercegovina në shkurt 2022 shkaktoi një sërë incidentesh dhe shtoi gjuhën e urrejtjes. Ndonëse Ministria e Punëve të Brendshme, pra Agjencia e Sigurisë Kombëtare, sqaroi se ky grup ka prezencë të përkohshme të rregulluar në vend⁶¹⁴ dhe se nuk përbën asnjë rrezik për sigurinë e qytetarëve në vend, kjo nuk ka penguar shpërthimin e urrejtjes, e cila kërcënonte sigurinë e anëtarëve të këtij grupi. Presioni me të cilin ballafaqoheshin anëtarët e këtij grupi

610 “Gjuha e urrejtjes do të gjykohej vetëm në format më të rënda”, („Говорот на омраза ќе се суди само при најтешките форми”), Sloboden pečat, 26 korrik 2022, <https://www.slobodenpecat.mk/govorot-na-omraza-ke-se-sudi-samo-pri-najteshките-formi/>.

611 Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut të Republikës së Maqedonisë së Veriut, “Raporti vjetor për gjendjen me të drejtat e njeriut në vitin 2021”, („Годишен извештај за состојбата со човековите права во 2021 година”), 20 qershor 2022, <https://bit.ly/300Sy5s>.

612 Shoqata Rinore Rajonale për Arsimin e Romëve – RROMA dhe Instituti për Hulumtime dhe Analiza Politike “Romalitiko”, “Raporti maqedonas nga monitorimi i gjuhës së urrejtjes online kundër romëve”, („Македонски извештај од мониторинг на онлајн-говорот на омраза кон Ромите”), dhjetor 2021, <https://bit.ly/3DMSMb4>.

613 “U mbajt konferenca “Gjuha e urrejtjes kundër komunitetit rom në sferën online si pjesë e anti-ciganizmit”, („Одржана конференцијата “Говор на омраза кон ромската заедница во онлајн-сферата како дел од антициганизмот”), Faqja zyrtare e Institutit për Hulumtime dhe Analiza Politike “Romalitiko”, 18 shkurt 2022, <https://romalitiko.org/index.php/en/vesti/93-news/press-releases/471-konferencija-govor-omraza-kon-romi-mediumi>.

614 “Anëtarët e Lev Tahorit kanë qëndrim të përkohshëm – qeveria bëri thirrje për tolerancë”, („Членовите на “Лев Тахор” имаат привремен престој – власта повика на толеранција”), Radio Slobodna Evropa, 16 shkurt 2022, <https://bit.ly/3U13i5m>.

fetar në Kumanovë vazhdoi në Shkup,⁶¹⁵ ku disa hotele refuzuan të strehonin grupin,⁶¹⁶ dhe anëtarët e grupit u ankuan publikisht se policia ishte më shumë pengesë sesa ndihmë.⁶¹⁷

Në fillim të muajit prill, u mbajt një takim dyditor i ekspertëve të organeve të barazisë të Shqipërisë, Malit të Zi dhe Maqedonisë së Veriut në lidhje me luftën kundër gjuhës së urrejtjes. Anëtarët e KPMD-së përfaqësuan Maqedoninë e Veriut, diskutuan sfidat me të cilat përballen vendet e Ballkanit Perëndimor në luftën kundër gjuhës së urrejtjes dhe shkëmbyen praktika pozitive me vendet e tjera për zbatimin e standardeve evropiane. Kështu, u theksua rëndësia e formimit të aleancave të gjera në luftën kundër gjuhës së urrejtjes dhe ndërgjegjësimit të popullatës në nivel kombëtar, si dhe nevoja e forcimit të bashkëpunimit me gjykatat në temën e diskriminimit me theks në gjuhën e urrejtjes si problem global dhe kërcënim për të drejtat e njeriut.⁶¹⁸

Në mesin e korrikut, një stol shumëngjyrësh në oborrin e shkollës, i lyer me ngjyra që ngjasojnë me ngjyrat e ylberit, nxiti gjuhën e urrejtjes në internet dhe kërkesa që ajo të rilyhet menjëherë, duke bërë që personi i quajtur «kryetari i komunitetit LGBT nga Stojakova» të akuzohet për lyerjen e stolit, duke e bërë atë synim të gjuhës së urrejtjes në internet dhe thirrjeve për sulm fizik. Drejtoresha e shkollës konfirmoi se ky person nuk është i lidhur në asnjë mënyrë me stolin e shkollës dhe ajo është lyer si pjesë e rinovimit të shkollës në dhjetor 2021 dhe ngjyrat nuk synonin aspak të provokonin publikun e gjerë.⁶¹⁹

615 “Grupi hebre nga Kumanova është transferuar në Shkup, MPB apelon për tolerancë”, („Еврејската група од Куманово е префрлена во Скопје, МВР апелира на толеранција“), TV Telma, 15 shkurt 2022, <https://bit.ly/3zrCCD3>.

616 “Disa hotele në Shkup refuzuan të pranonin grupin hebre, („Неколку хотели во Скопје одбиле да ја примат еврејската група“), Faktor, 15 shkurt 2022, <https://bit.ly/3LHkww4>.

617 “Ksenofobia nuk është dukuri e rastësishme në shoqërinë tonë”, („Ксенофобијата не е инцидентна појава во нашето општество“), Faqja zyrtare e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut të Republikës së Maqedonisë, 16 shkurt 2022, <https://bit.ly/35MN38C>.

618 “Maqedonia e Veriut, Mali i Zi dhe Shqipëria bashkë kundër gjuhës së urrejtjes”, („С. Македонија, Ц. Гора и Албанија заеднички против говорот на омраза“), Faqja zyrtare e Komisionit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi, 7 prill 2022, <https://bit.ly/3Ecpbse>.

619 „Stoli shumëngjyrësh shkollor në Stojakovë shkaktoi ofendime për aktivist LGBTI+“, („Училишна шарена клупа во Стојаково предизвика навреди кон ЛГБТИ + активист“), Radio MOF, 13 korrik 2022, <https://www.radiomof.mk/uchilishna-sharena-klupa-vo-stojakovo-predizvika-navredi-kon-lgbti-aktivist/>.

Veprat e urrejtjes

Gjatë vitit 2021 Rreth 80 ngjarje të lidhura me krimin e urrejtjes janë regjistruar nga KHDNJ, që është 20% më pak në krahasim me një vit më parë. Numri më i madh i tyre ka të bëjë me veprën penale të shkatërrimit të pronës dhe gjërave të të tjerëve dhe shkaktimin e urrejtjes, përçarjes dhe intolerancës, si dhe janë vërejtur edhe akte dhune, rrezikimi të sigurisë, grabitje dhe lëndime trupore, kanosje të rënda dhe shkatërrim të simboleve. Shumica e krimeve janë të motivuara nga përkatësia politike dhe etnike e viktimës, dhe motive të tjera përfshijnë përkatësinë fetare, statusin e migrantit dhe orientimin seksual.⁶²⁰

Më 7 maj, kryetari i "LGBTI United"⁶²¹ është sulmuar fizikisht në varrezat e qytetit në Tetovë. Rrjeti Kombëtar Kundër Homofobisë dhe Transfobisë këmbënguli për veprime të menjëhershme dhe të plota të organeve të zbatimit të ligjit dhe një zgjidhje të plotë të këtij rasti.⁶²² Sulmet ndaj presidentit të LGBTI United vazhduan gjatë gjithë vitit, me sulmin e radhës në fillim të gushtit në Strumicë, ku ai ishte me vullnetarët e LGBTI United në një ngjarje publike për të promovuar organizatën e tyre. Gjegjësisht, një burrë i rritur ka filluar ta kërcënojë dhe ofendojë drejtpërdrejt, e më pas i ka shkaktuar lëndime fizike, ndërsa vullnetarët janë larguar nga frika. Rrjeti Kombëtar Kundër Homofobisë dhe Transfobisë e dënoi sulmin dhe kërkoi nga institucionet kompetente që urgjentisht të konfirmojnë identitetin dhe të sanksionojnë autorin e këtij, sipas tyre, akti të urrejtjes.⁶²³ Pas sulmeve të përsëritura ndaj tij, presidenti i "LGBTI United" mbajti një konferencë para Qeverisë, ku u bëri thirrje institucioneve që urgjentisht të identifikojnë personat përgjegjës për sulmet fizike ndaj tij dhe nëse kjo nuk do të ndodhte, deklaroi se do të kamponte në ndërtesën e Qeverisë sepse nuk ndihet i sigurt sa herë që del nga shtëpia.⁶²⁴

620 Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut të Republikës së Maqedonisë së Veriut, "Raporti vjetor për gjendjen me të drejtat e njeriut në vitin 2021", („Годишен извештај за состојбата со човековите права во 2021 година“), 20 qershor 2022, <https://bit.ly/300Sy5s>.

621 "Aktivisti Bekim Asani u sulmua verbalisht dhe fizikisht para nënës së tij", („Вербално и физички нападнат активистот Беким Асани пред очите на неговата мајка“), Faqja zyrtare e Shoqatës LGBTI UNITED Tetovë, 8 maj 2022, <https://bit.ly/3ExJX7b>.

622 "RKHT: Urgjentisht të gjenden sulmuesit e Asanit, institucionet të mos i injorojnë aktet e urrejtjes", („HMXT: Итно да се пронајдат напаѓачите на Асани, институциите да не ги игнорираат делата од омраза“), Faqja zyrtare e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut të Republikës së Maqedonisë, 9 maj 2022, <https://mhc.org.mk/news/nmht-itno-da-se-pronajdat-napagachite-na-asani-instituciite-da-ne-gignorira-delata-od-omraza/>.

623 „Aktivistët kërkojnë reagim të menjëhershëm për sulmin ndaj Asanit nga "LGBTI United", („Активистите бараат итна реакција за нападот на Асани од „ЛГБТИ Јунајтед“), Radio MOF, 10 gusht 2022, <https://www.radiomof.mk/aktivistite-baraat-itna-reakcija-za-napadot-na-asani-od-lgbti-junajted/>.

624 "Nëse nuk dënohen personat që më sulmuan, do të ngre një tendë në Qeveri për të qenë i sigurt", thotë aktivisti LGBTI Asani, („Ако не се казнат луфето кои ме нападнаа ќе поставам шатор во Владата за да бидам безбеден, вели ЛГБТИ активистот Асани“), Radio MOF, 12 shtator 2022, <https://bit.ly/3AiwMUZ>.

LGBTI+

Propozimi për ndryshime dhe plotësime në Ligjin për Gjendjen Civile, i cili parasheh një proces për njohjen ligjore të gjinisë, renditet si ngjarje kyçe nga viti 2021 në Raportin e të Drejtave Themelore të Agjencisë Evropiane për të Drejtat Themelore për vitin 2022.⁶²⁵ Mirëpo, Qeveria e tërhoqi propozim ligjin për ndryshimin e Ligjit për Gjendjen Civile,⁶²⁶ një ditë para shqyrtimit të tij nga Komisioni për Sistemin Politik dhe Marrëdhëniet Ndërmjet Bashkësive. Prej një viti, deputetët, si të pozitës ashtu edhe të opozitës e mbajnë të bllokuar propozim ligjin në procedurë parlamentare. Arsyeja që dha Qeveria për tërheqjen e ligjit ishte se ai duhej të finalizohet.⁶²⁷ Rrjeti Kombëtar për Luftimin e Homofobisë dhe Transfobisë dënoi ashpër vendimin e Qeverisë për tërheqjen e ligjit. Sipas Rrjetit, Qeveria nuk e përmbush obligimin e saj, i cili rrjedh nga gjykimi i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut në rastin X kundër Maqedonisë së Veriut lidhur me ndryshimin e shënuesve gjinorë në Gjendjen civile.⁶²⁸

Më 20 prill, deputetët evropian iu drejtuan Qeverisë së Maqedonisë së Veriut me një letër në lidhje me nevojën për të mbrojtur të drejtën e personave trans dhe jobinarë për njohjen ligjore të gjinisë në Ligjin për Gjendjen Civile. Ata shprehën shqetësimin e tyre në lidhje me tërheqjen e propozim ligjit të Gjendjes Civile dhe i kërkuan Qeverisë që të vazhdojë përpjekjet për të trajtuar çështjet e theksuara nga organizatat e shoqërisë civile që mbrojnë të drejtat e personave LGBTIQ, si dhe të zbatojë detyrimet e saj sipas Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.⁶²⁹

Në nëntor 2021 grupi ndërpartiak i personave LGBTI në Kuvend organizoi një tryezë të rrumbullakët për njohjen ligjore të gjinisë, me persona trans që folën për herë të parë në Kuvend, duke treguar historitë e tyre të jetës.⁶³⁰ Në diskutim morën pjesë deputetë, përfaqësues të institucioneve, organizatave civile dhe komuniteteve dhe njëzëri konstatuan se është i nevojshëm miratimi i propozim ligjit për ndryshimin dhe plotësimin

625 Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore, "Kontributi kombëtar në Raportin e të Drejtave Themelore për të Drejtat Themelore për 2022 - MAQEDONIA E VERIUT" (Franet National contribution to the Fundamental Rights Report 2022 NORTH MACEDONIA), 8 qershor 2022, https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fundamental_rights_report_2022_north.pdf.

626 Regjistri Kombëtar Elektronik i Rregulloreve të Republikës së Maqedonisë së Veriut - ENER, "Propozimi i Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjendjen civile", (Предлог на Закон за изменување и дополнување на Законот за матична евиденција), 19 nëntor 2021, https://ener.gov.mk/default.aspx?item=pub_regulation&subitem=view_reg_detail&itemid=71555.

627 "Terhiqet propozim ligji i Qeverisë për ndryshimin e gjinisë me deklaratë të noterizuar", („Повлечен владиниот Предлог-закон за промена на полот со нотарска изјава“), TV 24, 22 mars 2022, <https://bit.ly/3ra8FTQ>.

628 "Rrjeti për Luftimin e Homofobisë dhe Transfobisë dënon vendimin për tërheqjen e propozimit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Gjendjen Civile", („Мрежата за борба против хомофобија и трансфобија ја осудува Одлуката за повлекување на предлогot за изменување и дополнување на Законot за матична евиденција“), 22 mars 2022, <https://bit.ly/3TPa5Pq>.

629 "Letër: Deputetët evropian iu drejtuan Qeverisë së Maqedonisë së Veriut në lidhje me njohjen juridike të gjinisë dhe Ligjin për Gjendjen Civile", („Писмо: Европатенитите се обратија до владата на Северна Македонија во врска со правното признавање на родot и Законot за матична евиденција“), Uebfaqja zyrtare e Koalicionit "Të drejtat seksuale dhe shëndetësore të komuniteteve të marginalizuara" MARGINI Shkup, 21 prill 2022, <http://koalicioni.org.mk/archives/12152>.

630 Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore, "Kontributi kombëtar në Raportin e të Drejtave Themelore për të Drejtat Themelore për 2022 - MAQEDONIA E VERIUT" (Franet National contribution to the Fundamental Rights Report 2022 NORTH MACEDONIA), 8 qershor 2022, https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fundamental_rights_report_2022_north.pdf.

e Ligjit për Gjendjen Civile në formën në të cilën është propozuar dhe më pas për të punuar në zbatimin e qëndrueshëm të tij.⁶³¹

Platforma për Gazetari Hulumtuese dhe Analizë (PINA) kreu një anketë joformale, anonime me 45 persona, shumica e të cilëve ishin transgjinorë, si dhe mbështetës të këtij komuniteti, dhe arriti në përfundimin se shumica (78%) e njerëzve trans besojnë se Propozim ligji për njohjen ligjore të gjinisë do të përmirësojë ndjeshëm jetën e tyre.⁶³²

Harta dhe Indeksi vjetor Rainbow i ILGA-Europe, i cili rendit situatën ligjore dhe politike të personave LGBTI në 49 vende evropiane, zbulon se në 12 muajt e fundit janë parë zhvillime të reja në adresimin e boshllëqeve në të drejtat LGBTI, si dhe ndryshimin e standardeve, duke u dhënë vendeve një themel mbi të cilin mund të përparojnë. Krahasuar me raportin dhe hartën e vitit të kaluar, Maqedonia e Veriut mbetet në vendin shumë të ulët të 31-të (nga gjithsej 49), për shkak të mospranimit të ndryshimeve në Ligjin për gjendjen civile, si dhe të Planit Kombëtar të Veprimit për Avancimin e të Drejtave të Personave LGBTI+.⁶³³

Sivjet “Parada e Krenarisë së Shkupit”, organizuar nga Rrjeti Kombëtar Kundër Homofobisë dhe Transfobisë, u mbajt më 25 qershor, nën moton “Dil për dashuri!”. Dinjitet. Barazi. Drejtës”.⁶³⁴ Pjesa e dytë e Fundjavës së Krenarisë në Shkup u mbajt nga 15 deri më 17 shtator, me qëllim të krijimit të një hapësire për prezantimin dhe promovimin e formave jonormative të edukimit botëror, dhe nën temën e trupave ekstazë, që trajton marrëdhëniet, afektet, pozicionet e identitetit, stilet e trupit dhe ndjeshmëritë e shënuara nga kontekste heteronormative, nacionaliste dhe neoliberale kapitaliste, të tilla si queer, ekscentrike dhe të dështuar.⁶³⁵

631 “Tryezë e rrumbullakët për njohjen juridike të gjinisë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut”, („Тркалезна маса за правно признавање на родот во Собранието на Република Северна Македонија”), Uebfaqja zyrtare e Koalicionit “Të drejtat seksuale dhe shëndetësore të komuniteteve të marginalizuara” MARGINI Shkup, 18 nëntor 2021, <http://coalition.org.mk/archives/11963>.

632 “Ligji për Gjendjen Civile do të përmirësojë jetën e njerëzve transgjinorë”, („Законот за матична евиденција би ги подобрил животите на трансродовите nrye”), PINA, 11 maj 2022, <https://bit.ly/3GIOISY>.

633 “Një dinamikë e re është shfaqur në të drejtat e LGBTI në të gjithë Evropën, zbulon harta e ylberit”, („Се појави нова динамика во ЛГБТИ-правата низ Европа, открива виножитната mana”), Faqja zyrtare e Koalicionit “Të drejtat seksuale dhe shëndetësore të komuniteteve të marginalizuara” MARGINI Shkup, 12 maj 2022, <http://coalition.org.mk/archives/12162>.

634 “Parada e Krenarisë në Shkup 2022: Më 25 qershor, dilni për dashuri! Shkupi Prajd 2022: Më 25 Qershor Dil Për Dashurinë!”, Faqja zyrtare e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 11 qershor 2022, <https://bit.ly/3E8qmcc>.

635 „Pjesa e dytë e fundjavës së krenarisë në Shkup në disa lokacione nga 15 deri më 17 shtator”, („Вториот дел од викендот на гордоста Скопје на неколку локации од 15 до 17 септември”), Radio MOF, 11 shtator 2022, <https://www.radiomof.mk/vtoriot-del-od-vikendot-na-gordosta-skopje-na-nekolku-lokacii-od-15-do-17-septemvri/>.

ROMËT

Në seancën e katërmëdhjetë të mbajtur më 15 shkurt 2022,⁶³⁶ Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut shqyrtoi dhe miratoi Strategjinë për përfshirjen e romëve 2022-2030.⁶³⁷ Strategjia e re udhëhiqet nga angazhimet e Deklaratës së Poznanit për vendet e Ballkanit Perëndimor për integrimin e romëve në procesin e zgjerimit të BE-së,⁶³⁸ dhe ndjek drejtimet e parashikuara në Kornizën Strategjike të BE-së për Romët.⁶³⁹ Raporti i të Drejtave Themelore të FRA 2022 thekson se drafti i parë i Strategjisë për Romët 2022-2030 u bë publik në dhjetor 2021, pas së cilës Qeveria hapi një proces të gjerë konsultimi në maj, përmes të cilit përfaqësuesit e interesuar të organizatave të shoqërisë civile u ftuan të përfshinin propozimet e tyre për masat dhe aktivitetet. KPMD mori pjesë në takimin përgatitor për konceptin e strategjisë, ndërsa të gjitha institucionet e tjera shtetërore mund të jipnin komente dhe propozime për draftin e parë të Strategjisë sipas thirrjes publike për konsultime.⁶⁴⁰

Qeveria rishikoi dhe pranoi Planin Kombëtar të Veprimit për Mbrojtjen, Promovimin dhe Përbushjen e të Drejtave të Njeriut të Grave dhe Vajzave Rome 2022-2024.⁶⁴¹ Qëllimi i planit strategjik është promovimi i drejtësisë ndërsektoriale, domethënë qasja e barabartë dhe e drejtë në të drejta, mundësi, burime dhe pushtet në shoqëri, për gratë dhe vajzat rome. Rezultatet e pritshme janë: 1. Rritja e pavarësisë ekonomike të grave rome; 2. Sigurimi i kushteve për marrjen dhe përfundimin e arsimit formal për gratë dhe vajzat rome; 3. Përmirësimi efektiv i mbrojtjes së grave rome nga çdo formë e dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje; 4. Forcimi i qasjes në drejtësi për gratë rome; 5. Forcimi i qasjes në kujdes shëndetësor për gratë rome dhe 6. Rritja e pjesëmarrjes në jetën publike dhe politike dhe kultivimi i udhëheqjes tek gratë rome.⁶⁴²

⁶³⁶ <https://vlada.mk/node/27774>.

⁶³⁷ Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, "Strategjia për përfshirjen e Romëve 2022-2030", („Strategjia za inkluzija na Romite 2022-2030“), <https://www.mtsp.gov.mk/content/pdf/2022/Strategija%20za%20inkluzija%20na%20Romite%202022-2030%2003-02-2022%20finalna%20verzija.pdf>

⁶³⁸ Këshilli Rajonal për Bashkëpunim, "Deklarata e Partnerëve nga Ballkani Perëndimor për integrimin e romëve në procesin e zgjerimit të BE-së", („Декларација на Партнерите од Западниот Балкан за интеграцијата на Ромите во рамките на процесот на проширување на ЕУ“), 5 korrik 2019, <https://bit.ly/3hz3iM4>.

⁶³⁹ Komisioni Evropian, "Udhëzime për përgatitjen e një Kornize Strategjike Kombëtare për Romët për periudhën pas vitit 2020 në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë, („Насоки за подготовка на Национална Стратешка Рамка за Ромите за периодот по 2020 во земјите од Западен Балкан и Турција,“), <https://bit.ly/3VW5o7e>.

⁶⁴⁰ Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore, "Kontributi kombëtar në Raportin e të Drejtave Themelore për të Drejtat Themelore për 2022 - MAQEDONIA E VERIUT" (Franet National contribution to the Fundamental Rights Report 2022 NORTH MACEDONIA), 8 qershor 2022, https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fundamental_rights_report_2022_north.pdf.

⁶⁴¹ Ministria e Punës dhe Politikës Sociale "Plani Kombëtar i Veprimit për Mbrojtjen, Promovimin dhe Përbushjen e të Drejtave të Njeriut të Grave dhe Vajzave Rome 2022-2024", (Министерство за труд и социјална политика „Национален акциски план за заштита, унапредување и исполнување на човековите права на жените и девојките Ромки 2022-2024“), nëntor 2021, <https://bit.ly/3hujr5p>.

⁶⁴² Ibid.

Në prill të vitit 2022, KPMD publikoi një rekomandim të përgjithshëm për autoritetet kompetente të vetëqeverisjes lokale që të ndërmarrin aktivitete për monitorimin e vazhdueshëm të akteve të reonizimit, me qëllim të desegregimit të fëmijëve romë⁶⁴³ dhe një rekomandim të përgjithshëm për komunat dhe ndërmarrjet publike rajonale të tyre që kryejnë aktivitete komunale, për të siguruar qasje në ujë të pastër në të gjithë territorin ku ata janë kompetentë lokalisht.⁶⁴⁴

Në përputhje me të lartëpërmendurën, u mbajt një takim dyditor, ku morën pjesë përfaqësues të Qeverisë, Kuvendit, organizatave ndërkombëtare dhe të shoqërisë civile.⁶⁴⁵ Ministri i Punës dhe Politikës Sociale prezantoi projekte dhe zgjidhje ligjore që synojnë arritjen e qëllimeve specifike, veçanërisht në fushat si arsimi, punësimi, strehimi dhe sigurimi i dokumenteve personale për personat që nuk kanë dokumente personale.⁶⁴⁶ Në takim u theksuan edhe përgatitjet për zbatimin e agjendës së gjelbër dhe dixhitale dhe mënyrat e përfshirjes së romëve në to.⁶⁴⁷

Megjithatë, strehimi për romët mbetet një çështje shqetësuese. KHDNJ raporton se disa familje rome përballen me një rikthim në rrezik social. Përkatesisht, ata kanë marrë vendim nga MPPS që të largohen nga vendbanimi i përkohshëm në Qendrën e pritjes në Vizbegovë, pa bërë plane për integrimin e tyre të mëtejshëm në shoqëri.⁶⁴⁸ Qëllimi i akomodimit të përkohshëm të romëve nga zona nën Kalanë në Qendrën e pritjes në Vizbeg ishte që t'u ndihmohej në përfshirjen e tyre në tregun e punës, t'u sigurohej mbrojtje sociale dhe kujdes shëndetësor, dokumente identifikimi, pastaj fëmijët të përfshihen në sistemin arsimor dhe të gjendet një zgjidhje të përhershme për strehimin e tyre, me qëllimin përfundimtar nxjerrjen e tyre nga varfëria. Dëbimi i tyre gjatë kësaj periudhe, pa një plan ndihmeje për strehim, të paktën në periudhën menjëherë pas dëbimit nga qendra e pritjes, do t'i kthejë menjëherë në varfëri. Gjithashtu, duke paraqitur raportin vjetor për vitin 2021, Avokati i Popullit vuri në dukje se familjet rome, banesat e improvizuara të të cilat u dogjën në nëntor 2021 në Gostivar ende janë pa akomodim

643 Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi, "Rekomandimi i Përgjithshëm", („Општа Препорука”), 27 prill 2022, <https://bit.ly/3AkjB62>.

644 Ibid.

645 "Trenčevska: Përfshirja e plotë e romëve në shoqëri është një detyrim për të cilin ne punojmë së bashku", („Тренчевска: Целосна инклузија на Ромите во општеството е обврска на која заедно работиме”), Faqja zyrtare e Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale, 24 shkurt 2022, <https://bit.ly/3r8AMmv>.

646 Përfshirja e 400 fëmijëve romë në procesin e arsimit parashkollor me qëndrim falas në kopshte, 700 bursa për gjimnazistët romë çdo vit, shkallë të lartë të punësimit të romëve në administratën shtetërore dhe publike, mbështetje për strehim, në drejtim të legalizimit të banesave të tyre - të gjitha të listuara si qëllime të përmbyshura, për të cilat Ministria ka punuar në periudhën e kaluar së bashku me partnerët e saj.

647 Përfshirja e romëve në axhendën dixhitale duke përmirësuar qasjen në pajisjet dixhitale, edukimin dixhital, mbështetjen e fëmijëve romë në fushën e arsimit, tregun e punës në drejtim të përvetësimit dhe aplikimit të aftësive të duhura, si dhe mbështetje për sipërmarrësit romë në dixhitalizimin e aktiviteteve të tyre. Në kuadër të agjendës së gjelbër, përfshirja e romëve në ekonominë cirkulare, me transformimin e sistemeve të menaxhimit të llojeve të ndryshme të mbetjeve dhe burimeve të tjera dhe përfshirjen e tyre në modelet inovative për energjinë e rinovueshme.

648 "Familjet rome përballen me dëbim me forcë nga qendra e pritjes në Vizbegovë", („Ромски семејства се соочуваат со присилно иселување од прифатниот центар во Визбегово”), Faqja zyrtare e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 30 mars 2022, <https://bit.ly/3r45dKD>.

adekuat.⁶⁴⁹ KPMD veproi sipas një peticioni të dorëzuar nga Qendra Evropiane për të Drejtat e Romëve në Bruksel kundër segregacionit në bazë të përkatësisë etnike⁶⁵⁰ dhe lëshoi një rekomandim të përgjithshëm⁶⁵¹ për autoritetet lokale, drejtorët e shkollave, Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dhe Inspektoratin Shtetëror të Arsimit.

KPMD dhe Instituti për Hulumtime dhe Analiza Politike “Romalitiko” nënshkruan një memorandum bashkëpunimi me qëllim të promovimit, zhvillimit dhe vazhdimet të bashkëpunimit për barazi, promovimit të të drejtave të njeriut dhe eliminimit të të gjitha llojeve të diskriminimit sipas interesave dhe qëllimeve të përbashkëta të të dyja organizatave. Përveç kësaj, të dy organizatat ranë dakord të shkëmbejnë periodikisht informacion në lidhje me rastet që lidhen me diskriminimin e drejtuar ndaj komunitetit rom.⁶⁵²

Anketa e fundit e Barometrit Ballkanik regjistroi perceptime kontradiktore të të anketuarve maqedonas në lidhje me komunitetin rom. Gjegjësisht, nga vendet e Ballkanit, Republika e Maqedonisë së Veriut ka përqindjen më të lartë të papranueshmërisë së të anketuarve ose fëmijëve të tyre për t'u martuar me Romë (76%), dhe nga ana tjetër, në Maqedoninë e Veriut është më e pranueshme të ftohet një person nga Komuniteti rom në shtëpinë e të anketuarve (68%).⁶⁵³

Avokati i Popullit pati një reagim për moszbatimin e Ligjit për personat e peregjistruar në Librin Amë, duke theksuar se shteti nuk e ka zgjidhur problemin e personave të padukshëm, madje as nuk i lëshon certifikatë lindjeje apo numër amë për foshnjat e tyre. Ky problem prek veçanërisht popullsinë rome. Përveç kësaj, asnjë nga ligjet specifike që rregullojnë të drejtën në arsim, shëndetësi, të drejtat e punës, etj. nuk janë në përputhje me këtë ligj, kështu që në praktikë personat e peregjistruar nuk i kanë këto të drejta. Është hera e parë që Qeveria i ka pranuar të gjitha kërkesat e Avokatit të Popullit dhe ai ka paralajmëruar se do të monitorojë se si do të kryejnë detyrat ministritë.⁶⁵⁴

649 Avokati i popullit i Republikës së Maqedonisë së Veriut, “Raport vjetor për shkallën e sigurimit të respektit, promovimit dhe mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut 2021”, („Годишен извештај за степенот на обезбедувањето почитување, унапредување и заштита на човековите слободи и права 2021”), mars 2022, <https://ombudsman.mk/CMS/Upload/NarodenPravobranitel/upload/Godisni%20izvestai/GI-2021/GI%20-2021.pdf>.

650 “U miratua një rekomandim i përgjithshëm për desegregimin e fëmijëve romë gjatë regjistrimit në shkollat”, („Донесена општа препорака за десегрегација на децата Роми при упис во училиштата”), Faqja zyrtare e Komisionit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi, 11 shkurt 2022, <https://bit.ly/3VOMOLO>.

651 Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi, “Mendim”, („Мислење”), 8 shkurt 2022, <https://bit.ly/3NR2hL3>.

652 “KPMD nënshkroi memorandum bashkëpunimi me ‘Romalitiko’”, („Потпишан меморандум за соработка помеѓу КСЗД и ‘Ромалитико’”), Faqja zyrtare e Komisionit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi, 14 prill 2022, <https://bit.ly/3twf7FD>.

653 Qendra ACIT dhe Instituti EPIK, “BAROMETER BALLKANIK – Raport analitik për opinionin publik 2022”, (BALKAN BAROMETER – 2022 Public Opinion Analytical report) qershor 2022, <https://www.rcc.int/balkanbarometer/publications>.

654 “Shteti i privon më tej foshnjat nga prindërit pa identitet dhe shton numrin e fantazmave të reja”, („Државата дополнително ги обесправува бебињата од родителите без идентитет и ја зголемува бројката на нови фантоми”), Sakam da kazam, 26 korrik 2022, <https://bit.ly/3TZFBLK>.

KPMD publikoi një mendim kundër një shkolle fillore në Manastir për shkak të segregimit të fëmijëve romë përmes praktikave të regjistrimit të nxënësve në shkollë, me çka autoritetet kishin një afat gjashtëmujor për të zbatuar masat për të hequr diskriminimin indirekt ndaj fëmijëve romë në shkollë. Përkatësisht, prindërit e nxënësve jo-romë kanë mundur t'i regjistrojnë fëmijët e tyre në shkolla jashtë mjedisit ku ata jetojnë për shkak të zbatimit selektiv të ligjit nga shkolla. Kjo rezultoi në ndarjen e nxënësve romë, pasi një numër i madh i fëmijëve jo-romë u lejuan të transferoheshin në shkolla të zonave të tjera, prandaj KPMD u rekomandoi drejtorëve të shkollave të asaj zone që të regjistronin vetëm ata fëmijë që administrativisht i përkasin asaj shkolle dhe Ministria e Arsimit u urdhërua të vendosë kritere më të rrepta për regjistrimin e fëmijëve në një shkollë jashtë rajonit të tyre.⁶⁵⁵

Qendra Evropiane për të Drejtat e Romëve (ERRC) njofton se autoritetet lokale në komunat Prilep, Kërçovë, Manastir dhe Kavadar kanë marrë urdhër për të siguruar qasje në ujë të pastër në vendbanimet rome në komunat, pas një peticioni të dorëzuar nga ERRC dhe një vendim nga KPMD për diskriminim të drejtpërdrejtë në bazë të racës, ngjyrës së lëkurës, përkatësisë etnike, prejardhjes sociale dhe gjendjes pronësore në fushën e qasjes në mallra dhe shërbime, sepse këto vendbanime nuk ishin të lidhura me rrjetin e ujit, pavarësisht faktit se komunitetet rome kanë jetuar atje për një kohë të gjatë.⁶⁵⁶

Nevojitet zbatimi i plotë i masave të parashikuara në Strategjinë Kombëtare për Barazi dhe Mosdiskriminim 2022-2026.

Nevojitet funksionalitet i plotë i KPMD-së: të zgjidhet problemi për infrastrukturën dhe mirëmbajtjen e hapësirave, të sigurohen burime dhe fonde për punë, të futet një zë në buxhet për punësime të reja.

Çelësi është bashkëpunimi mes KPMD-së, AGJPP-së dhe Këshillit Gjyqësor, me qëllim sensibilizimin e gjyqësorit ndaj parimit të mosdiskriminimit.

Është i nevojshëm miratimi i Strategjisë së re Kombëtare për Personat me Aftësi të Kufizuara të Maqedonisë së Veriut dhe përmbushja e vazhdueshme e masave të para-para në të, për të përmbushur plotësisht kërkesat e personave me aftësi të kufizuara.

655 „ERRC: KPMD urdhëroi shkollën fillore “Gjorgji Sugarev” të ndalojë segregacionin e fëmijëve romë”, („ЕЦПР: КСЗД му нареди на основното училиште „Ѓорѓи Сугарев” да ја прекине сегрегацијата на ромските деца”), Radio MOF, 17 gusht 2022, <https://bit.ly/3EyVanV>.

656 „Pas diskriminimit të përcaktuar nga KPMD, pushteti lokal në Prilep ka marrë urdhër për sigurimin e ujit të pijshëm për vendbanimet rome”, („По утврдена дискриминација од КСЗД, локалната власт во Прилеп доби наредба да обезбеди питка вода за ромските населби”), Radio MOF, 25 gusht 2022, <https://bit.ly/3Gi9wdt>.

Është e nevojshme të përmbushen detyrat e dhëna institucioneve kompetente me vendimin e Gjykatës Themelore Civile në Shkup, me të cilin është vërtetuar diskriminimi i drejtpërdrejtë ndaj personave me aftësi të kufizuara gjatë ushtrimit të së drejtës së tyre të votës.

Një problem tjetër që duhet zgjidhur është mungesa e asistentëve edukativë për fëmijët me aftësi të kufizuara, sepse kjo prish procesin e përfshirjes së fëmijëve me aftësi të kufizuara në sistemin arsimor dhe dëmton ata dhe prindërit e tyre.

Është e nevojshme që Kuvendi të miratojë pa vonesë Ligjin për pagesën e dëmshpërblimit monetar për viktimat e krimeve të dhunshme, i cili ndër të tjera do të mbrojë viktimat e dhunës me bazë gjinore.

Buxhetimi gjinor është paraparë në Ligjin për mundësi të barabarta për gratë dhe burrat, por duhet të rregullohet edhe në Ligjin për buxhetin.

Është e nevojshme të zbatohen plotësisht masat e parashikuara në Strategjinë e Barazisë Gjinore 2022-2027, me qëllim promovimin e barazisë gjinore dhe mbështetjen e grave.

Është i nevojshëm miratimi i Ligjit për Barazinë Gjinore, për të arritur barazinë e plotë gjinore në të gjitha sferat e jetës publike dhe private.

Është thelbësore të zgjidhen problemet e regjistruara të joprofesionalizmit, kontradiktës dhe pabarazisë në veprimet e qendrave të punës sociale, mosveprimi institucional në rastet e dhunës së kryer nga një ish-partner, mosveprimi i prokurorisë publike ndaj një raporti penal për dhunën e kryer në bazë gjinore dhe dështimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme për të vepruar sipas raporteve të pranuar për dhunën në familje.

Është e nevojshme që urgjentisht të miratohen ndryshimet dhe plotësimet në Ligjin për Gjendjen Civile, i cili parasheh një proces për njohjen ligjore të gjinisë dhe zbatimin e vazhdueshëm të tyre.

Është e nevojshme të zbatohen plotësisht masat e parashikuara në Strategjinë e Përfshirjes së Romëve 2022-2030 dhe në Planin Kombëtar të Veprimit për Mbrojtjen, Promovimin dhe Përmbushjen e të Drejtave të Njeriut të Grave dhe Vajzave Rome 2022-2024.

Ende ekziston problemi i "personave të padukshëm", i cili veçanërisht i prek romët, prandaj institucionet kompetente duhet të respektojnë kërkesat e Avokatit të Popullit dhe të zbatojnë siç duhet Ligjin për personat e paregjistruar në Librin amë.

Literatura e shfrytëzuar



- MKD. “6 vjet burg për Gruevskin për ndërtimin e selisë së VMRO-DPMNE, dënim me kusht për Bozhinovskin”, („6 години затвор за Груевски за изградбата на седиштето на ВМРО-ДПМНЕ, условна за Божиновски”), MKD, 8 qershor 2022, <https://www.mkd.mk/makedonija/sudstvo/presuda-za-talir-2>.
